



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në institucionin e**  
**Prefektit të Qarkut Tiranë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE”**

**Tiranë, shkurt 2025**

# **PËRMBAJTJA**

“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE” .....	1
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	11
<b>II. HYRJE.....</b>	<b>16</b>
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....</b>	<b>19</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë.....	19
2. Përshkrimi i rezultateve, sipas drejtimeve të auditimit .....	21
2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023.....	21
2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022 -31.12.2023.....	28
2.3. Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.....	35
2.4. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit .....	97
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>100</b>
<b>A. MASA ORGANIZATIVE .....</b>	<b>100</b>
<b>C. MASA DISIPLINORE .....</b>	<b>111</b>
<b>D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL .....</b>	<b>112</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë:

Qarku i Tiranës është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqje prej 1.586 km<sup>2</sup>. Qarku i Tiranës i përfshin pesë bashki (Tiranë, Kamzë, Vorë, Rrogozhinë dhe Kavajë). Qendra e Qarkut të Tiranës ndodhet në qytetin e Tiranës. Qarku i Tiranës kufizohet në veri me Qarkun e Durrësit, në verilindje me Qarkun e Dibrës, në juglindje me Qarkun e Elbasanit, në jug me Qarkun e Fierit dhe në perëndim me Detin Adriatik. Rajoni i Tiranës ka një popullsi prej 800,197 banorësh (2009).

Nga auditimi i procedurave të hartimit të buxhetit për periudhën e audituar, u konstatua se projekt buxheti për vitin 2022 dhe 2023, është hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit organik nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse të zbatimit të buxhetit të shtetit (UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe ligjeve dhe udhëzimeve plotësuese të zbatimit të buxhetit vjetor respektiv (ligjit nr. 115, datë 25.11.2021 dhe nr. 84, datë -24.11.2022, “Për buxhetin e vitit 2022 dhe 2023”).

Programet buxhetore afatmesme (PBA) 2023-2025 dhe 2024-2026, janë përgatitur nga institucioni qendror, Ministria e Brendshme.

Mbi bazën e shkresave të akordimit të fondeve, është bërë detajimi buxhetit sipas artikujve dhe nënartikujve në zbatim të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe UMB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”.

Akordimi fillestar i buxhetit për vitin 2022, është dërguar me shkresën e MB nr. 10084/4 prot., datë 27.01.2022. Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga institucioni qendror MB, është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2022. Akordimi fillestar i buxhetit për vitin 2023, është dërguar me shkresën e MB nr. 12851/20 prot., datë 30.01.2023. Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga MB, është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2023.

### a. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Nga viti 1912 deri më vitin 1926, Tirana ishte nënprefekturë nën juridiksionin e Prefekturës të Durrësit dhe vetëm pas shpalljes së Tiranës si kryeqytet i Shqipërisë, marrëdhënia me Ministrinë e Punëve të Brendshme filloi të ishte i drejtpërdrejtë.

Në vitin 1926, Dhoma e Deputetëve dhe Senati miratoi organizimin e ri të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që e përfshiu për herë të parë Qarkun e Tiranës në Departamentin e Qendrës. Kjo formë e organizimit vazhdoi deri në vitin 1944 dhe titullari më i lartë i administratës në shtet ishte prefekti.

Pas vitit 1944, edhe pse pa titullarët e tyre, prefekturat u ruajtën si njësi administrative deri më 1947.

Nocioni administrativ “Prefekturë” nuk u aplikua për rreth 45 vjet.

Forma e organizimit me prefektura u rivendos përsëri në vitin 1992, me miratimin e ligjit “Për prefekturat”, më datë 22 shtator 1992. Më 26 korrik 1993, Këshilli i Ministrave nxori vendimin për ndarjen dhe krijimin e 12 prefekturave në vend.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të auditimeve për muajin qershor 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87/5 prot., datë 07.06.2024.

#### **b. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:**

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2022 deri më datën 31.12.2023.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023;
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2023.
- Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

#### **c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:**

Grupi i auditimit, në bazë të programit të auditimit vlerësoi për auditim 5 procedura prokurimi, blerje e vogël për vitin 2022, me vlerë të kontratave 601,685 lekë me TVSh dhe 5 procedura prokurimi, blerje e vogël për vitin 2023, me vlerë të kontratave 477,502 lekë me TVSh.

Gjithashtu, u auditua edhe buxhetimi, monitorimi i institucioneve dhe miratimi i ligjshmërisë së vendimeve të këshillave bashkiake për bashkitë që përfshin Qarku i Tiranës, nga ku u konstatuan paputhshmëri ligjore, mangësi në dokumentacion dhe miratimi i akteve individuale në kundërshtim me ligjin organik për Prefektin e Qarkut dhe aktet nënligjore në fuqi.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve;
- Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- Intervistat;
- Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

#### **d. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 23 gjetje dhe ka dhënë 23 rekomandime, masa organizative.

#### **e. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

**1.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se nga njësitë e qeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut, Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë), për periudhën objekt auditimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë janë depozituar **381 Akte Individuale** (195 gjatë vitit 2022 dhe 186 gjatë vitit 2023), të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie, pasi iu drejtohen subjekteve të përcaktuar individualisht, duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete dhe janë të shteruar në zbatimin e tyre.

**2.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

- **37** Vendime të Këshillit Bashkiak Kamëz, me objekt “*Dhënie ndihme ekonomike*”, me një vlerë totale prej **13,342,000 Lekë**, janë konfirmuar në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019 “*Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe*

të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kapitulli 4, pikat 5, 7 dhe 13.

- Në 5 raste, u konstatua se VKB-të me objekt “Dhënie ndihme ekonomike për arsye shëndetësore”, janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11, pika 1.

**3.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se VKB-të nr. 14, datë 15.02.2023, “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”, nr. 26, datë 17.03.2023, “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”, nr. 28, datë 17.03.2023, “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”, nr. 39 datë 11.04.2023, “Për Shpërblimin e sportistëve dhe trajnerëve të ekipeve të shkollave të Bashkisë Kamëz, fituese në nivel qarku në disiplinat volejball dhe basketboll (meshkuj dhe femra), në kuadër të projektit “Ekipet sportive në shkollat”, nr. 52 datë 18.04.2023, “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim”, për vitin 2023 me fonde nga buxheti i shtetit”, janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, pika 4.

**4.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se nëpërmjet VKB-së nr. 8 datë 25.01.2022, “Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit privat A.A. ShPK & E.A. dhe Bashkisë Kavajë”, është miratuar aktmarrëveshja nr. 227 prot., datë 18.01.2022, ku dakortësohet që detyrimi i subjektit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej **11,842 828 lekë**, të këmbëhet me 3 apartamente banimi të cilat do të kalojnë në pronësi të Bashkisë Kavajë. Marrëveshja e miratuar nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të referuar në vendim, pasi nuk është e parashikuar të realizohet këmbimi me apartamente i vlerës së taksës të detyrueshme për t’u paguar në vlerë monetare.

**5.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në 2 raste, VKB-të nuk kanë qenë të shoqëruara nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

- Në dokumentacionin shoqërues të VKB-së nr. 67 datë 23.11.2022, “Për miratimin e fondit nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Rrogozhinë për objektin mbrojtje me gabione, përroi Sinaballaj, për mbrojtjen e banesave nga gërryerjet e këtij përroi”, mungon preventivi i vlerësimit të dëmeve për dëmshpërblimin e miratuar në shumën prej 692,700 lekë.

- Në dokumentacionin shoqërues të VKB-së nr. 35 datë 26.04.2022, “Për dhënien e ndihmës financiare z. S.H. për dëmet e shkaktuara në banesën e tij”, mungon procesverbali i konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

**6.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se Vendimi nr. 72 datë 20.11.2023, “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar nga AKMC për përballimin e situatave emergjente”, me të cilin është miratuar fondi **3,349,000 lekë** për ndërhyrje të menjëhershme në objektin industrial ish Fabrika e Letrës, është konfirmuar në mospërputhje Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 35, për arsye se prishja e detyruar e një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, sipas përfundimeve në akt konstatimet apo akt vlerësimit paraprake të Institutit të Ndërtimit ose në akt ekspertizën

e thelluar, si dhe nëse riparimi kushton më shumë se ndërtimi nga e para, sipas rekomandimeve në aktin e ekspertizës së thelluar, të hartuar sipas parashikimeve në këtë ligj.

Gjithashtu, u konstatua se për nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesës, nuk rezultojnë të dokumentuara kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

7. Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se:

1. Me vendimin nr. 4 datë 20.01.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”, është miratuar shuma **234,499,204 lekë**, në zbatim të programeve të rindërtimit;

2. Me vendimin nr. 84 datë 19.12.2023, “Për miratimin e ndryshimeve të masës së përfitimit të familjeve të miratuara me VKB-në nr. 62 datë 21.07.2021, VKB-së nr.88, datë 11.11.2021, VKB-së nr.4, datë 20.01.2023”, është miratuar ndryshimi i masës së përfitimit për: F.I.H., e cila kishte përfituar një apartament 2+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartamente 2+1 dhe 1+1; H.R.Rr., i cili kishte përfituar një apartament 1+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartament 2+1; Sh.M.L., i cili kishte përfituar apartament 1+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartament 2+1;

3. Me vendimin nr. 95 datë 19.07.2022, “Mbi miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve të vendimit nr. 67 datë 17.06.2022 të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për banesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të institutit të ndërtimit me nivel dëmtimi “Për shembje”” është miratuar kualifikim shtesë për 2 përfitues;

4. Me vendimin nr. 28 datë 23.03.2022, “Për disa ndryshime në VKB-në nr. 64, datë 11.06.2020 dhe VKB-në nr. 54 datë 30.06.2021, për miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit si rezultat i fatkeqësisë natyrore të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019” është miratuar masa e ndryshimit për përfituesit: F.H.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS1 dhe bëhet DS3); R.Sh.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3); D.T. (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3);

5. Me vendimin nr. 30 datë 23.03.2023, “Për një ndryshim/shtesë të VKB-së nr. 4 datë 20.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”” është miratuar masa e ndryshimit për përfituesit: E.Sh. (Sh.), vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 2,241,707 Lekë dhe pas rivlerësimit është në vlerën prej 3,412,137 Lekë; D.D., vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 12,094,026 Lekë për tre familjet D., për ndërtimin e një ndërtese në bashkëpronësi dhe pas rivlerësimit u shtua vlera prej 2,241,707 Lekë; L.B. shtohet si përfitues i një apartamenti 2+1;

6. Me vendimin nr. 10 datë 23.01.2023, “Për miratimin e subjekteve, të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit për shembje”, janë miratuar si përfitues aplikuesit L.P. dhe N.M., të cilët rezultojnë të skualifikuar në VKB-në nr. 50, datë 19.05.2021 dhe VKB nr. 146 datë 07.12.2020;

7. Me vendimin nr. 83 datë 22.08.2023, “Për miratimin e listës së familjeve shtesë që përfitojnë bonus qiraje, banesat e të cilëve preken nga rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit”, është miratuar lista e familjeve shtesë që do të trajtohen me bonus qiraje, për shkak se banesat e tyre preken nga projekti “Ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit dhe Rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit”.

**Në 7 rastet e sipërcituara, VKB-të janë konfirmuar në mungesë të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurës ligjore mbi të gjitha rivlerësimet e kryera**

(depozitimi i ankesave të subjekteve jo përfitues, procedura e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore, akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit etj.).

**8.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, Vendimit nr. 62 datë 29.09.2023 “*Për shembjen e detyruar të ndërtesës së Kopshtit “Fiqiri Kurti” si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019*”, u konstatua se Urdhëri nr. 102, datë 24.04.2023, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26.11.2019, është në tejkalim të afateve (rreth 4 vite pas fatkeqësisë natyrore) dhe konstatimi është kryer në mospërputhje të Ligjit nr. 45/2019 “*Për mbrojtjen civile*”, neni 14, pika 3.

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertiza e thelluar është hartuar në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*”, neni 34 dhe VKM-në nr. 26, datë 15.1.2020 “*Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara*”, pika 5, pasi përveç të tjerave, nuk përmban përkrahimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje.

**9.** Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se ***në 5 raste***, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht: Vendimet nr. 32 datë 06.04.2022; nr. 50 datë 14.06.2022; nr. 6 datë 25.01.2023; nr. 52 datë 03.05.2023 dhe nr. 118 datë 15.11.2023 (të konfirmuara), ***për dhënie prone për zhvillim*** janë konfirmuar pa u shoqëruar me dokumentacionin që vërteton këshillimin me bashkësinë, dokumentacionin ligjor mbi regjistrimin e pronës (certifikatë pronësie), relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore si dhe pa procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

**10.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë me nr. 56 datë 06.07.2022 “*Për miratimin e listave të përfituesve të nën programit të grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4*” është miratuar megjithëse kërkesat e qytetarëve janë në tejkalim të afateve ligjore të parashikuara për të drejtën e ankimimit dhe nuk kanë si dokumentacion shoqërues certifikatat e gjendjes familjare në datën 26.11.2019. Miratimi i listave nuk është shoqëruar me Procesverbalin e mbledhjes së këshillit bashkiak. Arsytet e rivlerësimit të 2 banesave, të shpjeguara në raportet nr. 18270, datë 20.05.2022 dhe nr. 23628, datë 24.06.2022 nga komisioni i posaçëm i ngritur, janë në mospërputhje me VKM-në nr. 5, datë 6.1.2020 “*Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model*”, Kreu IV “*Grantet për rikonstruksion*”, pika 19, pika 2, gërma a.

**11.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se me shkresën nr. 1399/1 prot., datë 22.07.2022, nga Prefekti është miratuar Vendimi KB Tiranë nr. 71 datë 12.07.2022 “*Për kalimin në administrim të Agjencisë së Industrisë Kreative, të objektit “Kinema Agimi”, me nr. pasurie 2/106-n 20, zona kadastrale 8270, në pronësi të Bashkisë Tiranë*”, pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues.

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në lidhje me administrimin e debitorit; (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar). Qendra Kulturore Tirana në shkresën nr. 297, datë 16.06.2022 “*Informacion mbi objektin Kinema “Agimi”*”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, thekson se për Kinemanë “Agimi” është krijuar debitori shoqëria “E.” deri në 31.12.2021, në vlerën 20,215,543 lekë të pasqyruar në bilancin e vitit ushtrimor 2021 në llogarinë 468 “*debitorë të ndryshëm*”, vlerë e cila në përfundim të kontratës

në datë 09.02.2022 arrin në 22,219,621 lekë dhe për çdo ditë vonesë një kamatë ditore prej 1% të vlerës së qirasë.....”).

- Mungon procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 dhe neni 55.

**12.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste për dhënie me qira**, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht Vendimi nr. 139 datë 23.12.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar” dhe Vendimi nr. 144 datë 23.12.2022 “Për miratimin e formës dhe procedurave për shfrytëzimin e ambienteve sportive të institucioneve arsimore publike para universitare, Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit “Shkolla Qendër Komunitare””, (të konfirmuara), për **periudhë të përkohshme përcakton një afat 3 vjeçar**, por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, projektvendimin dhe relacionin shpjegues.

**13.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, **për transferim prone** konkretisht Vendimi nr. 109, datë 15.11.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të një pjese të pasurisë me nr. 7/662, zona kadastrale 8170, me sipërfaqe prej 529 m<sup>2</sup>, që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e zhvillimit ekonomik, si dhe shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”; Vendimi nr. 19 datë 06.04.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 150, zona kadastrale 3517, me emërtimin “grup depo rep. usht. 8837, me vendndodhje në Stërmas”, me qëllim ngritjen e një qendre grumbullimi (strehëz) për kafshët endacake” dhe Vendimi nr. 24 datë 17.03.2023 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme me numër pasurie 1/71, ZK 8150, tiranë, që do të përdoret në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”, janë konfirmuar pa marrë më parë miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe pa u shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

**14.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, **dhënie ndihmë emergjencë** konkretisht Vendimi nr. 128, datë 23.12.2022 “Për dhënien e ndihmës financiare për 16 (gjashhtëmbëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit dhe përmbytjeve dhe dëmet ndërtimore në ambientet e përbashkëta të pallatit “Mesaplik 05”, ndërtesa Nr.4, në rrugën “Migjeni”, Lagjja Nr. 14.”. i cili ka miratuar fondin **3,245,423 lekë**; Vendimi nr. 51 datë 03.05.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 7 (shtatë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 2 raste, zjarre 4 raste dhe përmbytje 1 raste në vlerë totale 5,397,301 lekë); Vendimi nr. 86 datë 20.07.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 29 (njëzet e nëntë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 11 raste, zjarre 13 raste dhe përmbytje 5 raste në vlerë totale 11,757,572 lekë), janë konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, gërmat b, ç, d dhe e.

**15.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë **për sipërmarrje dhe dhënie me qira**, konkretisht Vendimi nr. 40 datë 19.04.2023 “Për miratimin në parim të dhënies me qira, me konkurrim, të një sipërfaqeje prej 1284 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me nr. 8/72, zona kadastrale 8270, me emërtim “Akuadromi i Tiranës”” dhe Vendimi nr. 100 datë 15.09.2023 “Për miratimin e projektit “Sipërmarrja ime për shkollën” hartuar



*sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij*”, janë konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 dhe neni 55, pikat 3 dhe 4; VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, pika 3; si dhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pikat b dhe c.

**16.** Me vendimin nr. 77, datë 05.01.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Vorë për vitin 2023”, është konfirmuar ligjshmëria për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, u konstatua se në pikën II.2., “Tarifa për shërbime administrative”, me numër rendor 3 është specifikuar “Aplikim për leje ndërtimi, leje zhvillimi, leje infrastrukturore, leje përdorimi”, me detyrim në vlerën 10,000 lekë. Në pikën II.9., “Tarifa vendore për kërkesa për leje punimesh”, është specifikuar detyrim në vlerën 1% e punimeve/preventivit.

Sa më sipër, rezulton se është vendosur dy herë detyrim, për të njëjtin shërbim të ofruar. Një herë në vlerën 10,000 lekë, e cila rezulton e argumentuar dhe e mbështetur në legjislacionin tatimor dhe një herë e shprehur në përqindje. Mënyra e llogaritjes së këtij detyrimi, e shprehur në përqindje mbi vlerën e investimit, del jashtë kuptimit të tarifës së aplikimit dhe realisht është rritje në mënyrë të tërthortë e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke rënduar detyrimet e qytetarëve.

**17.** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara u konstatua se për vitet 2022-2023, gjatë kryerjes së funksioneve në marrëdhëniet me institucionet qendrore në qark, Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk ka ushtruar përgjegjësitë e monitorimit dhe kontrollit.

Gjithashtu, nga ana e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk është kryer monitorimi i veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve që veprojnë në nivel qarku.

#### **f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

**1.** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa që në vazhdim të pranojë dhe të konfirmojë ligjshmërinë vetëm për aktet me karakter normativ, të depozituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

**2.** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë të marrë masa që:

- Të ngrihet një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

- Në vijim, në të gjitha rastet kur vërehen shkelje ligjore në akt dhe vlerësohet se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

**3** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik, të marrë masa për:

-Verifikimin sistematik të ligjshmërisë së akteve normative në njësitë e vetëqeverisjes vendore çdo 3 muaj.

-Kontrollin periodik mbi procedurat e ndjekura për aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore.

**4.** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa për të ngritur një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

**5.** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa që në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura për dhënien së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të

shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'u kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

**6. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë të marrë masa që:**

- Të ngrihet një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në mospërputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi.

- Në vijim, në të gjitha rastet kur vërehen shkelje ligjore në akt dhe vlerësohet se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

**7. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë të marrë masa që:**

- Të ngrejë grupe pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për konfirmimin e dhënë në mungesë të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurave ligjore;

- Në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

**8. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa për të ngritur një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në mospërputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi.**

**9. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për këto vendime dhe në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

**10. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 56, datë 06.07.2022 dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

**11. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 71, datë 12.07.2022 dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

**12. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 139 datë 23.12.2022 dhe nr. 144 datë 23.12.2022, si dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

**13. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 109, datë 15.11.2022 dhe nr. 19 datë 06.04.2022, si dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.**

14. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimet e dhëna në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

15. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimet e dhënë në mospërputhshmëri me kuadrin rregullator në fuqi. dhe në të gjitha rastet kur, aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

16. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik, të marrë masa për të kërkuar pavlefshmërinë e aktit Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

17. Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara të marrë masa që:

- Të ushtrojë përgjegjësitë e monitorimit dhe kontrollit duke ndjekur procedurën e përcaktuar në rregulloren e brendshme.

- Të kryejë monitorim të veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve që veprojnë në nivel qarku.

## **Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit**

### **Për auditimin e përputhshmërisë:**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Tiranë” për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve, rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, b) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike; c) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Prefektura Qarkut Tiranë ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

### **Baza për opinionin e kualifikuar:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë për zgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë dhe vlerën e materialitetit llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

1. Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se nga njësitë e

qeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut, Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë), për periudhën objekt auditimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë janë depozituar **381 Akte Individuale** (195 gjatë vitit 2022 dhe 186 gjatë vitit 2023), të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie, pasi iu drejtohen subjekteve të përcaktuar individualisht, duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete dhe janë të shteruar në zbatimin e tyre.

**2.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

- **37** Vendime të Këshillit Bashkiak Kamëz, me objekt “*Dhënie ndihme ekonomike*”, me një vlerë totale prej **13,342,000 lekë**, janë konfirmuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019, Kapitulli 4, pikat 5, 7 dhe 13.

- Në 5 raste, u konstatua se VKB-të me objekt “*Dhënie ndihme ekonomike për arsye shëndetësore*”, janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011, neni 11, pika 1.

**3.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se VKB-të nr. 14, datë 15.02.2023, “*Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë*”, nr. 26, datë 17.03.2023, “*Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë*”, nr. 28, datë 17.03.2023, “*Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë*”, nr. 39 datë 11.04.2023, “*Për Shpërblimin e sportistëve dhe trajnerëve të ekipeve të shkollave të Bashkisë Kamëz, fituese në nivel qarku në disiplinat volejboll dhe basketboll (meshkuj dhe femra), në kuadër të projektit “Ekipet sportive në shkolla”*”, nr. 52 datë 18.04.2023, “*Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim”, për vitin 2023 me fonde nga buxheti i shtetit*” të Bashkisë Kamëz, janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, neni 91, pika 4.

**4.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se nëpërmjet VKB-së nr. 8 datë 25.01.2022, “*Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit privat A.A. ShPK & E.A. dhe Bashkisë Kavajë*”, është miratuar aktmarrëveshja nr. 227 prot., datë 18.01.2022, ku dakordësohet që detyrimi i subjektit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej **11,842 828 lekë**, të këmbëhet me 3 apartamente banimi të cilat do të kalojnë në pronësi të Bashkisë Kavajë. Marrëveshja e miratuar nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të referuar në vendim, pasi nuk është e parashikuar të realizohet këmbimi me apartamente i vlerës së taksës të detyrueshme për t’u paguar në vlerë monetare.

**5.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në 2 raste, VKB-të nuk kanë qenë të shoqëruara nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në kundërshtim me me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

- Në dokumentacionin shoqërues të VKB-së nr. 67 datë 23.11.2022, “*Për miratimin e fondit nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Rrogozhinë për objektin mbrojtje me gabione, përroi Sinaballaj, për mbrojtjen e banesave nga gërryerjet e këtij përroi*”, mungon preventivi i vlerësimit të dëmeve për dëmshpërblimin e miratuar në shumën prej 692,700 lekë.

- Në dokumentacionin shoqërues të VKB-së nr. 35 datë 26.04.2022, “*Për dhënien e ndihmës financiare z. S.H. për dëmet e shkaktuara në banesën e tij*”, mungon procesverbali i konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara.

**6.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se Vendimi nr. 72 datë 20.11.2023, “*Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar nga AKMC për përballimin*

*e situatave emergjente*”, me të cilin është miratuar fondi **3,349,000 lekë** për ndërhyrje të menjëhershme në objektin industrial ish Fabrika e Letrës, është konfirmuar në kundërshtim me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, neni 35, për arsye se prishja e detyruar e një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, sipas përfundimeve në akt konstatimet apo akt vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit ose në akt ekspertizën e thelluar, si dhe nëse riparimi kushton më shumë se ndërtimi nga e para, sipas rekomandimeve në aktin e ekspertizës së thelluar, të hartuar sipas parashikimeve në këtë ligj.

Gjithashtu, u konstatua se për nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesës, nuk rezultojnë të dokumentuara kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011.

7. Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se:

1. Me vendimin nr. 4 datë 20.01.2023, “*Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019*”, është miratuar shuma **234,499,204 lekë**, në zbatim të programeve të rindërtimit;

2. Me vendimin nr. 84 datë 19.12.2023, “*Për miratimin e ndryshimeve të masës së përfitimit të familjeve të miratuara me VKB-në nr. 62 datë 21.07.2021, VKB-së nr.88, datë 11.11.2021, VKB-së nr.4, datë 20.01.2023*”, është miratuar ndryshimi i masës së përfitimit për: F.I.H., e cila kishte përfituar një apartament 2+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartamente 2+1 dhe 1+1; H.R.Rr., i cili kishte përfituar një apartament 1+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartament 2+1; Sh.M.L., i cili kishte përfituar apartament 1+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartament 2+1;

3. Me vendimin nr. 95 datë 19.07.2022, “*Mbi miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve të vendimit nr. 67 datë 17.06.2022 të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për banesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të institutit të ndërtimit me nivel dëmtimi “Për shembje” është miratuar kualifikim shtesë për 2 përfitues.*

4. Me vendimin nr. 28 datë 23.03.2022, “*Për disa ndryshime në VKB-në nr. 64, datë 11.06.2020 dhe VKB-në nr. 54 datë 30.06.2021, për miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit si rezultat i fatkeqësisë natyrore të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019*” është miratuar masa e ndryshimit për përfituesit: F.H.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS1 dhe bëhet DS3); R.Sh.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3); D.T. (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3);

5. Me vendimin nr. 30 datë 23.03.2023, “*Për një ndryshim/shtesë të VKB-së nr. 4 datë 20.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”*” është miratuar masa e ndryshimit për përfituesit: E.Sh. (Sh.), vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 2,241,707 Lekë dhe pas rivlerësimit është në vlerën prej 3,412,137 Lekë; D.D., vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 12,094,026 Lekë për tre familjet D., për ndërtimin e një ndërtese në bashkëpronësi dhe pas rivlerësimit u shtua vlera prej 2,241,707 Lekë; L.B. shtohet si përfitues i një apartamenti 2+1;

6. Me vendimin nr. 10 datë 23.01.2023, “*Për miratimin e subjekteve, të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit për shembje*”, janë miratuar si përfitues aplikuesit L.P. dhe N.M., të cilët rezultojnë të skualifikuar në VKB-në nr. 50, datë 19.05.2021 dhe VKB nr. 146 datë 07.12.2020;

7. Me vendimin nr. 83 datë 22.08.2023, “*Për miratimin e listës së familjeve shtesë që përfitojnë bonus qiraje, banesat e të cilëve preken nga rehabilitimi i digës së liqenit të*

*Paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit*”, është miratuar lista e familjeve shtesë që do të trajtohen me bonus qiraje, për shkak se banesat e tyre preken nga projekti “*Ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit dhe Rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit*”.

**Në 7 rastet e sipërcituara**, VKB-të janë konfirmuar në mungesë të **dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurës ligjore** mbi të gjitha rivlerësimet e kryera (depozitimi i ankesave të subjekteve jo përfitues, procedura e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore, akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit etj.).

**8.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, Vendimit nr. 62 datë 29.09.2023 “*Për shembjen e detyruar të ndërtesës së Kopshtit “Fiqiri Kurti” si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019*”, u konstatua se Urdhri nr. 102, datë 24.04.2023, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26.11.2019, është në tejkalim të afateve (rreth 4 vite pas fatkeqësisë natyrore) dhe konstatimi është kryer në kundërshtim me të Ligjit nr. 45/2019, neni 14, pika 3.

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertiza e thelluar është hartuar në kundërshtim me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “*Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore*”, neni 34 dhe VKM-në nr. 26, datë 15.1.2020, pika 5, pasi përveç të tjerave, nuk përmban përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje.

**9.** Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se **në 5 raste**, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht: Vendimet nr. 32, datë 06.04.2022; nr. 50, datë 14.06.2022; nr. 6, datë 25.01.2023; nr. 52, datë 03.05.2023 dhe nr. 118 datë 15.11.2023 (të konfirmuara), **për dhënie prone për zhvillim** janë konfirmuar pa u shoqëruar me dokumentacionin që vërteton këshillimin me bashkësinë, dokumentacionin ligjor mbi regjistrimin e pronës (certifikatë pronësie), relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore si dhe pa procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

**10.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë me nr. 56, datë 06.07.2022 “*Për miratimin e listave të përfituesve të nën programit të grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4*” është miratuar megjithëse kërkesat e qytetarëve janë në tejkalim të afateve ligjore të parashikuara për të drejtën e ankimimit dhe nuk kanë si dokumentacion shoqëruar certifikatat e gjendjes familjare në datën 26.11.2019. Miratimi i listave nuk është shoqëruar me Procesverbalin e mbledhjes së këshillit bashkiak. Arsyet e rivlerësimit të 2 banesave, të shpjeguara në raportet nr. 18270, datë 20.05.2022 dhe nr. 23628, datë 24.06.2022 nga komisioni i posaçëm i ngritur, janë në kundërshtim me VKM-në nr. 5, datë 6.1.2020, Kreu IV “*Grantet për rikonstruksion*”, pika 19.

**11.** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se me shkresën nr. 1399/1 prot., datë 22.07.2022, nga Prefekti është miratuar Vendimi KB Tiranë nr. 71, datë 12.07.2022 “*Për kalimin në administrim të Agjencisë së Industrisë Kreative, të objektit “Kinema Agimi”, me nr. pasurie 2/106-n 20, zona kadastrale 8270, në pronësi të Bashkisë Tiranë*”, pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar.

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në lidhje me administrimin e debitorit; (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar). Qendra Kulturore Tirana në shkresën nr. 297, datë 16.06.2022 “*Informacion mbi objektin Kinema “Agimi”*”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, thekson se për Kinemanë “Agimi” është krijuar debitor

shoqëria “E.” deri në 31.12.2021, në vlerën 20,215,543 lekë të pasqyruar në bilancin e vitit ushtrimor 2021 në llogarinë 468 “debitorë të ndryshëm”, vlerë e cila në përfundim të kontratës në datë 09.02.2022 arrin në 22,219,621 lekë dhe për çdo ditë vonesë një kamatë ditore prej 1% të vlerës së qirasë.....”).

- Mungon procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, neni 54 dhe neni 55.

**12.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste për dhënie me qira**, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht Vendimi nr. 139, datë 23.12.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar” dhe Vendimi nr. 144, datë 23.12.2022 “Për miratimin e formës dhe procedurave për shfrytëzimin e ambienteve sportive të institucioneve arsimore publike para universitare, Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit “Shkolla Qendër Komunitare””, (të konfirmuara), për **periudhë të përkohshme përcakton një afat 3 vjeçar**, por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, projektvendimin dhe relacionin shpjegues.

**13.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, **për transferim prone** konkretisht Vendimi nr. 109, datë 15.11.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të një pjese të pasurisë me nr. 7/662, zona kadastrale 8170, me sipërfaqe prej 529 m<sup>2</sup>, që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e zhvillimit ekonomik, si dhe shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”; Vendimi nr. 19 datë 06.04.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 150, zona kadastrale 3517, me emërtimin “grup depo rep. usht. 8837, me vendndodhje në Stërmas”, me qëllim ngritjen e një qendre grumbullimi (strehëz) për kafshët endacake”” dhe Vendimi nr. 24 datë 17.03.2023 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme me numër pasurie 1/71, ZK 8150, tiranë, që do të përdoret në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”, janë konfirmuar pa marrë më parë miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe pa u shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak.

**14.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, **dhënie ndihmë emergjencë** konkretisht Vendimi nr. 128, datë 23.12.2022 “Për dhënien e ndihmës financiare për 16 (gjashtëmbëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit dhe përmbytjeve dhe dëmet ndërtimore në ambientet e përbashkëta të pallatit “Mesaplik 05”, ndërtesa Nr.4, në rrugën “Migjeni”, Lagjja Nr. 14.”. i cili ka miratuar fondin **3,245,423 lekë**; Vendimi nr. 51 datë 03.05.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 7 (shtatë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 2 raste, zjarre 4 raste dhe përmbytje 1 raste në vlerë totale 5,397,301 lekë); Vendimi nr. 86 datë 20.07.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 29 (njëzet e nëntë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 11 raste, zjarre 13 raste dhe përmbytje 5 raste në vlerë totale 11,757,572 lekë), janë konfirmuar në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 329, datë 16.5.2012, Kreu III, pika 1, germa b, ç, d dhe e.

**15.** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë **për sipërmarrje dhe dhënie me qira**, konkretisht Vendimi nr. 40 datë 19.04.2023 “Për miratimin në parim të dhënies me qira, me konkurrim, të një sipërfaqeje prej 1284 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me nr. 8/72, zona kadastrale 8270, me emërtim “Akuadromi i Tiranës”” dhe

Vendimi nr. 100 datë 15.09.2023 “Për miratimin e projektit “Sipërmarrja ime për shkollën” hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”, janë konfirmuar në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, neni 54 dhe neni 55, pikat 3 dhe 4; VKM nr. 469, datë 03.06.2015, pika 3; si dhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020, aneksi nr. 1, neni 4, pikat b dhe c.

16. Nga auditimi mbi veprimtarinë e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara u konstatua se për vitet 2022-2023, gjatë kryerjes së funksioneve në marrëdhëniet me institucionet qendrore në qark, Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk ka ushtruar përgjegjësitë e monitorimit dhe kontrollit.

Gjithashtu, nga ana e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk është kryer monitorimi i veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve që veprojnë në nivel qarku.

## II. HYRJJE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 561/1, datë 31.05.2024 “Auditim Përputhshmërie në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë”, i ndryshuar me shkresat nr. 561/2, datë 25.06.2024 dhe nr. 561/3 prot., datë 11.07.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë”, nga data 20.02.2024 deri në datën 19.04.2024, u krye “Auditimi i Përputhshmërisë”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2023 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J.P., Përgjegjës Grupi;
2. A.Ç.
3. A.M. dhe
4. F.Ç., anëtarë.

### **Objekti dhe qëllimi i auditimit:**

Objekti i auditimit të përputhshmërisë synon dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

### **Identifikimi i çështjes:**

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse



të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e *Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë*.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Prefekti i Qarkut Tiranë, z. A.Q., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. B.L., Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e Qarkut*”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, etj.

### **Përgjegjësitë e audituesve:**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin e grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat

Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

### **Kriteret e vlerësimit:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të Mbrojtjes Civile”;
- VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Urdhëri i Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të Administratës së Prefektit të Qarkut”;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 07, datë 17.01.2024;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Institucionit të Prefektit, etj.
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

### **Standardet e auditimit:**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së;
- Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

### **Metodat e auditimit:**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku;

Intervista;

Raporte dhe Informacione.

### **Dokumentimi i auditimit:**

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**


### **1. Informacion i përgjithshëm mbi Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë**

#### **Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik**

**Zona Gjeografike:** Qarku i Tiranës shtrihet në një zonë gjeografike interesante dhe me një natyrë ku lehtësisht identifikohen diversiteti dhe potencialet e shumta turistike. Gjendet në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme tokësore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, me fushë të gjerë pjellore, të rrethuar me kodra dhe male të veshura me pyje, me pasuri të shumta hidrike, klimë të përshtatshme për zhvillimin bujqësor dhe urban, me dalje në det dhe burime të shumta turistike.

**Produkti i Brendshëm Bruto:** Sipas publikimit të realizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (2010), struktura e PBB-së e Qarkut të Tiranës është e ndarë sipas sektorëve: shërbime & tregti (46.4%); bujqësi (20.7%); ndërtim (14.3%); industri (9.7%).

**Turizmi:** Turizmi malor gjen një terren për t’u zhvilluar në sajë të Malit të Dajtit me Parkun Kombëtar, me një sipërfaqe prej 23,374 ha. Turizmi detar zhvillohet në zonat bregdetare të Golemit, Spillesë, Karpenit, etj. Zhvillimi i turizmit të biznesit dhe



konferencave është i lartë, për shkak të përqëndrimit të institucioneve qeveritare, joqeveritare, shoqatave ndërkombëtare etj, si dhe zinxhirëve të njohur hotelierë si: Sheraton, Plaza, Tirana International etj, të cilët ofrojnë mundësinë e zhvillimit të kongreseve, konferencave, seminareve dhe aktiviteteve të tjera, sipas standardeve ndërkombëtare.

**Arsimi/Tregu i Punës:** Qarku i Tiranës përbën qarkun më të arsimuar, pasi ka numrin më të lartë të institucioneve arsimore si dhe numrin më të lartë të nxënësve dhe studentëve në Shqipëri. Gjithashtu Qarku i Tiranës përbën tregun më të madh të punës dhe ka nivelin më të ulët të papunësisë në Shqipëri.

**Kultura:** Qarku i Tiranës është një muze i hapur i historisë së vjetër dhe të re të Shqipërisë. Ai mbart një histori të lashtë, e cila përbëhet kryesisht nga kultura ilire, nga kalatë e shumta që kanë vlera të mëdha historike. Qarku i Tiranës ka 183 monumente kulture të shpallura, prej të cilave, 168 ndodhen në rrethin e Tiranës dhe 15 në rrethin e Kavajës.

**Transporti:** Qarku i Tiranës konsiderohet një qark me ritme të larta sociale, ekonomike dhe shoqërore. Qarku i Tiranës lidhet me qarqet e tjerë, duke qënë nyja kryesore e transportit rrugor, hekurudhor dhe ajror.<sup>1</sup>

**Bashkitë dhe Njësitë Administrative (ish-komunat):**

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Bashkia Tiranë</b>	Qyteti i Tiranës: Njësia Bashkiake nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11. Ish komunat: Njësia Administrative Petrelë, Farkë, Dajt, Zall Bastar, Zall Herr, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq.
<b>Bashkia Kamzë</b>	Njësia Administrative Kamzë/Qytet dhe Paskuqan
<b>Bashkia Vorë</b>	Njësia Administrative Vorë/Qytet, Prezë dhe Bërxullë
<b>Bashkia Kavajë</b>	Njësia Administrative Kavajë/Qytet, Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas
<b>Bashkia Rrogozhinë</b>	Njësia Administrative Rrogozhinë/Qytet, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë

**Forma dhe mënyra e organizimit:**

Struktura dhe organika e Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 6, datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut të Tiranës”. Struktura ka të përcaktuar nivelet hierarkike

<sup>1</sup> Burimi: <https://prefektitirane.gov.al/ep-content/uploads/2017/10/Prefekti-i-Qarkut-Tiran%C3%AB.pdf>

dhe linjat e raportimit ndërsa organika numrin e punonjësve sipas pozicionit, në total 31 punonjës. Krahas sa mësipër, institucioni ka punësuar 3 punonjës me kontratë të përkohshme.

### **Kuadri ligjor:**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë funksionon në bazë të ligjit nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitutional të institucioneve dhe të strukturave të Mbrojtjes Civile”, Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Institucionit të Prefektit, etj.

Prefekt i Qarkut Tiranë është z. A.Q., emëruar me Vendim të Këshillit të Ministrave në datën 18.11.2021.

## **2. Përshkrimi i rezultateve, sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të vitit 2022-2023.**

#### ***Programimi dhe realizimi i buxhetit vjetor:***

Nga auditimi i procedurave të hartimit të buxhetit për periudhën e audituar, u konstatua se projektbuxheti për vitin 2022 dhe 2023, është hartuar në zbatim të kërkesave të ligjit organik nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse të zbatimit të buxhetit të shtetit (UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe ligjeve dhe udhëzimeve plotësuese të zbatimit të buxhetit vjetor respektiv (ligjit nr. 115, datë 25.11.2021 dhe nr. 84, datë 24.11.2022, “Për buxhetin e vitit 2022 dhe 2023”).

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe afatmesëm, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve dhe zyrave, por për planifikimin e buxhetit vjetor, kryesisht është marrë si bazë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës. Mbi bazën e dokumentacionit të grumbulluar, Nëpunësi Zbatues i institucionit ka plotësuar të gjitha pasqyrat shoqëruese “Tip” të projekt buxhetit për programet që menaxhohen nga njësia shpenzuese “Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë”. Këto pasqyra financiare, së bashku me relacionet sqaruese për zërat e shpenzimeve, janë konfirmuar nga drejtuesi i njësisë shpenzuese, (Nëpunësi Autorizues) dhe i janë dërguar Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse (Drejtorisë së Financave) në MB.

Programet buxhetore afatmesme (PBA) 2023-2025 dhe 2024-2026, janë përgatitur nga institucioni qendror, Ministria e Brendshme.

Mbi bazën e shkresave të akordimit të fondeve, është bërë detajimi buxhetit sipas artikujve dhe nënartikujve në zbatim të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe UMB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”.

#### ***Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative:***

Akordimi fillestar i buxhetit për vitin 2022, është dërguar me shkresën e MB nr. 10084/4 prot., datë 27.01.2022. Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga institucioni qendror MB, është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2022. Akordimi fillestar i buxhetit për vitin 2023, është dërguar me shkresën e MB nr. 12851/20 prot., datë 30.01.2023. Mbi bazën e

buxhetit të dërguar nga MB, është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2023.

Për institucionin e Prefektit Tiranë, përfshirë edhe Gjendjen Civile në total (për artikujt 600, 601, 602, 606), është miratuar fondi 42,462 mijë lekë për vitin 2022 dhe 42,517 mijë lekë për vitin 2023.

Fondet e akorduara sipas zërave buxhetorë, në mijë lekë, janë paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela B1.

Sa i përket ndryshimeve të zërave buxhetorë të ndodhura gjatë periudhës objekt auditimi, rezultoi se, ndryshimet (shtesa ose pakësime), janë të regjistruara e të rakorduara me degën e thesarit të rrethit dhe janë të raportuara periodikisht në institucionin qendror MB. Për çdo ndryshim të zërave të buxhetit, në shtesë apo në pakësim, bashkëlidhur janë shkresat e institucionit qendror, për ndryshimin e buxhetit. Detajimi i buxhetit, është bërë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit të MB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”.

Për miratimin e përdorimit të fondit të veçantë, nga njësia shpenzuese Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, janë bërë kërkesa, të cilat pasi janë shqyrtuar dhe miratuar nga MFE, janë dërguar për veprim në institucion nëpërmjet MB. Detajimi i buxhetit, është bërë në zbatim të kërkesave të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit të MB nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e MB”.

Situacionet e shpenzimeve mujore dhe progresive që ka bërë institucioni, janë plotësuar sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planin financiar dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Fondet e akorduara në planin financiar dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, për vitin 2022 dhe 2023, sipas nivelit të fondeve në mijë lekë dhe ndryshimeve shkresore, janë paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabelat B2 dhe B3.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikujt dhe nënartikujt është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe ndryshimet e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit.

Analiza e realizimit të buxhetit është bërë mbi bazën e urdhër-shpenzimeve të plotësuar, miratuara, kontrolluara, likuiduara dhe të regjistruara në librat e llogarisë, konform klasifikimit buxhetor. (*ditari shpenzimeve*). Konfirmimi i urdhërpagesave është bërë nga nëpunësit autorizues dhe zbatues, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

### ***Realizimi i shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:***

**Për vitin 2022**, njësisë shpenzuese “*Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë*”, i janë akorduar fonde buxhetore në total për të gjithë artikujt buxhetorë në shumën 40,037,875 lekë, të cilat janë detajuar e miratuar si më poshtë:

**1.** Shpenzimet vjetore të planifikuara në artikullin 600 “*Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli*”, janë në masën 28.045,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2022, janë bërë shtesa në shumën 40,000 lekë në programin e gjendjes civile, pakësime në shumën 2,164,625 në programin e administratës dhe plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 25,920,375 lekë.

**2.** Në artikullin 601 “*Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*”, planifikimi fillestar i fondit është në shumën 5,118,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin 2022, ka patur

pakësime në vlerën 110,000 lekë në programin e administratës, pra plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 5,008,000 lekë.

**3.** Për artikullin e shpenzimeve 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*”, për vitin 2022 është akorduar fondi vjetor në masën 9,299,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2022, ka patur pakësime në vlerën 900,700 lekë në programin e administratës dhe shtesa në shumën 111,000 lekë në programin e gjendjes civile. Plani me ndryshime në fund të vitit është 8,509,300 lekë.

**4.** Për shpenzimet e artikullit 606 “*Transferta për buxhetet familjare dhe individët*”, është akorduar fondi fillestar për vitin 2022 në masën 541,000 lekë. Gjatë vitit buxhetor, janë bërë shtesa dhe pakësime (-82,000, -211,800, -82,000, -115,000, +520,000, +30,000). Plani me ndryshimet për vitin buxhetor 2022 është në shumën 600,200 lekë.

**5.** Për artikullin e investimeve 231 nuk ka pasur fonde të akorduara për vitin 2022.

Për vitin buxhetor 2022, nuk ka pasur shtesa apo pakësime të tjera të buxhetit fillestar. Realizimi i buxhetit për këtë vit është në masën 95,93% ose në vlerën 38,407,475 lekë nga 40,037,875 lekë që është plani vjetor i ndryshuar:

Realizimi i buxhetit për vitin 2022, për Institucionin e Prefektit Tiranë, është paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela B4, nga ku u konstatua se nuk ka tejkalim të zërave të shpenzimeve.

**Për vitin 2023**, njësisë shpenzuese “*Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë*”, i janë akordur fonde buxhetore në total për të gjithë artikujt buxhetorë në shumën 54,117,200 lekë, të cilat janë detajuar e miratuar si më poshtë:

**1.** Shpenzimet vjetore të planifikuara në artikullin 600 “*Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli*”, janë në masën 28,784,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2023, janë bërë shtesa dhe pakësime në vlerat (+10,000,000, +476,000, - 1,000,000; +257,400) lekë dhe plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 38,517,400 lekë.

**2.** Në artikullin 601 “*Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore*”, planifikimi fillestar i fondit është në shumën 5,233,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin 2023, ka pasur shtesa në shumën (+1,000,000, +92,000, +637,000) lekë dhe plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 6,962,000 lekë.

Shtesat në zërin e shpenzimeve “*Paga, sigurime dhe shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli*”, është bërë kryesisht për shkak të ndryshimit të VKM-së për llogaritjen e pagave të punonjësve të institucionit.

**3.** Për artikullin e shpenzimeve 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*”, për vitin 2023 është akorduar fondi vjetor në masën 8,500,000 lekë. Për këtë artikull, për vitin buxhetor 2023, ka patur shtesa dhe pakësime në shumën (-40,000, +58,200) lekë. Plani me ndryshimet për këtë zë shpenzimesh është në shumën 8,518,200 lekë.

**4.** Për shpenzimet e artikullit 606 “*Transferta për buxhetet familjare dhe individët*”, është akorduar fondi fillestar për vitin 2023 në masën 470,000 lekë. Gjatë vitit buxhetor, janë bërë pakësime në shumën 350,400 lekë dhe plani me ndryshimet për vitin buxhetor 2023 është në shumën 119,600 lekë.

Për vitin buxhetor 2023, nuk ka pasur shtesa apo pakësime të tjera të buxhetit fillestar. Realizimi i buxhetit për këtë vit është në masën 89.49% ose në vlerën 48,432,897 lekë nga 54,117,200 lekë që është plani vjetor i ndryshuar.

Realizimi i buxhetit për vitin 2023, për Institucionin e Prefektit Tiranë, është paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela B5, nga ku u konstatua se nuk ka tejkalim të zërave të shpenzimeve.

***Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Vlerësimi i risqeve buxhetore:***

***- Raportimi i zbatimit të buxhetit:***

Nga auditimi i kryer, rezultoi se nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, janë përpiluar çdo muaj dhe në mënyrë progresive, situacionet e zbatimit të buxhetit. Këto situacione, janë të përpiluara nga ana e Nëpunësit Zbatues dhe janë të konfirmuara nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike. Të gjitha situacionet (mujore dhe progresive), janë të konfirmuara nga Dega e Thesarit të rrethit.

- Auditimi i sistemit të pagesave nëpërmjet bankës:

U audituan hap pas hapi veprimet me bankë për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2023, të cilat janë të dokumentuara me urdhër pagesat përkatëse, të nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues dhe titullari i institucionit, si dhe të konfirmuara me nënshkrimin e punonjësit dhe të vulosura nga Dega e Thesarit të rrethit Tiranë. Nga periudha 16 shtator 2022 e në vazhdim, urdhër shpenzimet nënshkruhen elektronikisht nga Regjistruesi, Nëpunësi Zbatues, Nëpunësi Autorizues dhe Specialistja e Degës së Thesarit në sistemin elektronik webportal.

Për të gjithë periudhën e auditimit nëpërmjet thesarit dhe bankave të nivelit të dytë janë kaluar e likuiduar shpenzime të ndryshme të klasifikuara sipas llogarive buxhetore, fonde të akorduara të cilat sipas viteve janë: 38,407,475 lekë në vitin 2022 nëpërmjet 218 urdhër shpenzimeve dhe 48,432,897 lekë për vitin 2023 nëpërmjet 212 urdhër shpenzimeve.

Urdhër shpenzimet (pagesat) kanë bashkëlidhur dokumentacionin justifikues. Regjistrimi i transaksioneve në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve është bërë në mënyrë elektronike sipas kronologjisë së veprimeve ekonomike dhe vlerat e regjistruara në llogari për çdo fund periudhe mujore janë të kuadruara si për llogaritë debitore dhe ato kreditore. Për çdo fund periudhe mujore, shuma e shpenzimeve të regjistruara të likuiduara është e kuadruar me ditarët analitikë të llogarive.

Vlera e urdhër shpenzimeve të likuiduara përputhet me vlerën e detyrimit për shërbimet dhe mallrat e përfutuara. Urdhër shpenzimet janë përpiluar me numër rendor kronologjik dhe janë të regjistruara rregullisht në kontabilitet (ditarët e llogarisë).

Nga auditimi i ditarit të transaksioneve me bankën dhe ditarit të shpenzimeve, rezultoi se janë mbajtur në rregull dhe janë përditësuar të gjitha urdhër shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën. Ditari është i kuadruar për të gjithë llogaritë e shpenzimeve, konform planit të shpenzimeve të miratuara.

Shpenzimet e likuiduara nëpërmjet bankës përputhen me shpenzimet e paraqitura në situacionin vjetor të shpenzimeve të konfirmuara në Degën e Thesarit të rrethit Tiranë, i cili është i kuadruar edhe sipas shpenzimeve në artikujt kryesor; 600 “Paga shpërblime personeli”, 601 “Sigurime Shoqërore”, 602 “Shpenzime operative”, 606 “Transferta”.

Urdhër pagesat ishin të plotësuara me të gjitha të dhënat e kërkuara në formularin “Tip” të miratuar, kishin bashkëlidhur dokumentacionin justifikues sipas natyrës së shpenzimit si dokumentacionin e procedurës së prokurimit, kontratën, faturën tatimore të shitjes, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit dhe të shërbimit, fletëhyrjen e magazinës, etj. Dokumentacioni justifikues dhe mbështetës i pagesave ishte i plotë dhe i bazuar në aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Për periudhën e audituar (2022 dhe 2023) sipas natyrës së akordimit të fondeve (klasifikimit buxhetor) institucioni ka shpenzuar vlerat si më poshtë;

**Për vitin 2022**, në total janë shpenzuar (likuidime nëpërmjet bankës e thesarit) 38,407,475 lekë të ndara për: Paga personeli (Artik. 600) në shumën 22,795,306 lekë për institucionin e Prefektit dhe 2,333,757 lekë për Gjendjen Civile, Sig. Shoqërore (Artik. 601) në shumën 3,813,689 lekë për institucionin e Prefektit dhe 389,454 lekë për Gjendjen Civile, mallra e shërbime (Artik. 602) shuma 8,387,594 lekë për institucionin e prefektit dhe 111,000 lekë për Gjendjen Civile, Transferta (Artik. 606) shuma 546,675 lekë për institucionin e Prefektit dhe 30,000 lekë për Gjendjen Civile.

**Për vitin 2023**, në total janë shpenzuar (likuidime nëpërmjet bankës e thesarit) 48,432,897 lekë të ndara për: Paga personeli (Artik. 600) në shumën 31,095,112 lekë për institucionin e



Prefektit dhe 2,975,057 lekë për Gjendjen Civile, Sig.Shoqërore (Artik. 601) në shumën 5,683,788 lekë për institucionin e Prefektit dhe 509,696 lekë për Gjendjen Civile, mallra e shërbime (Artik. 602) shuma 8,022,644 lekë për institucionin e prefektit dhe 58,200 lekë për Gjendjen Civile, Transferta (Artik. 606) shuma 88,400 lekë për institucionin e Prefektit.

- Auditimi i shpenzimeve të funksionimit të institucionit:

Në fondet e akorduara në artikullin 602 dhe të shpenzuara, përfshihen edhe fondet për funksionimin e institucionit të cilat janë për shpenzime të ruajtjes fizike, energjisë elektrike, ujit, telefon, posta dhe internet. Për këto shpenzime likuidimi është bërë çdo muaj, vlera është e rakorduar me faturat e lëshuara nga operatorët për konsumin real të shpenzuar nga institucioni, sipas aparateve matëse. Për të gjitha likuidimet e kryera nga insitucioni për shpenzimet operative, nga dega e thesarit është bërë konfirmimi i urdhër shpenzimeve. Nga auditimi i bërë urdhër shpenzimeve për likuidimin e faturave për shpenzimin e energjisë elektrike, shpenzimet telefonike, etj, nuk ka kamatëvonesa të aplikuara apo likuiduara. Pra fondet e akorduara janë shpenzuar sipas planifikimit vjetor të shpenzimeve.

Urdhër shpenzimet për likuidimin e shpenzimeve për vitet 2022-2023 janë të konfirmuar nga Nëpunësi Autorizues, Prefekti z. A.Q. dhe Nëpunësi Zbatues, z. B.L.. Ndërsa nga data 15 shtator 2022 janë të nënshkruara edhe nga regjistrueset M.M. dhe E.J. sipas rasteve të ndryshme.

Institucioni për vitet 2022 dhe 2023 ka planifikuar fondin për “*Shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të Institucionit të Prefektit*”, shërbim i cili është kontraktuar dhe realizuar me shoqërinë “*I.G. ShA*”, bazuar në VKM nr. 177, datë 04.04.2019 dhe tarifat e shërbimit të miratuara në udhëzimin e përbashkët nr. 407/1, datë 14.06.2019, likuidimet mujore për këtë shërbim janë kryer të rregullta sipas faturave mujore të lëshuar nga shoqëria.

Auditimi i trajtimit të punonjësve me paga e të ardhura të tjera:

Struktura dhe organika e Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 6, datë 12.01.2016 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut të Tiranës*”. Struktura ka të përcaktuar nivelet hierarkike dhe linjat e raportimit ndërsa organika numrin e punonjësve sipas pozicionit, në total 31 punonjës: titullari i institucionit (1), sekretar (1), Nënprefekt (1), Sekretar i Përgjithshëm (1), sektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara (7), sektori i zhvillimit urban (3), sektori i planifikimit, përbalimit të emergjencave civile dhe krizave 4,, sektori juridik 4, sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse (9). Për vitin 2022 në zbatim të VKM nr. 35, datë 19.01.2022 “*Për përcaktimin e numrit të punonjesve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njesitë e qeverisjes qendrore*”, Institucioni ka punësuar 3 punonjës me kontratë të përkohshme. Për vitin 2023 në zbatim të VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “*Për përcaktimin e numrit të punonjesve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njesitë e qeverisjes qendrore*”, Institucioni ka punësuar 3 punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga auditimi, rezultoi se në datën 31 dhjetor 2023 organika është e plotësuar (Specialiste Juriste E.Sh. është shpallur fituese por emërimin e ka marrë më 5.01.2024)

Lëvizjet e punonjesve (emërimet/largimet) janë paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela B6.

Për vitin 2022 janë emëruar 10 punonjës dhe larguar 8 punonjës në total. Për vitin 2023 janë emëruar 4 punonjës dhe larguar 7 punonjës në total. Nga auditimi i dosjeve të personelit, rezultoi se dosjet ishin të organizuara dhe të plotësuara me dokumentat përkatës në zbatim të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrimit Qëndror të Personelit*”. Dosja teknike e punonjësit kishte fletën e inventarit të dosjes së punonjësve me listen e dokumentave përkatëse që dosja përmban (kopje ID, CV, librezë pune, raportin e aftësisë për punë, diplomë etj.), si dhe fletën e prezantimit të dosjes teknike të punonjësit (gjeneralitetet, pozicioni i punës, paga, arsimi, kualifikimet etj.). Lista e dokumentave në dosje është organizuar duke respektuar

Vendimin nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qëndror të Personelit”.

Për periudhën objekt auditimi, me përzgjedhje u auditua dokumentacioni i trajtimit të punonjësve me paga, shtesa mbi pagë, përlllogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat, sigurimi suplementar etj.

Nga auditimi rezultoi se listëpagesa përpilohej mbi bazën e listëprezencave. Listëprezencat janë hartuar nga specialistja e burimeve njerezore në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, mbështetur në listëprezencat e bëra nga çdo përgjegjës sektori. Në listëprezencë është evidentuar prezenca në punë e punonjësve apo të dhëna mbi arsyet e mosprezencës (me leje të zakonshme, me raport mjekësor etj.), e cila është nënshkruar edhe nga Nëpunësi Zbatues. Nga auditimi i kryer për rakordimin listëpagesave me përmbledhësen e listëpagesave, rezultoi se ato rakordojnë dhe shuma neto e përmbledhëses së listëpagesës, është e barabartë me shumën e urdhërpagesës. Në listëpagesat e çdo muaji, për çdo punonjës janë evidentuar pagat bazë, shtesat për funksion, vjetërsia, shtesa për vështiresi, si dhe janë llogaritur dhe ndaluar detyrimet si tatimi mbi të ardhurat personale, përqindja e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kontributi suplementar dhe çdo ndalesë tjetër. Listëpagesa është hartuar nga specialisti i financës dhe është miratuar nga përgjegjësi i sektorit të financës, ndërsa përmbledhësja e listëpagesës është firmosur nga përgjegjësi i sektorit të financës, firmosur e vulosur nga titullari i institucionit. Paga e detyrimeve për llogari të Tatim Taksave është bërë brenda afateve kohore.

Pagesa e punonjësve të Aparatit të Prefektit, për periudhën 1 janar 2022 deri 31 mars 2023 është bërë në zbatim të Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar. Pas kësaj periudhe pagat janë llogaritur sipas Vendimit nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Aktualisht trajtohen pagë për funksion politik dy pozicione, ai i Prefektit të Qarkut Tiranë me 205,000 lekë dhe Nënprefektit të Kavajës, me 170,000 lekë; pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Përgjegjësit e Sektorit janë trajtuar me pagë grupi 14,000 lekë (DND); specialist prefekturë me pagë grupi 14,000 lekë, me pagë grupi 12,000 lekë (master profesional) dhe me pagë grupi 10,000 lekë (bachelor). Trajtimi i punonjësve për vjetërsi në punë, është kryer duke i verifikuar vitet e punës në librezë për çdo punonjës. Nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pagesa për vjetërsi është kryer vite pune herë 2% të pagës bazë për çdo vit pune për periudhën deri me 31 mars 2023 dhe sipas tabelës përkatëse të VKM-së së re.

Pagesa e punonjësve mbështetës, është bërë në bazë të VKM nr. 234, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore të ndryshuar me VKM-të nr. 234 datë 20.04.2022 dhe nr. 326 datë 31.05.2023””. Janë trajtuar me pagë punonjësit mbështetës të cilët kanë përfituar pagë sipas klasave dhe shtesës për vjetërsi si dhe shtesa vështirësie.

Përlllogaritja e vjetërsisë së punonjësve mbështetës është kryer duke i verifikuar vitet e punës në librezë për çdo punonjës, herë 1% të pagës bazë për çdo vit pune.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat janë llogaritur në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në listëpagesa, për çdo punonjës, janë evidentuar ndalesat për tatimin mbi të ardhurat dhe janë bërë rregullisht xhirimet e këtyre detyrimeve në buxhetin e shtetit.

U audituan ndalesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe rezultoi se ato kryhen në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Listëpagesat, në pjesën e ndalesave, kanë pasqyruar ndalesat mujore për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare (pagesa për sigurimin suplementar bëhet për prefektin, n/prefektin dhe sekretarin e pergjithshëm) si dhe tatimin mbi të ardhurat që paguhen nga punëmarrësit. Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare që paguhen nga punëmarrësi, është bërë e saktë, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe janë bërë rregullisht xhirimet e këtyre detyrimeve në buxhetin e shtetit. Pagesat e detyrimeve janë bërë brenda afateve kohore.

### ***Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre:***

#### ***Të ardhurat nga shitja e pullave të Gjendjes Civile:***

Të ardhurat e krijuara nga shitja e pullave në total për 1,408,300 lekë, përfaqëson vlerën e pullave të Gjendjes Civile të furnizuara nga DP e Tatimeve dhe të xhiruara nga Dega e Thesarit të rrethit Tiranë për llogari të tatim taksave. Procedura për furnizimin dhe arkëtimin e vlerës së pullave është e dokumentuar me “Faturën për arkëtim”, të hartuar nga Nëpunësi Zbatues i institucionit, në përputhje me pikën 197 dhe pikën 200 të Udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Për periudhën e auditimit 2022 dhe 2023, Institucioni i Prefektit është furnizuar me pullat e Gjendjes Civile nga Dega e Tatim Taksave Tiranë dhe ka furnizuar me pulla dy zyrat e Gjendjes Civile (Tiranë dhe Kavajë) me dokumentacion të rregullt. Sektori i financës për të dy zyrat e gjendjes civile si dhe me degën e tatimeve për çdo fund periudhe, ka rakorduar të ardhurat duke mbajtur rregullisht aktin e rakordimit.

Arkëtimi i vlerës së pullave është dokumentuar me mandat arkëtimi nga punonjësit e zyrës së gjendjes civile sipas faturës për arkëtim të sektorit të financës dhe vlera e faturës për arkëtim është e rakorduar me nxjerrjen nga thesari të llogarisë për çdo muaj.

Pullat e furnizuara nga Dega e Tatimeve janë marrë hyrje në institucion dhe janë bërë dalje Gjendjes Civile Tiranë e Kavajë.

Gjendja e pullave të tërhequra dhe shpërndara nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë për vitet 2022 dhe 2023, është paraqitur në Aneksin 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabelat B6 dhe B7.

Vlerat e paraqitura sipas zyrave të Gjendjes Civile janë të rakorduara për vlerat mujore të arkëtimeve dhe të rakorduara për gjendjen në fund të periudhës me këto zyra nëpërmjet aktit të rakordimit të konfirmuar mes palësh si dhe janë të pasqyruara edhe në pasqyrën vjetore të të ardhurave si në bilancin e vitit 2022 dhe atë 2023 (për vlerat respektive 144,000 dhe 319,700 lekë gjendje).

Në këtë zë të ardhurash institucioni ka të drejtën e pjesmarrjes në masën 5% të vlerës së arkëtuar në zbatim të UMF nr. 27, datë 16.12.2014, ndërkohë që institucioni vlerën e realizuar nga shitja e pullave nuk e ka përdorur me autorizim rritje buxhetore, por e ka xhiruar 100% në buxhetin e shtetit.

***Verifikimi i masave të programit të emergjencave dhe mbrojtjes civile për masat e marra për fatkeqësitë natyrore si tërmetet, përmbytjet, dëmtimet nga zjarri, vlerësimet e dëmeve nga fatkeqësitë e ndryshme për përmirësimin e cilësisë jetës njeriut duke promovuar përvojat më të përparuara dhe shërbime të sigurta dhe efikase).***

Struktura përgjegjëse për emergjencat dhe mbrojtjen civile pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë është Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave (SPPECK), i cili funksionon bazuar në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”. SPPECK në fillim të çdo viti harton “Planin e punës vjetor” dhe mbi bazën e tij harton planet mujore.

- Gjatë vitit 2022-2023 SPPECK ka hartuar planet e masave me shkresat nr. 266 prot., datë 15.02.2022 dhe nr. 123 prot., datë 24.01.2023, “Plani i Qarkut Tiranë për Mbrojtjen Civile”;
- Janë miratuar planet vjetore dhe mujore të punës për vitet 2022 dhe 2023;
- Me shkresat nr. 267 prot., datë 15.02.2022 dhe nr. 124 prot., datë 25.01.2023 janë miratuar “Dokumentet e Vlerësimit, Menaxhimit të Riskut për Qarkun Tiranë”;
- Janë mbajtur takime të vazhdueshme me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Institucionet që janë pjesë e KMCQ, duke informuar në mënyrë konstante për situatën në territorin e Qarkut Tiranë;
- Gjatë muajit tetor është organizuar mbledhje me qëllim marrjen e masave për emergjencat sezonale në periudhën vjeshtë-dimër 2022-2023 dhe është hartuar plani i masave me shkresën nr. 1873 prot., datë 11.10.2022 “Mbi masat që duhen marrë për parandalimin, mbrojtjen dhe përballimin e situatave emergjente (vjeshtë-dimër 2022-2023)”;
- Gjatë vitit 2023 janë kryer takime të komisionit të mbrojtjes civile në lidhje me masat që duhen marrë për të përballuar emergjencat e mundshme, gjithashtu ka korrespondenca me AKMC për marrjen e masave paraprake;
- Me shkresën nr. 267/1 prot., datë 15.02.2022 është miratuar Regjistri i zonave me risk në Qarkun Tiranë;
- Gjatë vitit 2023, janë hartuar kryesisht plane, seminare, trajnime dhe monitorimin e situatave të emergjencave lokale si zjarre dhe izolimin nga dëbora, si dhe takime të vazhdueshme me bashkitë ose inspektime në terren;
- Në takimet e organizuara nga SPPECK janë hartuar plane për emergjencat e zjarreve, emergjencat sezonale dhe përmbytjet. Gjithashtu janë bërë seminare, workshop-e dhe trajnime në kuadrin e projekteve dhe mbështetjes së bashkive.

## **2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve për periudhën 01.01.2022 -31.12.2023.**

***Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);***

***Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimin i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve;***

Prefektura Tiranë ka programuar sipas nevojave të Institucionit, duke hartuar regjistrin e parashikimeve të prokurimit, dhe gjatë periudhës objekt auditimi ka realizuar prokurime gjithsej 27 procedura gjithsej. Nga prokurimet e realizuara ka kryer në 3 raste “Blerje në vlera të vogla”.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e strukturave përkatëse të Prefekturës, në çdo rast janë paraqitur kërkesat për nevoja për mallra dhe shërbime të ndryshme.

Njësia e prokurimit ka argumentuar fondin limit me tre operatorë ekonomikë duke mbajtur procesverbalin për secilin Operator Ekonomik me çmimet e mallrave apo shërbimeve të kërkuara. Në urdhër prokurimin për blerjet me vlera të vogla është përcaktuar sasia dhe natyra e blerjes së bashku me ftesën për ofertë për mallra dhe shërbime duke përcaktuar kriteret e përgjithshme e të veçanta si dhe i ka publikuar në sistem.

Për dokumentacionin e prokurimeve me vlera të vogla janë hapur dosje të veçanta të inventarizuara, si dhe një kopje e plotë e praktikave të prokurimeve me vlera të vogla i është bashkëlidhur si dokumentacion justifikues urdhër shpenzimeve të bankës për operatorët ekonomikë fitues. Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve të furnizuara

nga operatori ekonomik fitues sipas proces verbaleve kanë qenë në përputhje me sasinë cilësinë dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e tenderit. Mallrat ishin bërë hyrje në magazinë pas përfundimit të procesit të verifikimit.

### **Procedurat e vitit 2022:**

- Në vitin 2022, me shkresën nr. 64/1, datë 14.01.2022 është përcaktuar person përgjegjës për prokurimet znj. Y.Sh., ndryshuar me shkresën nr 52/2 prot. datë 23.03.2022 dhe person përgjegjës është caktuar z. H.Ll..

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me urdhërin nr. 5, i ndryshuar me urdhërin nr. 87 datë 23.03.2022, janë përcaktuar personat përgjegjës për Prokurimet (PPP), është ngritur komisioni i prokurimeve me vlera të vogla, i përbërë nga z. H.Ll., znj. E.K. dhe z. A.U., mbështetur në pikën 2 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “*Për përdorimin e procedurës e me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*”.

Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2022, nga verifikimi i SPE, është paraqitur në Aneksin 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela P1.

Procedurat e përzgjedhura për auditim, janë paraqitur në Aneksin 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela P2.

### **1. Riparimi i automjeteve të Institucionit**

Nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, drejtuar Komisionit të Prokurimit të blerjeve të vogla dhe miratuar nga Prefekti është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit, për “*Shërbim mirëmbajtje automjeteve*”, së bashku me listën e specifikimeve për kryerjen e mirëmbajtjes.

Nuk ka një strukturë të përcaktuar për hartimin e fondit limit por kjo detyrë i është ngarkuar sektorit të financës, nga i cili është hartuar fondi limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 355,367 lekë pa TVSh.

Me shkresën nr. 1931 datë 20.10.2022 ka dalë urdhër prokurimi nr. 240, datë 20.10.2022 për “*Shërbim mirëmbajtje mjete*” ku është përcaktuar edhe komisioni i përbërë nga z. H.Ll., znj. E.K. dhe z. A.U..

Kërkesat e paraqitura në ftesën për Ofertë me nr. 1931/1, datë 20.10.2022 janë pasqyruar në Aneksin 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela P3.

### **Zhvillimi i procedurës:**

Në sistem janë paraqitur 9 operatorë ekonomikë nga të cilët 5 janë skualifikuar për arsye se oferta e dhënë ka qenë mbi fondin limit. Janë kualifikuar B.M. me vlerë 317,800 lekë; A.M. me vlerë 339,000 lekë; L.S. me vlerë 342,000 lekë dhe B. me vlerë 346,600 lekë.

Në sistemin elektronik datë 28.10.2022, “*Njoftim për shpallje fituesi*” komisioni i Prokurimit me blerje të vogël për prokurimin me objekt “*Shërbim mirëmbajtje mjete*” ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik “B.M.” me ofertë në vlerë 317,800 lekë dhe 381,360 lekë me TVSh.

Nga auditimi i dokumentacionit të verifikuar rezultoi se Operatori Ekonomik fitues ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë si dhe në përputhje me përcaktimet e bëra.

Me urdhër nr. 296 prot., datë 19.12.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mjeteve pas shërbimit, i përbërë nga z. F.V. Kryetar, z. A.Xh. anëtar dhe z. F.D. anëtar, që me procesverbalin datë 19.12.2022 ka marrë në dorëzim mjetet pas shërbimit.

Me urdhër shpenzimin nr. 207, datë 23.12.2022 është bërë likuidimi i OE B.M. PF, me nr. NIPT L.....R në vlerën 381,360 lekë me TVSh, bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura elektronike e B.M. me nr. 232/2022 datë 19.12.2022 me vlerë totale 381,360 lekë me TVSh për riparimin e dy mjeteve të transportit.

### **2. Blerje bojëra për printer dhe fotokopje:**

Nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, (specialisti IT), drejtuar Komisionit të Prokurimit të blerjeve të vogla dhe miratuar nga Prefekti është bërë kërkesa për miratimin e fillimit të procedurës së prokurimit, për “*Blerje bojëra për printer dhe fotokopje*”, së bashku me listën e specifikimeve teknike.

Nuk ka një strukturë të përcaktuar për përcaktimin e fondit limit por kjo detyrë i është ngarkuar sektorit të financës, nga i cili është hartuar fondi limit bazuar në testimin e tregut, sipas mesatares së 3 ofertave të paraqitura, në vlerën 124,133 lekë pa TVSh.

Me shkresë nr. 1749 datë 22.09.2022 ka dalë urdhër prokurimi nr. 215, datë 22.09.2022 për “Blerje bojëra për printer dhe fotokopje” ku është përcaktuar edhe komisioni i përbërë nga z. H.Ll., znj. E.K. dhe z. A.U..

Kërkesat e paraqitura në ftesën për Ofertë me nr. 1749/1, datë 22.09.2022 janë pasqyruar në Aneksin 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela P4.

#### Zhvillimi i procedurës:

Në sistem janë paraqitur 12 operatorë ekonomikë nga të cilët 2 janë skualifikuar për arsye se oferta e dhënë ka qenë mbi fondin limit. Nga ana e njësisë së prokurimit është bërë vlerësimi i 10 operatorëve të kualifikuar dhe kanë rezultuar 3 OE me të njëjtën vlerë 62,500 konkretisht: “C.”; “A.P.” dhe “B.T.”. Në sistemin elektronik Operatorët Ekonomikë janë njoftuar për të marrë pjesë në short në ambientet e institucionit.

Në datën 29.09.2022 është mbajtur procesverbali i hedhjes së shortit, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik “B.T.”

Në sistemin elektronik datë 29.09.2022, “Njoftim për shpallje fituesi”, Komisioni i Prokurimit me blerje të vogël për prokurimin me objekt “Blerje bojëra për printer dhe fotokopje” ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik “B.T.” me ofertë në vlerë 62,500 lekë dhe 75,000 lekë me TVSh.

Nga auditimi i dokumentacionit të verifikuar rezultoi se Operatori Ekonomik fitues me nr. 1749/2, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë në përputhje me përcaktimet e bëra.

Me urdhër nr. 06 prot., datë 13.01.2022, të titullarit, është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit apo shërbimit i përbërë nga znj. M.M. Kryetar, znj. P.Q. anëtar dhe znj. A.S. anëtar, që me proces verbalin datë 06.10.2022 ka marrë në dorëzim mallrat.

Me urdhër shpenzimin nr. 168, datë 26.10.2022 është bërë likuidimi i OE B.T. me nr. NIPT L.....G në vlerën 75,000 lekë me TVSh. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura elektronike nr. 96/2022 datë 06.10.2022 me vlerë totale 75,000 lekë me TVSh për blerjen e bojërave. Malli është bërë hyrje sipas fletë hyrjes nr. 10 datë 06.10.2022.

#### 3. Blerje materiale pastrimi me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSh, blerje e drejtpërdrejtë:

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2022 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesës për materiale pastrimi dorëzuar në datë 18.11.2022 janë përcaktuar specifikimet dhe sasia “Për blerje materiale pastrimi”.

Njësia e prokurimit ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me urdhërin nr. 5 i ndryshuar me urdhërin nr. 87 datë 23.03.2022, ka kryer testimin e tregut dhe ka mbajtur procesverbal mbi përcaktimin e çmimeve të tregut dhe kërkesën drejtuar Operatorit Ekonomik me çmimin më të ulët. Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve ngritur sipas Urdhërit nr. 6, datë 13.01.2022 ka kryer verifikimin e mallrave dhe marrjen në dorëzim të tyre pasqyruar në procesverbalin datë 24.11.2022

Me urdhër shpenzimin nr. 200, datë 06.12.2022 është bërë likuidimi i Operatorit Ekonomik “J.” shpk në vlerën 61,875 lekë. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr. 200, datë 06.12.2022, fatura e OE nr. 385872612/2022 datë 24.11.2022, fletë hyrja nr. 14 datë 24.11.2022 me vlerë totale 61,785 lekë vlefte e artikujve në fletë hyrje është me TVSh. Proces verbali i marrjes në dorëzim të mallit datë 24.11.2022.

#### 4. Blerje kancelari dhe distinktivë identifikimi të plastifikuara me logon e prefektit:

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2022 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesës për kancelari dorëzuar në datë 21.12.2022 janë përcaktuar specifikimet dhe sasia “Për blerje kancelari”.

Njësia e prokurimit ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me urdhërin nr. 5 i ndryshuar me urdhërin nr. 87 datë 23.03.2022, ka kryer testimin e tregut dhe ka mbajtur procesverbal mbi përcaktimin e çmimeve të tregut dhe kërkesën drejtuar Operatorit Ekonomik me çmimin më të ulët. Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve ngritur sipas Urdhërit nr. 6, datë 13.01.2022 ka kryer verifikimin e mallrave dhe marrjen në dorëzim të tyre, pasqyruar në procesverbalin datë 27.12.2022.

Me urdhër shpenzimin nr. 210, datë 28.12.2022 është bërë likuidimi i OE “Dh.V.” në vlerën 24,000 lekë bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura e OE nr. 1378/2022 datë 27.12.2022, fletë hyrja nr. 19 datë 27.12.2022 me vlerë totale me TVSh për 24,000 lekë. Proces verbali datë 27.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallit.

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2022 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesës për kancelari dorëzuar në datë 05.12.2022 janë përcaktuar specifikimet dhe sasia “*Për blerje distinktivë identifikimi*”.

Njësia e prokurimit ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me urdhërin nr. 5 i ndryshuar me urdhërin nr. 87 datë 23.03.2022, ka kryer testimin e tregut dhe ka mbajtur procesverbal mbi përcaktimin e çmimeve të tregut dhe kërkesën drejtuar Operatorit Ekonomik me çmimin më të ulët. Komisionin i marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve ngritur sipas Urdhërit nr. 6, datë 13.01.2022 ka kryer verifikimin e mallrave dhe marrjen në dorëzim të tyre pasqyruar në procesverbalin datë 27.12.2022

Me urdhër shpenzimin nr. 209, datë 28.12.2022 është bërë likuidimi i OE “I.” në vlerën 18,000 lekë bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura e OE nr. 111/2022 datë 27.12.2022, fletë hyrja nr. 18 datë 27.12.2022 me vlerë totale me TVSh për 24,000 lekë. Proces verbali i marrjes në dorëzim të mallit datë 27.12.2022.

#### 5. Shërbim pritje përcjellje për aktivitetet ku është pjesëmarrës Prefekti:

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2022 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesave për Shërbim pritje përcjellje sipas rasteve konkretë, janë përcaktuar specifikimet për “*Shërbim pritje përcjellje për aktivitetet ku është pjesëmarrës Prefekti i Qarkut*”, ky zë i regjistrit është realizuar me 7 fatura.

Referuar kërkesës për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore të vdekjes së Ismail Qemalit është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 15/2022 datë 25.01.2022.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 23 datë 15.02.2022 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh, shoqëruar me faturën nr. 15/2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 25.01.2022.

Referuar ftesës së ardhur nga Bashkia Tiranë për pjesëmarrjen në memorialin në Qafë Kashar ceremonia homazh në përkujtim të pritjes së delegatëve të Kongresit të Lushnjës është kryer shërbimi përgatitjes së kurorës me lule natyrale dhe dërgimi i saj në destinacion nga OE “B.D.” sipas faturës nr. 30/2022 datë 11.02.2022.

Me Urdhër shpenzimin nr. 45 datë 11.03.2022 është bërë likuidimi i OE B.D. me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 30/2022.

Referuar kërkesës me shkresën nr. 5095 datë 14.04.2022 të ardhur nga Ministria e Jashtme për pjesëmarrjen në ceremoninë e 5 Majit në Varrezat e Dëshmorëve është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 119/2022 datë 05.05.2022.

Me Urdhër shpenzimin nr. 79 datë 12.05.2022 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 119/2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 05.05.2022.

Referuar kërkesës për pjesëmarrjen në ceremoninë homazh për vdekjen e ish-Presidentit të Republikës z. Bujar Nishani është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 19/2023 datë 02.06.2022.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 96 datë 09.06.2022 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 19/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 02.06.2022.

Referuar kërkesës me shkresën nr. 31525 datë 12.09.2022 të ardhur nga Bashkia Tiranë për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore për 80-vjetorin e Konferencë së Pezës është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 197/2022 datë 16.09.2022.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 158 datë 05.10.2022 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 197/2022 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 16.09.2022.

Referuar kërkesës me shkresën nr. 39433 datë 09.11.2022 të ardhur nga Bashkia Tiranë për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore për ditën e çlirimit të Tiranës është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 311/2022 datë 17.11.2022.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 184 datë 22.11.2022 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 311/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 17.11.2022.

Referuar kërkesës me shkresën nr. 14688, datë 11.11.2022 të ardhur nga Ministria e Jashtme për pjesëmarrjen në ceremoninë e “29 Nëntorit” në Varrezat e Dëshmorëve është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 333/2022 datë 29.11.2022.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 199, datë 06.12.2022 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 333/2022 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 29.11.2022.

### **Procedurat e vitit 2023:**

Në vitin 2023, me shkresën nr. 46, datë 12.01.2023 është përcaktuar person përgjegjës për prokurimet z. H.Ll..

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me urdhërin nr. 8 datë 12.01.2023 janë përcaktuar personat përgjegjës për Prokurimet (PPP) dhe është ngritur komisioni i prokurimeve me vlera të vogla, i përbërë nga z. H.Ll., znj. E.K. dhe z. A.U., mbështetur në pikën 2 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës e me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar manuali me Udhëzimin nr. 5, datë 29.07.2022.

Për vitin 2023 janë dërguar periodikisht çdo 4 muaj regjistrat e realizimit të procedurave të prokurimit publik në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Ministria e Brendshme përkatësisht me nr. 718, datë 10.05.2023; nr. 718/1, datë 10.09.2023; nr. 44, datë 09.01.2024 Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve për vitin 2023, nga verifikimi i SPE, është paraqitur në Aneksin 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela P5.

Procedurat e përzgjedhura për auditim, janë paraqitur në Aneksin 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela P6.

#### **1. Blerje materiale kancelarie me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSh, blerje e drejtpërdrejtë.**

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2023 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesës për blerje materiale kancelarie, dorëzuar janë përcaktuar specifikimet “Blerje materiale kancelarie”.

Njësia e prokurimit dhe komisioni i marrjes në dorëzim pasi kanë testuar tregun, kanë porositur mallin te operatori ekonomik I.O. shpk me nr. NIPT J.....Q. Operatori Ekonomik ka dorëzuar mallin në institucion sipas kërkesës të shoqëruar me faturën nr. 2312/2023 datë 12.06.2023.

Me urdhër shpenzimin nr. 92, datë 16.06.2023 është bërë likuidimi i I.O. shpk në vlerën 93,292 lekë bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura e OE nr. 2312/2023 datë 12.06.2023, fletë hyrja nr. 06 datë 12.06.2023 me vlerë totale me TVSh për 93,292 lekë. Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit datë 12.06.2023.



**2. Blerje bojëra për printer dhe fotokopjo me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSh blerje e drejtpërdrejtë.**

Referuar buxhetit të miratuar për vitin 2023, regjistrin të parashikimit për vitin 2023 dhe kërkesës së bërë më datë 11.12.2023 nga specialisti IT me specifikimet përkatëse, Njësia e prokurimit së bashku me komisionin e marrjes në dorëzim pasi kanë testuar tregun, kanë porositur mallin të operatori ekonomik "A.P." shpk me nr. NIPT L.....V. Operatori Ekonomik ka dorëzuar mallin në institucion sipas kërkesës së bërë shoqëruar me faturën nr. 3990/2023 datë 18.12.2023.

Me urdhër shpenzimit nr. 203, datë 21.12.2023 është bërë likuidimi i OE "A.P." shpk në vlerën 112,200 lekë me TVSh, bashkëlidhur urdhër shpenzimit dhe fatura e OE nr. 3990/2023 datë 18.12.2023, fletë hyrja nr. 11 datë 18.12.2023 me vlerë totale 112,200 lekë me TVSh. Procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit datë 18.12.2023.

**3. Blerje materiale pastrimi, desifektimi dhe ndricimi me vlerë nën 100,000 lekë pa t.v.sh blerje e drejtpërdrejtë.**

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2023 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesave për materiale pastrimi e ndriçimi janë përcaktuar specifikimet dhe sasia "*Për blerje materiale pastrimi dhe ndriçimi*". Ky zë i regjistrit është realizuar me 3 fatura.

Për kryerjen e shërbimit të zëvendësimit të "*plafoniereve ndriçues led*" sipas kërkesës datë 15.05.2023 është kryer shërbimi nga OE E.S. PF, me faturë nr. 1/2023 datë 29.05.2023.

Me Urdhër Shpenzimit nr. 78 datë 30.05.2023, është likuiduar OE E.S. me vlerë 17,600 lekë me TVSh, shoqëruar me faturën përkatëse nr. 1/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 29.05.2023.

Për blerjen e "*materialeve të pastrimit dhe desifektimit*", sipas kërkesës datë 17.10.2023. Shërbim i kryer te OE "J." shpk me faturë nr. 7112 datë 24.10.2023.

Me Urdhër Shpenzimit nr. 177 datë 07.11.2023 likuiduar OE "J." Shpk me vlerë 68,160 lekë me TVSH sipas faturës nr. 7112 datë 24.10.2023, është fletë hyrja nr. 10 datë 24.10.2023 me vlerë totale 68,160 lekë. Procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit datë 24.10.2023.

**4. Shërbim pritje përcjellje për aktivitetet ku është pjesëmarrës Prefekti (Përgatitja e kurorave me lule) me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSh blerje e drejtpërdrejtë.**

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2023 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesave për Shërbim pritje përcjellje sipas rasteve konkretë, janë përcaktuar specifikimet për "*Shërbim pritje përcjellje për aktivitetet ku është pjesëmarrës Prefekti i Qarkut*", ky zë i regjistrit është realizuar me 5 fatura si më poshtë: Referuar kërkesës me shkresës nr. 6893 datë 11.04.2023 të ardhur nga Ministria e Jashtme për pjesëmarrjen në ceremoninë e "5 Majit" në Varrezat e Dëshmorëve është kryer shërbimi nga OE B.D. me faturë nr. 186/2023 datë 05.05.2023.

Me Urdhër Shpenzimit nr. 75 datë 22.05.2023 është bërë likuidimi i OE "B.D." me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 186/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 05.05.2023.

Referuar kërkesës dhe njoftimit të ardhur nga Bashkia Tiranë për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore me rastin e ditës së shenjtërimit të Nënë Terezës është kryer shërbimi nga OE B.D. me faturë nr. 357/2023 datë 05.09.2023.

Me Urdhër Shpenzimit nr. 145 datë 13.09.2023 është bërë likuidimi i OE "B.D." me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 357/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 05.09.2023.

Referuar kërkesës me shkresën nr. 31182 datë 11.09.2023 nga Bashkia Tiranë për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore për "*81-vjetorin e Konferencës së Pezës*" është kryer shërbimi nga OE "B.D." me faturë nr. 384/2023 datë 16.09.2023.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 165 datë 25.10.2023 është bërë likuidimi i OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 384/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 16.09.2023.

Referuar kërkesës sipas shkresës nr. 14586 datë 01.11.2023 të ardhur nga Ministria e Jashtme për pjesëmarrjen në ceremoninë e “29 Nëntorit” në Varrezat e Dëshmorëve është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 3/2023 datë 29.11.2023.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 200 datë 12.12.2023 është likuiduar OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSh shoqëruar me faturën nr. 3/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 29.11.2023.

Referuar kërkesës me shkresën nr. 39187 datë 8.11.2023 të ardhur nga Bashkia Tiranë për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore “Për ditën e çlirimit të Tiranës” është kryer shërbimi nga OE “B.D.” me faturë nr. 510/2023 datë 17.11.2023.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 193 datë 25.10.2023 është likuiduar OE “B.D.” me vlerë 16,800 lekë me TVSH shoqëruar me faturën nr. 510/2023 sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 17.11.2023.

#### 5. Shërbim i siguracionit të mjeteve të transportit me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSh blerje e drejtpërdrejtë.

Mbështetur në planifikimin e buxhetit për vitin 2023 si dhe nevojat e institucionit pasqyruar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve dhe të kërkesave për Siguracionin e mjeteve që disponon sipas rasteve konkretë, janë përcaktuar specifikimet për “Shërbim pritje Siguracionin e mjeteve që disponon”, ky zë i regjistrit është realizuar me 3 fatura.

Referuar, afatit kohor të sigurimit të detyruar të mjeteve motorike, njësia e prokurimit si dhe komisioni i marrjes në dorëzim pasi kanë testuar tregun, kanë porositur shërbimin te operatori ekonomik I. Sha me nr. NIPT L.....D. Operatori Ekonomik ka dorëzuar siguracionin TPL në institucion sipas kërkesës së bërë me faturën nr. 5024/2023 datë 20.01.2023.

Me urdhër shpenzimin nr. 20, datë 10.02.2023 është bërë likuidimi për I. sha në vlerën 18,250 lekë me TVSh, bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura e OE nr. 5024/2023 datë 20.01.2023, siguracioni TPL për mjetin Toyota Rav 4 me targa AA359PM.

Referuar afatit kohor të sigurimit të detyruar të mjeteve motorike, njësia e prokurimit si dhe me komisionin e marrjes në dorëzim pasi kanë testuar tregun kanë porositur shërbimin te operatori ekonomik I. Sha me nr. Nipt L.....D. Operatori Ekonomik ka dorëzuar siguracionin TPL në institucion sipas kërkesës së bërë shoqëruar me faturën nr. 27967/2023 datë 19.05.2023.

Me urdhër shpenzimin nr. 76, datë 22.05.2023 është bërë likuidimi i I. sha në vlerën 18,250 lekë me TVSH, bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura e OE nr. 27967/2023 datë 19.05.2023, siguracioni TPL për mjetin Hyundai Tucson me targa AA496TT.

Referuar afatit kohor të sigurimit të detyruar të mjeteve motorike njësia e prokurimit si dhe me komisionin e marrjes në dorëzim pasi kanë testuar tregun kanë porositur shërbimin te operatori ekonomik I. Sha me nr. NIPT L.....D. Operatori Ekonomik ka dorëzuar siguracionin TPL në institucion sipas kërkesës së bërë shoqëruar me faturën nr. 68521/2023 datë 12.09.2023.

Me urdhër shpenzimin nr. 159, datë 05.10.2023 është bërë likuidimi i I. sha në vlerën 18,940 lekë me TVSh, bashkëlidhur urdhër shpenzimit është fatura e OE nr. 68251/2023 datë 12.09.2023, siguracioni TPL për mjetin Mazda me targa AA020LP.

### 2.3. Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me organet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore bazohen në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut” dhe në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka përgjegjësi të shprehet për “Verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”, e përcaktuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika a).

Për zbatimin e kësaj përgjegjësie, institucioni i prefektit shprehet nëpërmjet strukturës përgjegjëse që është sektori juridik, i cili, sipas urdhërit nr. 5, datë 12.01.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut të Tiranës”, është i miratuar me 4 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë) me status të nëpunësit civil, organikë e plotësuar.

Ky sektor si strukturë përgjegjëse, ka si detyrë kryesore “Verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe përpilon dokumentacionin e nevojshëm duke u shprehur për ligjshmërinë e këtyre akteve, brenda afateve kohore”, e përcaktuar në nenin 15 të rregullores së brendshme të funksionimit të Institucionit të Prefektit, të miratuar me urdhërin nr. 175, datë 09.07.2020, të MB.

Me ndarjen e re administrative, në territorin e Qarkut Tiranë veprojnë Bashkitë Tiranë, Vorë, Kamzë, Kavajë, Rrogozhinë dhe Këshilli i Qarkut.

Prefekti i Qarkut ka miratuar Planet vjetore të punës për vitet 2022 dhe 2023 (shkresa nr. 44/6 prot., datë 12.01.2022 dhe shkresa nr. 12/6 prot., datë 05.01.2023) në të cilat përfshihet edhe plani vjetor i punës për sektorin Juridik. Në këto plane janë përcaktuar detyrat e sektorit gjatë vitit si dhe periudha kohore e realizimit të tyre, ku ndër detyrat kryesore janë:

- Verifikimet nga ana ligjore e vendimeve të këshillave bashkiakë të vetëqeverisjes vendore brenda afatit kohor dhe verifikimet në vend të vendimeve të këshillave bashkiakë.
- Raportimi periodik mujor i vendimeve të këshillave sipas urdhërit nr. 667, datë 18.12.2018 të MB.

Bazuar në kërkesat e urdhërit nr. 667, datë 18.12.2018 të MB, “Për raportimin dhe informimin e veprimtarisë së prefektit të qarkut”, Institucioni i Prefektit në mënyrë periodike (për çdo muaj) ka raportuar në Drejtorinë e Koordinimit dhe Monitorimit të Prefekturave pranë MB mbi veprimtarinë e institucionit të Prefektit, në të cilin është bashkëlidhur edhe pasqyra mujore dhe progresive e konfirmimit të akteve normative për periudhën si dhe është raportuar edhe statusi i akteve normative të hyra e të shqyrtuara nga Institucioni i Prefektit.

Evidenca mujore dhe përmbledhëse e vitit, për të gjitha aktet e hyra në protokollin e institucionit, është përgatitur nga sektori juridik.

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën 01.01.2022-31.12.2023, rezultoi se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **1,004** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **955** vendime të këshillave bashkiakë, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **49** vendime në total. Sipas periudhave vjetore dhe njëjësive vendore, statusi i trajtimit të vendimeve nga Institucioni i Prefektit (akteve administrative) për vitin 2022 dhe 2023, është paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabelat L1 dhe L2.

Nga auditimi u konstatua se një pjesë e vendimeve të këshillave bashkiakë janë akte me karakter individual, (kryesisht me objekt ndihma ekonomike, fondi 6%, dhënie tituj nderi, emërtim rrugësh, bulevardi sheshi, dhënie/heqje mandati, listë përfitim bursash, zgjedhje kryetar/zv kryetar apo sekretar këshilli etj.), **akte të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie pranë prefektit pasi marrin fuqi ditën e njoftimit të subjektit/subjekteve që i drejtohet.**

Sipas ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 3, pikat 1 dhe 2, kuptimi i akteve administrative përcaktohet si më poshtë:

1. “Akti administrativ”: **a) “Akti administrativ individual”** është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, **kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës**, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
2. “Akt normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, **që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë, janë depozituar nga njësitë e qeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut, Bashkia Tiranë, Kamzë, Vorë, Kavajë, Rogozhinë), **195 Akte Individuale**, ndërsa për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, janë depozituar **186 Akte Individuale**, të paraqitura në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabelat L3 dhe L4.

**Si konkluzion**, nga Prefekti i Qarkut Tiranë nuk duhet të ishin pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria për **381** akte individuale, të depozituara nga njësitë e qeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut, Bashkia Tiranë, Kamzë, Vorë, Kavajë, Rogozhinë), pasi është në kundërshtim me ligjin nr. “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, në të cilin përcaktohet:

“Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën, Për çdo akt të regjistruar, prefekti i qarkut **detyrohet** të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit. Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i **lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës** të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkëljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore **rishqyrton aktin**; Vendimi, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, **depozitohet pranë prefektit** të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të kësaj pike.”

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Tiranë (viti 2022):**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga auditimi rezultoi se nga Këshilli i Bashkisë Tiranë në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **112** akte administrative, të cilat janë konfirmuar të gjitha për bazueshmëri ligjore.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojë për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Tiranë nga Këshilli i Bashkisë Tiranë, për vitin 2022 përzgjedhi për auditim 47 Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) (nga të cilat 29 për vitin 2022 dhe 18 për vitin 2023), nga ku u konstatua se:

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se **në 18 raste**, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), kanë **Karakter individual dhe janë konfirmuar në mospërputhshmëri me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, gërma gj, ku citohet:**

“Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:  
gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët”

Sa më sipër, **është kompetencë e kryetarit të Bashkisë si person juridik dhe përfaqësues i saj, marrëdhënia me të tretët**, për rrjedhojë nuk nevojitet autorizim apo Vendim Këshilli Bashkiak. Aktet me karakter individual, të miratuara nga KB Tiranë për vitin 2022, janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L5.

- Vendimi nr. 99 datë 19.02.2022 “Për riorganizimin e shoqërisë UKT sh.a në kuadër të politikave kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.”

Në pikën 1 të vendimit shprehen: “Autorizimi i Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e tij dhe si aksioner i vetëm i shoqërisë UKT dhe si përfaqësues i vetëm më asamblenë e përgjithshme të kësaj shoqërie për të negociuar me bashkinë Kamzë e Vorë...”.

Është konfirmuar në mospërputhshmëri me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, gërma gj.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), për dhënie prone për zhvillim janë konfirmuar në mospërputhshmëri me nenet 18; nenin 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” konkretisht:

- Vendimi nr. 32 datë 06.04.2022 “Për zhvillimin e pronave nr. 2/21, nr. 2/32 dhe nr. 2/287, zona kadastrale 8150, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e draft kontratës së sipërmarrjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “B. Sh.A.””.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 694/2 prot., datë 29.04.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 32 datë 06.04.2022 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar:

- Vendimi nr. 50 datë 14.06.2022 “Për miratimin e akt-marrëveshjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “B. Sh.A.””.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 1171/2 prot., datë 22.06.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 50 datë 14.06.2022 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar:

Miratimet nga Prefekti me shkresën nr. 694/2 prot., datë 29.04.2022 si dhe me shkresën nr. 1171/2 prot., datë 22.06.2022 janë kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar konkretisht:

- Dokumentacion që vërteton Këshillimin me bashkësinë, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohet:

1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji.

2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

- Dokumentacioni ligjor mbi regjistrimin e pronës (certifikatë pronësie)

- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore. Në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ku përcaktohet:

3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “e/l”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.

4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 1 rast** Vendimi i Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për Ndryshim DS është konfirmuar në mospërputhje me VKM nr. 5, datë

6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” konkretisht:

- Vendimi nr. 56 datë 06.07.2022 “Për miratimin e listave të përfituesve të nënprogramit të grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 1353/1 prot., datë 19.07.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 56 datë 06.07.2022.

- Nga auditimi u konstatua se kërkesat e qytetarëve janë në tejkalim të afateve ligjore të parashikuara për të drejtën e ankimimit dhe nuk kanë si dokumentacion shoqëruar certifikatat e gjendjes familjare më datë 26.11.2019.

Miratimi i listave nuk është shoqëruar me dokumentacionin si:

- Procesverbal i mbledhjes së këshillit bashkiak.

- Arsyet e rivlerësimit të 2 banesave, të shpjeguara në raportet me nr. 18270, datë 20.05.2022 dhe nr. 23628, datë 24.06.2022 nga komisioni i posaçëm i ngritur janë në mospërputhje me Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pika 19, ku përcaktohet:

*Aplikantëve jo fitues, struktura përgjegjëse u njofton edhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje si dhe të vendimit për përfitim nga një proces tjetër i procesit të rindërtimit, nëse kjo është e mundur. Aplikantët jo fitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose pranë autoritetit përgjegjës, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.*

- në mospërputhje me Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i cili në Kreun IV “Grantet për rikonstruksion” pika 2/a përcakton:

*2. Përveç sa parashikohet në pikën 13, të kreut II, të këtij vendimi, aplikimet për grante rikonstruksioni ose riparimi duhet të shoqërohen dhe me:*

*a) aktin e konstatimit ose aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar shtëpia individuale, ndërtesa ose banesa;*

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në I rast** Vendimi i Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për *Kalim pronësie* është konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, konkretisht:

- Vendimi nr. 71 datë 12.07.2022 “Për kalimin në administrim të Agjencisë së Industrisë Kreative, të objektit “Kinema Agimi”, me nr. pasurie 2/106-n20, zona kadastrale 8270, në pronësi të Bashkisë Tiranë”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 1399/1 prot., datë 22.07.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71 datë 12.07.2022 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar:

- Pasqyrat përkatëse ( në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar). Qendra Kulturore Tirana me shkresën nr. 297, datë 16.06.2022 “Informacion mbi objektin Kinema “Agimi”” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit thekson “Vlen për tu theksuar për Kinema Agimi është krijuar debitori shoqëria “E.” deri në 31.12.2021 në vlerën 20,215,543 lekë të pasqyruar në bilancin e vitit ushtrimor 2021 në llogarinë 468 “debitorë të ndryshëm“, vlerë e cila në përfundim të kontratës në datë 09.02.2022 arrin vlerë 22,219,621 lekë dhe për çdo ditë vonesë një kamatë ditore prej 1 % të vlerës së qirasë.....”

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në lidhje me administrimin e debitorit;

- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

Sa më sipër, janë në mospërputhje edhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c, ku përcaktohet:

b. Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit
- Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet me ligj
- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore
- Projektvendim
- Certifikatë e pronësisë e në mungesës të saj, statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjen e pronave), plan vendosjet
- Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar)
- Dokumentacion përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendim marrjes për emergjencat civile), etj.

c. Në rast se akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), Prefekti i Qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuar), për **Taksat vendore** janë konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, konkretisht:

- Vendimi nr. 139 datë 23.12.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar”.

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se Vendimi i Këshillit Bashkiak (i konfirmuar), **periudhë të përkohshme përcakton një afat 3 vjeçar** vendimi nuk është **shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, projektvendim dhe me relacionin shpjegues**, në mospërputhje me nenin 18 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksin nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

- Vendimi nr. 144 datë 23.12.2022 “Për miratimin e formës dhe procedurave për shfrytëzimin e ambienteve sportive të institucioneve arsimore publike para universitare, Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit “Shkolla Qendër Komunitare””.

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, Vendimi i Këshillit Bashkiak (i konfirmuar), nuk është **shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, projektvendim dhe me relacionin shpjegues**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për Transferim Pronë janë konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe Rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, konkretisht:

- Vendimi nr. 109, datë 15.11.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të një pjese të pasurisë me nr. 7/662, zona kadastrale 8170, me sipërfaqe prej 529 m<sup>2</sup>, që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e zhvillimit ekonomik, si dhe shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 2178/2 prot., datë 25.11.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 109 datë 15.11.2022, është kryer:

- pa marrë më parë miratimin nga Këshilli i Ministrave për kalimin të pronës nr. 1/71 në ZK 8150 nga pronësia shtet në pronësi të Bashkisë Tiranë është veprim në kundërshtim me nenin 17 dhe 19 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

- pa procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

- pa Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore. Në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

Vendimi nr. 19 datë 06.04.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 150, zona kadastrale 3517, me emërtimin “grup depo rep. usht. 8837, me vendndodhje në Stërmas”, me qëllim ngritjen e një qendre grumbullimi (strehëz) për kafshët endacake”

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 694/1 prot., datë 14.04.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 19 datë 06.04.2022, pa marrë më parë nga Bashkia Tiranë miratimin nga Këshilli i Ministrave për kalimin të pronës nr. 1/71 në ZK 8150 nga pronësia shtet në pronësi të Bashkisë Tiranë është veprim në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

- bashkëlidhur me Vendimin e Këshillit Bashkiak nuk ka dokumentacion bashkëlidhur për projektet a planet për zhvillimin e pronës që do transferohet.

- mungon procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në I rast** Vendimi i Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për *Dhënie ndihmë emergjencë* është konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, konkretisht:

- Vendimi nr. 128, datë 23.12.2022 “Për dhënien e ndihmës financiare për 16 (gjashtëmbëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit dhe përmbytjeve dhe dëmet ndërtimore në ambientet e përbashkëta të pallatit “Mesaplik 05”, ndërtesa nr. 4, në rrugën “Migjeni”, Lagjia nr. 14.”.

Akordimi i ndihmës financiare prej 3,245,423 lekë për 17 subjekte e persona, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 128, datë 23.12.2022 si dhe miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 2401/1 prot., datë 30.12.2022, është kryer pa dokumentacionin shoqërues bashkëngjitur vendimit; mungon preventivi mbi vlerësimin për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit.

Në mospërputhje me VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, gërmat b, ç, d dhe e, ku përcaktohet:

“1. Procedurat e vlerësimit të dëmeve

b) Drejtuesi i organit të qeverisjes vendore verifikon vërtetësinë e fakteve të paraqitura në kërkesë, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të tij, i cili mban dhe procesverbalin e konstatimit të gjendjes



**për dëmet e shkaktuara.** Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit është 5 (pesë) ditë.

ç) Sipas rastit, me kërkesë të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, këshilli i qarkut përkatës krijon komisionin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, i cili pas vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën "ç" të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, përcakton masën e dëmshpërblimit për familjet e dëmtuara.

d) Vlerësimi për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit, bëhet në përputhje me shkronjën "e" të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi.

dh) Afati kohor nga ngritja e komisionit deri në përfundimin e vlerësimit të dëmeve të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

e) Bashkia ose komuna harton kërkesën për dhënien e ndihmës së menjëhershme, për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkohshme për jetesë të qytetarëve, si dhe për shpenzime të tjera për përbalimin e situatës emergjente.”

### **Verifikimi në vend 2022:**

Institucioni i Prefektit (sektori juridik) në zbatim të objektit kryesor të veprimtarisë (*bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”*), ka ushtruar verifikime ligjshmërie të akteve normative të nxjerra nga këshillat e bashkisë në juridiksion.

Për realizimin e këtij procesi, Prefekti Qarkut me urdhër të brendshëm ka krijuar grupet e punës me tre anëtare (*personel i sektorit juridik*) për realizimin e kontroleve në vend të akteve pranë njësive vendore. Ky proces është në përmbushje të nenit 16 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe me detyrat e përcaktuara në urdhërin e kryeministrit nr. 50, datë 15.02.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”.

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2022**, janë krijuar grupet e punës me urdhërat; nr. 120 datë 16.05.2023 “Për verifikimin e periudhës Janar-Mars 2022”; urdhëri nr. 197 datë 17.08.2022 “Për verifikimin e periudhës Prill- Qershor 2022”; urdhërin nr. 259 datë 02.11.2022 “Për verifikimin e periudhës Korrik - Shtator-2022” dhe Urdhërin nr. 16, datë 23.01.2023 “Për verifikimin e periudhës tetor-dhjetor 2022”

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, verifikimi në vend për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Procesi i verifikimit të ligjshmërisë në vend të akteve ka konsistuar në “Verifikimin e ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga këshilli i bashkisë dhe të paraqitura në Institucionin e Prefektit për shprehje ligjshmërie” në respektim të:

- ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 17, pikat 1 dhe 2;

- ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, procedurat e ndjekura lidhur me thirrjen e këshilltarëve për mbledhje, dokumentacionet, afatet, etj.

- Zbardhjen e akteve të miratuara nga këshilli nëse është bërë në bazë të pasqyrimeve në procesverbalin e mbledhjes dhe materialeve përkatëse të paraqitura në mbledhje. Rregulloren e brendshme të funksionimit të këshillit. Respektimi i dispozitave të saj, në lidhje me siglimin e procesverbaleve të mbledhjeve, etj.

Në akt kontrollet e mbajtura nga grupi i punës, përkatësisht aktin nr. 917/1 prot., datë 30.05.2022, aktin nr. 1576/1 prot., datë 02.09.2022, aktin nr. 2022/1 prot., datë 30.11.2022 dhe aktin nr. 117/1, datë 10.02.2023 nuk janë konstatuar mangësi në drejtim të mospasqyrimit të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk u konstatuan akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit. (Aktet janë marrë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

- Grupi i punës nuk ka kryer një verifikim të plotë mbi dokumentacionet shoqëruese që duhet të përmbajnë vendimet e këshillit të cilat depozitohen pranë Prefektit të Qarkut, siç janë: procesverbalet e dëgjësive publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; relacionet përkatëse që shpjegojnë respektimin e procedurave ligjore; pasqyrat përkatëse ( në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar) etj.

- Me aktin nr. 917/2 prot., datë 30.05.2022, aktin nr. 1576/2 prot., datë 02.09.2022, aktin nr. 2022/2 prot., datë 30.11.2022 dhe aktin nr. 117/2, datë 10.02.2023, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut*”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Tiranë (viti 2023):**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga Këshilli i Bashkisë Tiranë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **35** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **34** vendime të Këshillit të Bashkisë Tiranë.

Grupi i auditimit të KLSH-së, për vitin 2023 përzgjodhi për auditim **14** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), nga ku u konstatua se:

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), ***nuk janë shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes***, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut*”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

Vendimet e ***pashoqëruara me procesverbalin e mbledhjes*** janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L6.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, ***në 1 rast*** Vendimi i Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për Transferim Prone është konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar si dhe Rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut*”, konkretisht:

- Vendimi nr. 24 datë 17.03.2023 “*Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme me numër pasurie 1/71, ZK 8150, Tiranë, që do të përdoret në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë*”

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 474/1, datë 28.03.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 24 datë 17.03.2023, pa marrë më parë nga Bashkia Tiranë miratimin nga Këshilli i Ministrave për kalimin të pronës nr. 1/71 në ZK 8150 nga pronësia shtet në pronësi të Bashkisë Tiranë është veprim në kundërshtim me nenet 17 dhe 19 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, ***në 1 rast*** Vendimi i Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për dhënien me Qira është konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” i ndryshuar, si dhe me VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “*Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore*”, konkretisht:

- Vendimi nr. 40 datë 19.04.2023 “*Për miratimin në parim të dhënies me qira, me konkurrim, të një sipërfaqeje prej 1284 m2, pjesë e pasurisë me nr. 8/72, zona kadastrale 8270, me emërtim “Akuadromi i Tiranës”*”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 649/1, datë 25.04.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 40 datë 19.04.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- relacion mbi dobishmërinë e dhënies me qira dhe

- shkresën e Qendrës Sportive Tirana nr. 47, datë 16.02.2023 “Propozim për dhënien me qira afatgjatë të një sipërfaqe në administrim të Qendrës Sportive “Tirana”” për këshillin drejtues i Qendrës Sportive “Tirana” si dhe në Vendimin nr. 1, datë 17.02.2023 të Këshillit Drejtues “Për dhënien me qira pasuri të paluajtshme”.

Llogaritja e nivelit minimal të qirasë është për objekte banimi dhe jo tregtare, ç’ka bie në kundërshtim me VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore” në pikën 3 ku përcaktohet:

3. Për dhënien me qira të ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, në qytetin e Tiranës, vlera minimale e qirasë mujore, për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet, si më poshtë vijon:

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkia për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, në 2 raste Vendimet e Këshillit Bashkiak (konfirmuara), për Dhënie ndihmë emergjencë janë konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, konkretisht:

- Vendimi nr. 51 datë 03.05.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 7 (shtatë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 2 raste, zjarre 4 raste dhe përmbytje 1 raste në vlerë totale 5,397,301 lekë).

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 690/1 prot., datë 04.05.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 51 datë 03.05.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues: Në Përputhje e zbatim të VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, pika 2 ku përcaktohet:

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

a) Procesverbali i konstatimit të gjendjes;

c) Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake;

ç) Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;

dh) Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në rast eksplozivi;

e) Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licencuara, nëse është rrëshqitje toke;

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkia për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar. Vendimi nr. 86 datë 20.07.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 29 (njëzet e nëntë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 11 raste, zjarre 13 raste dhe përmbytje 5 raste në vlerë totale 11,757,572 lekë).

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 1065/1 prot., datë 28.07.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 86 datë 20.07.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues: Në Përputhje e zbatim të VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat

*e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” pika 2 ku përcaktohet:*

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të kërkuar dhe vërtetuar dhënien e ndihmës financiare:

- Procesverbal i konstatimit të gjendjes;
- Preventivat e dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit, si dhe dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake;
- Certifikata familjare në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë;
- Akt-ekspertiza nga PMNZSH-ja, në raste zjarri dhe vërtetimi nga Policia e Shtetit ose prokuroria e rrethit, në rast eksplozivi;
- Studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licencuara, nëse është rrëshqitje toke;

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkia për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.  
- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), për dhënie prone për zhvillim janë konfirmuar në mospërputhshmëri me nenin 18; nenin 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht:

- Vendimi nr. 6 datë 25.01.2023 “Për zhvillimin e pronës nr. 2/377 ZK 8380 me emërtimin “Godinë 1 kat “Dhoma e tregtisë dhe industrisë” në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimi i draft kontratës së sipërmarrjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “I.C.”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 172/1 prot., datë 06.02.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 6 datë 25.01.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore. Në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksin nr. 1, neni 4, pika b, c.

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.  
Vendimi nr. 52 datë 03.05.2023 “Për zhvillimin e pronës nr. 1/66, zona kadastrale 8150, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e draft kontratës së sipërmarrjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “F.” sh.p.k”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 690/1 prot. datë 04.05.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 52 datë 03.05.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore. Në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksin nr. 1, neni 4, pika b, c.

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.  
Vendimi nr. 118 datë 15.11.2023 “Për zhvillimin e pasurisë nr. 7/430, zona kadastrale 8360, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e draft kontratës së sipërmarrjes midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit tregtar “M.P.”, person fizik”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 1558/1 prot., datë 24.11.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 118 datë 15.11.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore. Në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksin nr. 1, neni 4, pika b, c

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 1 rast** Vendimi i Këshillit Bashkiak (konfirmuar), për sipërmarrje është konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, konkretisht:

- Vendimi nr. 100 datë 15.09.2023 “Për miratimin e projektit “Sipërmarrja ime për shkollën” hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”.

Miratimi nga Prefekti me shkresën nr. 1304/1 prot., datë 25.09.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 100 datë 15.09.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- Pasqyrat përkatëse ( në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar);

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në buxhet dhe në cfare zeri preket te buxheti i bashkisë;

- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 2 dhe 6 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Në mospërputhje edhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

### **Verifikimi në vend 2023:**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2023**, janë krijuar grupet e punës me urdhërat: nr. 92 datë 18.04.2023 “Për verifikimin e periudhës janar-mars 2023”; urdhëri nr. 160 datë 07.09.2023 “Për verifikimin e periudhës prill-gusht 2023”; dhe urdhërin nr. 13 datë 18.01.2024 “Për verifikimin e periudhës shtator-dhjetor 2023”

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, verifikimi në vend për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2, ku përcaktohet:

1. Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, **jo më pak se njëherë në 3 muaj.**

2. Verifikimi në vend, si rregull do të kryhet në muajt mars, qershor, shtator, dhjetor.

Procesi i verifikimit të ligjshmërisë në vend të akteve ka konsistuar në “**Verifikimin e ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga këshilli i bashkisë dhe të paraqitura në Institucionin e Prefektit për shprehje ligjshmërie**”, në respektim të:

- ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 17, pikat 1 dhe 2;

- ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, procedurat e ndjekura lidhur me thirrjen e këshilltarëve për mbledhje, dokumentacionet, afatet, etj.

- Zbardhjen e akteve të miratuara nga këshilli nëse është bërë në bazë të pasqyrimeve në procesverbalin e mbledhjes dhe materialeve përkatëse të paraqitur në mbledhje. Rregulloren e

brendshme të funksionimit të këshillit. Respektimi i dispozitave të saj, në lidhje me siglimin e procesverbaleve të mbledhjeve, etj.

Në akt kontrollet e mbajtura nga grupi i punës, përkatësisht aktin nr. 614/1 prot., datë 04.05.2023, aktin nr. 1257/1 prot., datë 25.09.2023 dhe aktin nr. 80/1 prot., datë 08.02.2024, nuk janë konstatuar mangësi në drejtim të mos pasqyrimin të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk u konstatuan akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit. (Aktet janë marrë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

- Grupi i punës nuk ka kryer një verifikim të plotë mbi dokumentacionet shoqëruese që duhet të përmbajnë vendimet e këshillit të cilat depozitohen pranë Prefektit të Qarkut, siç janë: procesverbalet e dëgjësive publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji; relacionet përkatëse që shpjegojnë respektimin e procedurave ligjore; pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar) etj.

- Me shkresat nr. 614/2 prot., datë 04.05.2023, nr. 1257/2 prot., datë 25.09.2023, nr. 80/2 prot., datë 08.02.2024, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

- Nga auditimi i procedurës së ndjekur u konstatua se, për aktet e kthyera për rishqyrtim, nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësitë vendore), në përmbushje kjo të kërkesave të nenit 16 pika 2 gërma (b), e ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, me pasojë kjo në mos monitorimin e procesit dhe mosfunksionimin si duhet të sistemit të kontrollit të procedurës mbi aktet normative; konkretisht:

- Vendimi nr. 99 datë 15.09.2023 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 142, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e marrëveshjes së mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe qendrës shqiptare të trashëgimisë për themelimin e përbashkët të organizatës jofitimprurëse qendrës “T.P.T.Gj.G.” dhe akteve të themelimit të kësaj organizate jofitimprurëse.”.

Me shkresën nr. 1304/1 prot., datë 25.09.2023 në lidhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 99 datë 15.09.2023 Prefekti është shprehur se: “kemi gjykim Juridik në mungesë pasi jemi në kushtet e mos koherencës së akteve lidhur me depozitimin e tyre pranë Institucionit të Prefektit referuar ligjit nr. 138/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar” pasi Vendimi nr. 99, datë 23.12.2022, është përcjellë pa u shoqëruar me dokumentacionin ligjor të kërkuar:

- Vendimin nr. 142, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak i cili është ndryshuar;

- Memon nr. 12778/1, datë 26.07.2023 Drejtorisë së përgjithshme të promovimit të qytetit;

- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 2 dhe 6 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Në mospërputhje edhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

Nga verifikimi në vend i Vendimeve të marra në vitin 2023 sipas Urdhërit nr. 80, datë 18.01.2024 të Prefektit për ngritjen e grupit të punës për verifikimin në vend është mbajtur

procesverbali me nr. 3698/1 prot., datë 24.01.2024 ku për Vendimin nr. 99 është cituar njësoj si në shkresën “verifikim ligjshmërie” nr. 1304/1 prot., datë 25.09.2023: “kemi gjykim Juridik në mungesë pasi jemi në kushtet e mos koherencës së akteve lidhur me depozitimin e tyre pranë Institucionit të Prefektit referuar ligjit nr. 138/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar”.

### **Vendime të Këshillit të Qarkut:**

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, 15 vendime janë akte me karakter individual, kryesisht me objekt (propozim për shtesë pensioni, propozim për shpallje dëshmor, për vërtetimin e mandatit të këshilltarit të qarkut, etj.), akte të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie pranë prefektit pasi marrin fuqi ditën e njoftimit të subjektit/subjekteve që i drejtohet.

### **Verifikimi në vend:**

**Për vitet 2022-2023**, nuk janë krijuar grupet e punës për verifikimin në vend në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe detyrave të përcaktuara në urdhërin e kryeministrit nr. 50, datë 15.02.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut” dhe në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” e cila në aneksin nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

1. Vendimi nr. 1, datë 13.07.2023, me objekt “Për zgjedhjen e Komisionit të Mandateve”, ka miratuar të zgjedhë komisionin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të Qarkut, Vendimi nr. 2 datë 13.07.2023, “Për vërtetimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të qarkut, a miratuar raportin e komisionit të mandateve, Për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit të qarkut”, Vendimi nr. 3, datë 13.07.2023, “Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Qarkut”, ka miratuar z. A.D. si kryetar të KQ Tiranë, Vendimi nr. 4, datë 13.07.2023, “Për Zgjedhjen e Zëvendës Kryetarit të KQ”, ka miratuar Z. D.C. si Zëvendës Kryetar të KQ, Vendimi nr. 5, datë 13.07.2023 “Për zgjedhjen e kryesisë së KQ”, ka miratuar zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë së KQ Tiranë”.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se mungon procesverbali i mbledhjes në mospërputhje me me pikën 3, neni 74 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohet:

“Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij.”

Gjithashtu u konstatua se mbledhja e parë e KQ është zhvilluar në tejkallim të afatit të parashikuar në pikën, neni 74 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ku përcaktohet:

“Këshilli i qarkut zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 50 ditë nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve vendore.”

2. Vendimi nr. 8 datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë”, në pikën 2 të tij, ka miratuar shpërblimin mujor të anëtarëve të Kryesisë së Këshillit të Qarkut.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se vendimi nuk është i shoqëruar me pasqyrën financiare përkatëse në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksi nr. 1, neni 4, pika b, ku përcaktohet:

“Akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar);

iv. Projektvendim;”

3. Vendimi nr. 6 datë 20.07.2023 “Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, Vendimi nr. 7 datë 20.07.2023

“Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të të Qarkut Tiranë”, Vendimi nr. 8 datë 20.07.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë”, nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, e cila në aneksin nr. 1, neni 4, pika b.

4. Vendimi nr. 9 datë 15.09.2023 “Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të rishikuar të këshillit të Qarkut Tiranë”, nuk është i shoqëruar me relacion shpjegues, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

5. Vendimi nr. 10 datë 15.09.2023 “Për vërtetimin e mandatit të Këshilltarit të Qarkut”, ka miratuar vërtetimin e Mandatit të Këshilltarit të Qarkut Tiranë, z. E.M., Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë nuk është i shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” e cila në aneksin nr. 1, neni 4, pika b, gërma i.

Gjithashtu, ky vendim përbën “Akt administrativ individual” dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

6. Vendimi nr. 28 datë 21.12.2023 “Për miratimin e propozimit për mbështetjen financiare për zbatimin e projekteve të kujdesit shoqëror”, ka miratuar propozimin për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mbështetjen financiare për zbatimin e 8 projekteve të kujdesit shoqëror.

Për këtë vendim, nuk rezulton e dokumentuar procedura e ndjekur nga Këshilli i Qarkut në zbatim të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, ku përcaktohet:

“Roli i qarkut

1. Këshilli i qarkut harton planin social rajonal të bashkërenduar me planet sociale të njëjësive të qeverisjes vendore dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

2. Kryetari i qarkut vendos ofrimin e shërbimeve të specializuara në bashkërendim rajonal të rasteve për shërbimet e kujdesit shoqëror të vendosura në nivel rajonal.

3. Kryetari i qarkut krijon komitetin e planifikimit të nevojave “ad hoc”, të përbërë nga përfaqësues të të gjitha strukturave vendore /rajonale dhe shoqërisë civile, me pjesëmarrje vullnetare.”

7. Vendimi nr. 12 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Tiranë për vitin 2024”, ka miratuar buxhetin e Këshillit të Qarkut Tiranë.

8. Vendimi nr. 13 datë 21.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Këshillit të Qarkut Tiranë.

9. Vendimi nr. 14 datë 21.12.2023 “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe buxheti vjetor i Këshillit të Qarkut Tiranë.

10. Vendimi nr. 25 datë 21.12.2023 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencisë Kombëtare për punësim dhe aftësi (AKPA)”, në pikën 2 të tij ka ngarkuar Kryetarin e Këshillit të Qarkut Tiranë për nënshkrimin e marrëveshjes, si dhe akteve të tjera në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

11. Vendimi nr. 26 datë 21.12.2023 “Për propozimin në organizatën ndërkombëtare forumi i qyteteve të Adriatikut dhe Jonit (FAIC) TË Bashkive Rrogozhinë, Kavajë, Vorë, Kamzë”, ka



miratuar ti propozojë Bashkive Rrogozhinë, Kavajë, Vorë dhe Kamzë, anëtarësimin në Organizatën Ndërkombëtare Forumi i Qyteteve të Adriatikut dhe Jonit (FAIC) Gjithashtu, referuar dispozitave ligjore të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk rezulton në detyrat dhe kompetencat e këshillit të Qarkut propozimi për anëtarësim në forume të ndryshme. Vlen të theksojmë se neni 77 përcakton detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut, të cilat janë:

“a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;

b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;

c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;

ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njësisve e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;

dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm;

f) vendos për taksat e tarifrat në kompetencë të qarkut, si dhe për nivelin e tyre;

g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;

gj) vendos për krijimin e një personi juridik me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta, sipas nenit 14 të këtij ligji;

h) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve në varësi të tij;

i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;

j) vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut, sipas nenit 75 të këtij ligji;

k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin e disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik në nivel qarku;

l) vendos për simbolet e qarkut;

ll) jep tituj nderi dhe stimuj;

m) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark;

n) miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së këshillit të qarkut”

12. Vendimi nr. 54 datë 16.01.2023 “Për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut” dhe dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” G.B.L.”, Vendimi nr. 55 datë 16.01.2023 “Për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut” dhe dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” H.B.B.”, Vendimi nr. 56 datë 16.01.2023 “Për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut” dhe dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” A.Xh.B.”, Vendimi nr. 57 datë 16.01.2023 “Për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut” dhe dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” Xh.N.S.”, përbëjnë “Akte administrative individuale”, nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

13. Vendimi nr. 58 datë 16.01.2023 “Për krijimin dhe përbërjen e grupit të punës të qarkut Tiranë për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2023”, ka miratuar krijimin e grupit të punës së Qarkut Tiranë për përzgjedhjen, përgatitjen dhe pjesëmarrjen e Grupit përfaqësues të Qarkut Tiranë, në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2023.

Gjithashtu, referuar dispozitave ligjore të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk rezulton në detyrat dhe kompetencat e këshillit të Qarkut krijimi dhe përbërja e grupeve të punës.

14. Vendimi nr. 59 datë 16.01.2023 “Për lirimin e sekretarit të Këshillit të Qarkut ” dhe Vendimi nr. 60 datë 16.01.2023 “Për emërimin e sekretarit të Këshillit të Qarkut”, përbëjnë “Akte administrative individuale”, nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

15. Vendimi nr. 62 datë 10.03.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 të Këshillit të Qarkut Tiranë.

16. Vendimi nr. 64 datë 10.03.2023 “Për miratimin e mbështetjes financiare për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës 2023 të grupit përfaqësues të Qarkut Tiranë”, ka miratuar mbështetjen financiare në vlerën prej 995,000 Lekë që do të përballohen nga buxheti i Këshillit të Qarkut Tiranë.

Gjithashtu, nuk është pjesë e dokumentacionit shoqërues të këtij vendimi:

1. Materiali udhëzues i Ministrisë së Kulturës me nr. 5682/2 prot., datë 27.10.2022 ku përcaktohet se çdo qark dhe bashki do të mundësojë mbështetjen financiare për organizimin e të gjitha fazave të përgatitjes dhe të pjesëmarrjes në FKGJ-Gjirokastrë 2023;

2. Urdhëri nr. 22, datë 17.01.2023 i Këshillit të Qarkut Tiranë, i cili ka hartuar zërat e shpenzimeve me vlerë 995,000 lekë (honorarë, qira sallash, veshje popullore, foni, transport) për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në FKGJ-Gjirokastrë 2023;

Vlen të theksojmë se rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika d, përcaktohet se:

“Prefekti i Qarkut ka të drejtë të kërkojë edhe dokumente të tjera, të cilat argumentojnë ligjshmërinë e vendimmarrjes sipas natyrës së vendimmarrjes.”

17. Vendimi nr. 66 datë 10.03.2023 “Për mbështetjen financiare për realizimin e botimit të vëllimit II dhe III të librit “Dëshmorët në rrënjët e Kombit Shqiptar ””, ka miratuar mbështetjen financiare në vlerën prej 250,000 Lekë që do të përballohen nga tepricat e fondeve buxhetore të vitit 2022, të cilat trashëgohen në vitin 2023.

Gjithashtu, mbështetja financiare e dhënë nga Këshilli i Qarkut, në vlerën prej 250,000 Lekë e cila është parashikuar të përballohet nga tepricat e fondeve buxhetore të vitit 2022, të cilat trashëgohen në vitin 2023, është në mospërputhje me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 28, pika 5, ku përcaktohet:

“Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore në fund të vitit buxhetor rezulton me fonde të papërdorura nga transferata specifike për funksionin për të cilin janë dhënë këto fonde, ato trashëgohen për të njëjtin funksion në vitin pasardhës buxhetor.

Gjithashtu, në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, zëri 604 nuk parashikon transferata për realizimin e botimeve të librave.”

18. Vendimi nr. 65 datë 10.03.2023 “Për mbështetjen financiare për realizimin e projektit me titull Etno-Piano”, ka miratuar mbështetjen financiare në vlerën prej 620,000 lekë që do të përballohen nga tepricat e fondeve buxhetore të vitit 2022, të cilat trashëgohen në vitin 2023.

Mbështetja financiare e dhënë nga Këshilli i Qarkut, në vlerën prej 620,000 lekë e cila është parashikuar të përballohet nga tepricat e fondeve buxhetore të vitit 2022, të cilat trashëgohen në vitin 2023, është në mospërputhje edhe me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 28, pika 5.

Gjithashtu, në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, zëri 604 nuk parashikon transferata për realizimin e këtyre projekteve.

Nuk është pjesë e dokumentacionit shoqërues të këtij vendimi Draft Projekti me titull “Etno-Piano”

Sipas rregullores së brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika d, “Prefekti i Qarkut ka të drejtë të kërkojë edhe dokumente të tjera, të cilat argumentojnë ligjshmërinë e vendimmarrjes sipas natyrës së vendimmarrjes”.

19. Vendimi nr. 61 datë 10.03.2023 “Për miratimin e tepricave të fondeve buxhetore 2022/2023 dhe përcaktimin e destinacioneve të tyre për vitin 2023”, ka miratuar tepricat e fondeve buxhetore për vitin 2022/2023 për tepricën e pakushtëzuar të vitit 2022 në vlerën prej 10,627,228,64 lekë.

Ky vendim është miratuar në mospërputhje me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 28, pika 5.

20. Vendimi nr. 63 datë 10.03.2023 “Për propozimin për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror”, ka miratuar ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm për 1. z. B.B. dhe 2. z. Th.Gj..

Gjithashtu, ky vendim përbën “Akt administrativ individual” dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

21. Vendimi nr. 40 datë 14.07.2022 “Për miratimin e projekt dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar projekt-dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë.

22. Vendimi nr. 41 datë 14.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë.

Ky vendim nuk është i shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, projekt vendimin dhe relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

23. Vendimi nr. 42 datë 14.07.2022 “Për propozimin për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” dhe dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” B.Z.H.””, Vendimi nr. 43 datë 14.07.2022 “Për propozimin për shpallje “Dëshmor i Atdheut” dhe dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” L.Dh.B.””, përbëjnë “Akte administrative individuale”, nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

24. Vendimi nr. 44 datë 14.07.2022 “Për propozimin për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror”, ka miratuar ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm për 1. z. Y.B., 2. z. D.B., 3. z. A.T., 4. z. A.H., 5. z. D.T., 6. z. I.R. dhe 7. z. Q.P..

Gjithashtu, ky vendim përbën “Akt administrativ individual” dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

25. Vendimi nr. 39 datë 15.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë.

26. Vendimi nr. 49 datë 9.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Tiranë për vitin 2023”, ka miratuar Buxhetin e Këshillit të Qarkut Tiranë për vitin 2023.

27. Vendimi nr. 50 datë 9.12.2022 “Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar kalendarit e programit buxhetor afatmesëm dhe Buxhetin e Këshillit të Qarkut Tiranë.

28. Vendimi nr. 51 datë 09.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Këshillit të Qarkut Tiranë.

29. Vendimi nr. 52 datë 09.12.2022 “Për vërtetimin e mandatit të Këshilltarit të Qarkut ” për z. H.K., Kryetar i Këshillit të Bashkisë Kamzë”, Vendimi nr. 53 datë 09.12.2022 “Për vërtetimin e mandatit të Këshilltarit të Qarkut” për zj. R.X., Kryetare e Këshillit të Bashkisë Kavajë”, Vendimi nr. 46 datë 13.09.2022 “Për vërtetimin e mandatit të Këshilltarit të Qarkut” për z. E.M., Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, Vendimi nr. 53 datë 09.12.2022 “Për vërtetimin e mandatit të Këshilltarit të Qarkut” për z. B.Sh., Kryetar i Bashkisë Vorë, përbëjnë “Akte administrative individuale”, nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

30. Vendimi nr. 45 datë 13.09.2022 “Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të rishikuar të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të rishikuar të Këshillit të Qarkut Tiranë.

31. Vendimi nr. 48 datë 06.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Këshillit të Qarkut Tiranë”, ka miratuar nivelin e pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, të Këshillit të Qarkut Tiranë.

Këto vendime (nr. 12 datë 21.12.2023, nr. 13 datë 21.12.2023, nr. 14 datë 21.12.2023, nr. 25 datë 21.12.2023, 26 datë 21.12.2023, nr. 58 datë 16.01.2023, nr. 62 datë 10.03.2023, nr. 64 datë 10.03.2023, nr. 66 datë 10.03.2023, nr. 65 datë 10.03.2023, nr. 61 datë 10.03.2023, nr. 63 datë 10.03.2023, nr. 40 datë 14.07.2022, nr. 44 datë 14.07.2022, nr. 39 datë 15.03.2022, nr. 49 datë 9.12.2022, nr. 50 datë 9.12.2022, nr. 51 datë 09.12.2022 dhe nr. 45 datë 13.09.2022, nr. 48 datë 06.10.2022), nuk janë të shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, projekt vendimin dhe relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë (viti 2022):**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, Bashkia Rrogozhinë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **82** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **79** vendime të këshillave bashkiakë, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **3** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Tiranë nga Këshilli Bashkiak Rrogozhinë, për vitin 2022 përzgjedhi për auditim **23** Vendime të konfirmuara të Këshillit Bashkiak, të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L7 dhe **3** vendime (të pakonfirmuara) të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L8.

**Nga auditimi u konstatua se 23** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

**12** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me “Manualin për hartimin e legjislacionit”, Shtojca E, relacion për projekt-aktin, faqe 303-306 dhe rregulloren

e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**7** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **janë konfirmuar në mungesë verifikimi të përputhshmërisë me dispozitat rregullatore në fuqi, përkatësisht si më poshtë:**

**1.** Vendimi nr. 33 datë 07.07.2022 “Për miratimin në parim të listës së subjekteve private të cilat përfitojnë nga granti i rindërtimit për nivelet e dëmtimit DS4-DS5 sipas akt-ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit”. Lista e subjekteve përbëhet nga 3 përfitues dhe vlera totale e përfitimit është në shumën prej 7,463,268 lekë.

**2.** Vendimi nr. 19 datë 24.03.2022 “Për miratimin në parim të listës së subjekteve private të cilat përfitojnë nga granti i rindërtimit për nivelet e dëmtimit DS5 sipas akt-ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit”. Lista e subjekteve përbëhet nga 2 përfitues dhe vlera totale e përfitimit është në shumën prej 5,661,310 lekë.

**3.** Vendimi nr. 6 datë 26.01.2022 “Për miratimin në parim të listës së subjekteve private të cilat përfitojnë nga granti i rindërtimit për nivelet e dëmtimit DS5 sipas akt-ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit”. Lista e subjekteve përbëhet nga 23 përfitues dhe vlera totale e përfitimit është në shumën prej 65,148,998 lekë.

**4.** Vendimi nr. 53 datë 21.09.2022 “Për miratimin në parim të listës së subjekteve private të cilat përfitojnë nga granti i rindërtimit për nivelet e dëmtimit DS5 sipas akt-ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit”. Lista e subjekteve përbëhet nga 12 përfitues dhe vlera totale e përfitimit është në shumën prej 38,662,896 lekë.

Si bazë ligjore për këto vendime është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, neni 29, pika 1, neni 54, gërma k dhe neni 55, pikat 2 dhe 6; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 113, pika 2, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendimi nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe të Komisionit të Posaçëm të tërmetit.

Nga auditimi u konstatua se këto vendime **nuk janë të shoqëruara me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertizat e thelluara janë hartuar në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34, ku përcaktohet:

“Akt ekspertiza e thelluar përmban, përveç të tjerave, **përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje**”. Ekspertiza jep një konkluzion të qartë mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit.”

Si dhe Vendimin nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, pika 5, ku përcaktohet:

“Akt ekspertiza e thelluar përfshin, si më poshtë vijon:

a) Mbledhjen e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik për objektin, si:

i. projektin arkitektonik;

ii. projektin konstruktiv;

iii. lejet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse;

iv. studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;

v. studimin sizmik;

- vi. procesverbalet e punimeve të maskuara;
- vii. raportin e llogaritjes së strukturës.
- b) Evidentimin e ndryshimeve gjeometrike në strukturën e objektit gjatë kohës së shfrytëzimit;
- c) Përditësimin gjeometrik të strukturës;
- ç) Mbledhjen e dokumentacionit të zbatimit;
- d) Katalogimin e dëmtimeve në objekt;
- dh) Gjykimin inxhinierik në bazë të raportit të llogaritjes së strukturës, të dokumentacionit të zbatimit dhe të shkallës së dëmtimit;
- e) Konkluzionet për origjinën dhe shkallën e dëmtimit të objektit dhe përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga aktekspertizat e mëparshme.,,

**Si konkluzion**, aktet e paraqitura në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk kanë qenë të shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**5.** Vendimi nr. 11 datë 23.02.2022 “Për dhënie autorizimi Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt: Lidhjen e marrëveshjes në emër të SH.A, UK Rrogozhinë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”

Si bazë ligjore për këto vendime është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 14, gërma gj, neni 54, pika 3, neni 55, gërma gj dhe neni 64; ligji nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 5, pika 1, gërma ç, VKM nr. 431 datë 11.07.2018, “Për krijimin, organizimin, funksionimin e agjencisë së U.K Rrogozhinë dhe Infrastrukturës së Mbetjeve” dhe shkresës nr. 950 prot., datë 28.01.2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Sa më sipër, është kompetencë e kryetarit të Bashkisë si person juridik dhe përfaqësues i saj, marrëdhënia me të tretët, për rrjedhojë nuk nevojitet autorizim nga Këshilli Bashkiak.

**6.** Vendimi nr. 46 datë 15.08.2022 “Për miratimin e marrëveshjes për dhënien e autorizimit për kryetarin e bashkisë Rrogozhinë z. E.M. për të firmosur kontratën, për grantin e fituar me nr. 163 prot., datë 25.07.2022, dhe me nr. reference të aplikimit: EU4M-CIP-2-A10, ndërmjet bashkisë Rrogozhinë dhe shoqatës N.A.L.A.S.E.E.N. me thirrjen e dytë të skemës së granteve BE për Bashkitë”.

Si bazë ligjore për këto vendime është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenet 14, 54, 55 dhe 64; VKB nr. 65 datë 24.12.2021 “Për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm 2022-202 dhe buxhetit vjetor 2022, të Bashkisë Rrogozhinë dhe institucioneve në varësi të saj” dhe letrës së njoftimit nr.163 datë 23.07.2022, për projektin “Empowering Future Leaders”.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse, vlerën që do të financohet nga bashkia dhe në cilin zë buxhetor është e përfshirë në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksin nr. 1, neni 4, gërma c.

**7.** Vendimi nr. 67 datë 23.11.2022 “Për miratimin e fondit nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Rrogozhinë për objektin mbrojtje me gabiona, përroi Sinaballaj, për mbrojtjen e banesave nga gërryerjet e këtij përroi”.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, ligji nr. 8756 datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar dhe ligji nr. 45 datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen civile”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim nuk është i shoqëruar me procesverbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara, në mospërputhje me Vendimin nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, gërma b.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

Nga auditimi u konstatua se **3** Vendime të Këshillit Bashkiak, **nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut**, të cilat nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit, në mospërputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**2** Vendime të kthyera për pabazueshmëri ligjore nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit, në mospërputhje me ligjin nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

Referuar kërkesave të mësipërme, institucioni i Prefektit (sektori juridik) ka detyrimin që për rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, **i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ka detyrimin e rishqyrtimit të aktit..**, proces i cili nuk është realizuar nga njësia e vetëqeverisje vendore.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, por nuk ka argumentim mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pavlefshmëri të vendimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16.

### **Verifikimi në vend 2022:**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2022**, janë krijuar grupet e punës me urdhërat nr. 123 datë 16.05.2022, “Për verifikimin e periudhës janar-mars 2022”; urdhëri nr. 199 datë 17.08.2022, “Për verifikimin e periudhës prill- qershor 2022”; urdhërin nr. 260 datë 02.11.2022, “Për verifikimin e periudhës korrik- shtator 2022” dhe urdhërin nr. 14 datë 23.01.2023, “Për verifikimin e periudhës tetor-dhjetor 2022”

**Nga auditimi u konstatua se** verifikimi në vend për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Në aktin kontrollit e mbajtura, përkatësisht aktin nr. 920/1 prot., datë 30.05.2022; aktin nr. 1578/1 prot., datë 26.08.2022; aktin nr. 2023/1 prot., datë 30.11.2022 dhe aktin nr. 115/1 prot., datë 10.02.2023, grupi i punës nuk ka konstatuar mangësi në drejtim të mospasqyrit të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk janë konstatuar akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose

jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësia vendore), në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**Konstatohet se:** Grupi i punës nuk ka monitoruar procedurën e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore mbi aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore;

Me shkresat nr. 618 prot., datë 04.05.2023, nr. 1259/2 prot., datë 25.09.2023, nr. 82/2 prot., datë 08.02.2024, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve.

**Konstatohet se:** Pas verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g., ku përcaktohet:

“Në përfundim të procedurës së kryerjes së verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut dërgon konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV objekt verifikimi.”

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë (viti 2023):**

Nga auditimi, rezultoi se për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **65** akte administrative nga Këshilli Bashkiak Rrogozhinë, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **61** vendime të këshillit bashkiak, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **4** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, për vitin 2023 përzgjedhi për auditim **14** Vendime të konfirmuara të Këshillit Bashkiak, të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L9 dhe **4** vendime (të pakonfirmuara) të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L10.

Nga auditimi u konstatua se: **14** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” e cila në aneksin nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c;

**6** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me “Manualin për hartimin e legjisllacionit”, Shtojca E, relacion për projekt aktin, faqe 303-306 dhe rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” e cila në aneksin nr. 1, neni 4, gërma b;

**3** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **janë konfirmuar në mungesë verifikimi të përputhshmërisë me dispozitat rregullatore në fuqi, përkatësisht si më poshtë:**

**1.** Vendimi nr. 20 datë 19.09.2023 “Për dhënie autorizimi Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt: Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe avokaturës së shtetit për të autorizuar e legjitimuar avokaturën e shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar Bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të RSh”.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 10018/2018, “Për avokaturën e shtetit” i ndryshuar, neni 5, pika 1, gërma ç, ligji nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar, neni 474, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se vendimi nuk gjen përputhshmëri ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, gërma gj. Sa më sipër, **është kompetencë e kryetarit të Bashkisë si person juridik dhe përfaqësues i saj, marrëdhënia me të tretët**, për rrjedhojë nuk nevojitet autorizim nga Këshilli Bashkiak.



2. Vendimi nr. 12 datë 27.03.2023 “Për mbylljen dhe disiplinimin e varrezës të Fshatit Zeshtik, Njësia Administrative Kryevindh”.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” dhe 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, ligji nr. 9220 datë 22.12.1999 “Për shërbimin publik të varrimit”, i ndryshuar, nenet 3, 12 dhe 13, me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë pjesë e dokumentacionit verifikues të këtij vendimi:

- Mendimi i Inspektoratit Sanitar Shtetëror, në mospërputhje me ligjin nr. 9220, datë 15.04.2004 “Për Shërbimin Publik të Varrimit”, neni 12, pika 1, ku përcakthet:

*Prishja e varrezës vendoset nga një komision i posaçëm, i ngritur nga këshilli bashkiak ose komunal, i cili harton dokumentin përkatës për verifikimin e gjendjes së plote të varrezës, **pasi është marrë mendimi i Inspektoratit Sanitar Shtetëror.***

Gjithashtu, referuar relacionit që shpjegon respektimin e procedurës ligjore, kjo zhvendosje e varreve kërkohet për të zhvilluar zonën dhe hapësira të kthehet në lulishte, në kundërshtim me ligjin nr. 9220, datë 15.4.2004 “Për Shërbimin Publik të Varrimit”, neni 13, pikat 1 dhe 2, ku përcaktohet:

*- Toka e një varreze, për të cilën është vendosur prishja, **nuk destinohet për përdorim tjetër pa kaluar 15 vjet nga varrimi i fundit që bëhet në të.** Gjatë kësaj periudhe, kjo varreze mbetet nën mbikëqyrjen e bashkisë ose komunës, e cila organizon mirëmbajtjen e saj.*

*- Përpara se të përdoret për qëllim tjetër, nga toka e varrezës duhet të hiqen me kujdes eshtrat në një thellësi jo më të madhe se 2 m dhe ato vendosen në ndërtesën e përbashkët të vendosjes së eshtrave ose në varrezën e re.*

Në relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore, nga ana e Drejtorisë së Politikave Urbane, nuk rezulton e shpjeguar procedura e mësipërme.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksin nr. 1, neni 4, gërma c, ku përcaktohet:

*“Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.”*

3. Vendimi nr. 42 datë 27.12.2023 “Për miratimin e Hartës së Plazhit Spille dhe Vilëbashtovë Bashkia Rrogozhinë në zbatim të VKM-së nr. 171, datë 27.03.2019, Për miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54 dhe Rregullorja e miratuar me VKM-në nr. 171 datë 27.03.2019 “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, neni 4, për përgatitjen e hartës për plazhet e lejuara nga Bashkia Rrogozhinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me propozim të Drejtorisë së Politikave Urbane dhe të Kryetarit të Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë pjesë e dokumentacionit verifikues të këtij vendimi:

- Urdhëri për ngritjen e grupit të punës i drejtuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në përbërje të së cilës ka përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare në mospërputhje me VKM-në nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, neni 2, pika 3, ku përcaktohet:

*“Harta e përgjithshme hartohet nga një grup pune i drejtuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në përbërje të së cilës ka përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe miratohet, brenda muajit janar, me vendim të këshillit bashkiak.”*

Nga auditimi i relacionit shoqëruar të VKB-së, rezulton se ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik do të bëhet proporcionalisht, **sipas raportit 70%/30% dhe në mënyrë pendikulare me vijën bregdetare, në mospërputhje** me VKM-në nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, neni 2, pika 2, ku përcaktohet:

“Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar si plazh privat/publik do të bëhet proporcionalisht, **sipas raportit 80%/20% dhe në mënyrë apendikulare me vijën bregdetare. Hapësira e çdo plazhi (publik ose privat) kufizohet me vijën bregdetare;**”

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

Nga auditimi u konstatua se **4** Vendime të Këshillit Bashkiak, **nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut**, të cilat nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit, në mospërputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

Referuar kërkesave të mësipërme, institucioni i Prefektit (sektori juridik) ka detyrimin që për rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, **i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ka detyrimin e rishqyrtimit të aktit**, proces i cili nuk është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, por nuk ka argumentim mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pavlefshmëri të vendimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16.

#### **Verifikimi në vend:**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2023,** janë krijuar grupet e punës me urdhërat nr. 96 datë 18.04.2023 “Për verifikimin e periudhës janar-mars 2023”; nr. 162 datë 07.09.2023 “Për verifikimin e periudhës prill-gusht 2023” dhe nr. 15 datë 18.01.2024 “Për verifikimin e periudhës shtator-dhjetor 2023”

**Nga auditimi u konstatua se** verifikimi në vend për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Në akt kontrollet e mbajtura, përkatësisht: aktin nr. 618/1 prot., datë 04.05.2023; aktin nr. 1259/1 prot., datë 25.09.2023 dhe aktin nr. 82/1 prot., datë 08.02.2024, grupi i punës nuk ka konstatuar mangësi në drejtim të mos pasqyrimin të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk janë konstatuar akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësia vendore), në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**Konstatohet se:** Grupi i punës nuk ka monitoruar procedurën e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore mbi aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore.

Me shkresat nr. 618 prot., datë 04.05.2023, nr. 1259/2 prot., datë 25.09.2023, nr. 82/2 prot., datë 08.02.2024, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve.

**Konstatohet se:** Pas verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Kavajë (viti 2022):**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **133** akte administrative nga Këshilli Bashkiak Kavajë, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **115** vendime të këshillit bashkiak dhe janë kthyer për papazueshmëri ligjore **18** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Tiranë nga Këshilli Bashkiak Kavajë, për vitin 2022 përzgjedhi për auditim **11** Vendime të konfirmuara të Këshillit Bashkiak, të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L11 dhe **18** vendime (të pakonfirmuara) të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L12.

Nga auditimi u konstatua se: **11** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” e cila në aneksin nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c;

**2** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me “Manualin për hartimin e legjislacionit”, Shtojca E, relacion për projekt aktin, faqe 303-306 dhe rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4 pika b; **7** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **janë konfirmuar në mungesë verifikimi të përputhshmërisë me dispozitat rregullatore në fuqi, përkatësisht si më poshtë:**

**1.** Vendimi nr. 8 datë 25.01.2022 “Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit privat A.A. ShPK & E.A. dhe Bashkisë Kavajë” ka miratuar Aktmarrëveshjen me nr. 227 prot., datë 18.01.2022 nënshkruar ndërmjet zhvilluesit privat A.A. ShPK & E.A. dhe Bashkisë Kavajë.

Referuar relacionit përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore, rezulton se kjo marrëveshje ndërmjet palëve lidhet për këmbimin e vlerës prej **11,842 828 Lekë** që lind si detyrim i pagesës së ndikimit në infrastrukturë (detyrim i zhvilluesit privat A.A. ShPK & E.A.), në 3 apartamente banimi (që do të kalojnë në pronësi të Bashkisë Kavajë). Për diferencën prej 1,259,190 lekë që bashkia i detyrohet zhvilluesit (e cila del si rezultat i mosrakordimit të sipërfaqeve të banimit në raport me detyrimin e pagesës së zhvilluesit), palët bien dakord që kjo diferencë të likuidohet brenda vitit 2022.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, neni 22, pika 1, neni 24, pika 1 dhe neni 54; ligji nr. 7895 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar dhe ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se kjo marrëveshje nuk është në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, pika 4, ku përcaktohet:

*“Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë ose të komunës, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi”.*

Si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 22, pika 2, ku përcaktohet:

*“Brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, për miratimin e kërkesës për leje ndërtimi, kërkuesi duhet të ngarkojë në sistem aktet që provojnë pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.*

2. Vendimi nr. 17, datë 22.02.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes prej 11800 m<sup>2</sup>, të pasurisë nr. 74, lloji i pasurisë PF (pa frutë), pasuri e cila është në përdorim të Bashkisë Kavajë, e regjistruar në ASHK Kavajë me indeks harte kadastrale K-34-100-(99-B), ZK 1397, me vendndodhje në fshatin Çetë”;

3. Vendimi nr. 61 datë 23.06.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të tokës bujqësore për pasurinë nr. 76 e llojit arë me sipërfaqe 31900 m<sup>2</sup>, e ndodhur në ZK. 1397 Çetë, Njësia Administrative Helmas, pasuri në administrim të Bashkisë Kavajë, e regjistruar në ASHK Kavajë”

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, neni 18, pika 2, neni 54, gërma e dhe neni 55, pika 4; ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, VKM nr. 5 datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen, në pronësi ose përdorim të Komunës Helmas të Qarkut të Tiranës”.

Nga auditimi u konstatua se këto dy vendime janë konfirmuar në mungesë të procesverbaleve të mbledhjeve, mbi pjesëmarrjen e tre të pestave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit, në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 54, gërma e dhe nenin 55, pika 4, ku përcaktohet:

*“54. Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:*

*e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;*

*55/4 -Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.”*

Në të dy vendimet e sipërpërmendura, kartelat e pasurive të paluajtshme, në seksionin B, të dhënat e titullit të pronësisë, adresë të pronarit kanë Bashkinë Fier. Për vendimin nr. 18 datë 22.02.2022 “Për miratimin e dhënies me qira të tokës bujqësore për pasurinë nr. 76 e llojit arë me sipërfaqe 31900 m<sup>2</sup>, e ndodhur në ZK. 1397 Çetë, Njësia Administrative Helmas, pasuri në administrim të Bashkisë Kavajë, e regjistruar në ASHK Kavajë”, nuk ka konfirmim nga DAMT, në mospërputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012.

**Si konkluzion**, aktet e paraqitura në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk kanë qenë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

4. Vendimi nr. 28 datë 23.03.2022 “Për disa ndryshime në VKB-në nr. 64, datë 11.06.2020 dhe VKB-në nr. 54 datë 30.06.2021, për miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit si rezultat i fatkeqësisë natyrore të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave

dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, VKM nr. 282, datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 5 datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKM nr. 401, datë 19.05.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 5 datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, VKB nr. 64 datë 11.06.2020, VKB nr. 54 datë 30.06.2021 “Për miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, si rezultat i fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019” dhe Akt ekspertizë e Institutit të Ndërtimit për vlerësimin e shkallës së dëmtimit, për 3 subjektet përfituese: F.H.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS1 dhe bëhet DS3); R.Sh.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3) dhe D.T. (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3).

**Nga auditimi, u konstatua se** vendimi është konfirmuar në mungesë të relacionit përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore mbi rivlerësimin e 3 banesave, në mospërputhje me “Manualin për hartimin e legjislacionit”, Shtojca E, relacionin për projekt aktin, faqe 303-306 dhe rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b;

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**5.** Vendimi nr. 35 datë 26.04.2022 “Për dhënien e ndihmës financiare z. S.H. për dëmet e shkaktuara në banesën e tij”.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ligji nr. 8756 datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile” i ndryshuar, ligji nr. 45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”, VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes së përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, VKB nr. 128 datë 23.04.2020 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2021”.

**Nga auditimi u konstatua se** mungon vlerësimi i dëmeve për të përcaktuar masën e dëmshpërblimit në shumën prej **692,700 lekë**, në mospërputhshmëri me VKM nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, gërmat b, ç, d dhe e.

**6.** Vendimi nr. 119 datë 14.12.2022 “Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit “Mbështetje për Zhvillim 2022-2024” ndërmjet projektit Bashki të Forta dhe Bashkisë Kavajë”.

Si bazë ligjore është referuar neni 113 pika 2 i Kushtetutës dhe ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se vendimi nuk gjen përputhshmëri me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, gërma gj. Sa më sipër, **është kompetencë e kryetarit të Bashkisë si person juridik dhe përfaqësues i saj, marrëdhënia me të tretët**, për rrjedhje nuk nevojitet autorizim nga Këshilli Bashkiak.

Gjithashtu, u konstatua se në pikën 2 të VKB-së nr. 119 datë 14.12.2022 citohet: “Efektet financiare nëpërmjet bashkëfinancimit që rrjedhin nga zbatimi i bashkëpunimit të këtij memorandumi do të përballohen nga të ardhurat e Bashkisë Kavajë”.

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**7. Vendimi nr. 84 datë 10.08.2022 “Për miratimin e zbatimit të projektit Promovimi i Praktikave dhe Mjeteve Inovative për reduktimin e emëttimeve të karbonit dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë në Bashkinë Kavajë”.**

Ky vendim, pjesë të dispozitivit ka bashkëfinancimin në vlerën 6,000 Euro, por **nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**Nga auditimi u konstatua se** vetëm 2 nga vendimet e kthyera për pabazueshmëri ligjore janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe janë paraqitur në institucionin e Prefektit, 16 vendime të kthyera nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore në mospërputhje kjo të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 gërma b.

Referuar kërkesave të mësipërme, institucioni i Prefektit (sektori juridik) ka detyrimin që për rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, **i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ka detyrimin e rishqyrtimit të aktit..**”, proces i cili nuk është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, por nuk ka argumentim mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pavlefshmëri të vendimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16.

#### **Verifikimi në vend:**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2022**, janë krijuar grupet e punës me urdhërat nr. 119 datë 16.05.2022 “Për verifikimin e periudhës janar-mars 2022”; urdhëri nr. 198 datë 17.08.2022 “Për verifikimin e periudhës prill-qershor 2022”; urdhërin nr. 257 datë 02.01.2022 “Për verifikimin e periudhës korrik-shtator 2022” dhe urdhërin nr. 15 datë 23.01.2023 “Për verifikimin e periudhës tetor-dhjetor 2022”

**Nga auditimi u konstatua se** verifikimi në vend për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Në aktin kontrollor e mbajtura, përkatësisht: aktin nr. 916/1 prot., datë 30.05.2022; aktin nr. 1577/1 prot., datë 26.08.2022; aktin nr. 2020/1 prot., datë 30.11.2022 dhe aktin nr. 116/1 prot., datë 10.02.2023, grupi i punës nuk ka konstatuar mangësi në drejtim të mos pasqyrimin të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk janë konstatuar akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsytet e mos rishqyrtimit të akteve nga njësia vendore), në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**Konstatohet se** grupi i punës nuk ka monitoruar procedurën e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore mbi aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore.

- Me shkresat nr. 916/2 prot., datë 30.05.2022, nr. 1577/2 prot., datë 26.08.2022, nr. 2020/2 prot., datë 30.11.2022 dhe nr. 116/2 prot., datë 10.02.2023 Prefekti i Qarkut ka përcjellë aktin kontrollor mbi verifikimet në vend të vendimeve.

**Konstatohet se** pas verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Kavajë (viti 2023):**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, Bashkia Kavajë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **86** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **80** vendime të këshillave bashkiakë, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **6** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, për vitin 2023 përzgjedhi për auditim **12** Vendime të konfirmuara të Këshillit Bashkiak, të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L13 dhe **6** vendime (të pakonfirmuara) të cilat janë paraqitur në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L14.

Nga auditimi u konstatua se **12** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

**3** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **nuk janë të shoqëruara me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me “Manualin për hartimin e legjislacionit”, Shtojca E, relacion për projekt aktin, faqe 303-306 dhe rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

**7** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara), **janë konfirmuar në mungesë verifikimi të përputhshmërinë me dispozitat rregullatore në fuqi, përkatësisht si më poshtë:**

**1.** Vendimi nr. 4 datë 20.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuar nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”. Ky vendim ka miratuar shumën prej **234,499,204 Lekë**, në zbatim të programeve të rindërtimit.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve në disa programe të procesit të rindërtimit” të ndryshuar, Urdhëri nr. 176/1 datë 18.07.2022, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për shqyrtimin e disa kërkesave të qytetarëve të cilët kanë qenë përfitues me VKB dhe për mbylljen e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë”, si dhe në vijim të raportit të Komisionit të Posaçëm.

**Nga auditimi u konstatua se ky vendim nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

Vendimi nuk shoqërohet me dokumentacion justifikues (ankesat e qytetarëve, procedura e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore, akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit etj.) mbi rivlerësimin e bërë, në mospërputhje me Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pika 19.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

**2.** Vendimi nr. 30 datë 23.03.2023 “Për një ndryshim/shtesë të VKB-së nr. 4 datë 20.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve në disa programe të procesit të rindërtimit” të ndryshuar, Urdhëri nr. 176/1 datë 18.07.2022, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për shqyrtimin e disa kërkesave të qytetarëve të cilët kanë qenë përfitues me VKB dhe për mbylljen e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë”, si dhe në vijim të raportit të Komisionit të Posaçëm.

**Nga auditimi u konstatua se për 3 subjektet përfituese: E.Sh. (Sh.), vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 2,241,707 Lekë dhe nga rivlerësimi është në vlerën prej 3,412,137 lekë; D.D., vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 12,094,026 lekë për tre familjet D., për ndërtimin e një ndërtese në bashkëpronësi dhe rivlerësimi i bërë është në vlerën prej 2,241,707 lekë dhe L.B. shtohet si përfitues i një apartamenti 2+1, **vendimi nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.**



Vendimi nuk shoqërohet me dokumentacion justifikues (ankesat e qytetarëve, procedura e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore, akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit etj.) mbi rivlerësimin e bërë.

Sa më sipër, nuk është në përputhje me Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pika 19.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**3.** Vendimi nr. 84 datë 10.08.2022 “Për shembjen e detyruar të ndërtesave të dëmtuara, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019, mbështetur në akt ekspertizën e thelluar të Institutit Shtetëror të Ndërtimit Tiranë”. Lista e banesave të cilat do të nënshtrohen prishjes së detyruar fillon me numrin rendor 1 dhe përfundon me numrin 109.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve në disa programe të procesit të rindërtimit” të ndryshuar,

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore**, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b dhe Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 35, pika 1, ku përcaktohet:

“Prishja e detyruar e një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, sipas përfundimeve në akt konstatimet apo akt vlerësimit paraprake të Institutit të Ndërtimit ose në akt ekspertizën e thelluar, si dhe nëse riparimi kushton më shumë se ndërtimi nga e para, sipas rekomandimeve në aktin e ekspertizës së thelluar, të hartuar sipas parashikimeve në këtë ligj.”

**4.** Vendimi nr. 62 datë 29.09.2023 “Për shembjen e detyruar të ndërtesës së Kopshtit Fiqiri Kurti si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019”.

Si bazë ligjore është referuar neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe të procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore” VKM nr. 1563, datë 26.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Kavajë të Qarkut Tiranë”, duke u bazuar dhe në raportet e ekspertimit dhe ekspertizën e thelluar të Institutit Shtetëror të Ndërtimit Tiranë me nr. 768/4 prot., datë 04.05 2023.

**Nga auditimi u konstatua se** Urdhëri nr. 102, datë 24.04.2023, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26.11.2019, është në tejkalim

(rreth 4 vite) nga emergjenca në mospërputhje ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 3, ku përcaktohet:

**“Planet për emergjencat civile marrin në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, të të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të shtresave në nevojë dhe grave.”**

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertiza e thelluar është hartuar në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34 dhe Vendimin nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, pika 5.

**5.** Vendimi nr. 72 datë 20.11.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar nga AKMC për përballimin e situatave emergjente”, ka miratuar fondin në **shumën prej 8,000,000 lekë**, për blerje automjeteve që do të përdoren për përballimin e situatave emergjente me Kodin 91707AG, “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së automjeteve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës” dhe miratuar fondin në **shumën prej 3,349,000 lekë**, për ndërhyrje të menjëhershme në objektin industrial ish Fabrika e Letrës, me Kodin 91707AB.

Si bazë ligjore është referuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” ndryshuar me VKM nr. 290 datë 17.05.2023, bazuar në shkresën e AKMC-së për fondin dhënë Bashkisë Kavajë për emergjencat civile për vitin 2023.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është paraqitur asnjë preventiv mbi llojin dhe vlerën e mjeteve që do të blihen për përballimin e situatave emergjente në mospërputhshmëri me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pika b.

Për ndërhyrjen e menjëhershme në objektin industrial ish Fabrika e Letrës, nuk është paraqitur Akt Ekspertiza e thelluar në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 35, pika 1.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**6.** Vendimi nr. 74 datë 20.11.2023 “Për shprehjen në parim për miratimin e hartës së përgjithshme të stacioneve të plazheve të lejuara dhe përcaktimi i vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në zonën e plazhit, për sezonin turistik 2024”.

Nga auditimi u konstatua se nuk është pjesë e dokumentacionit verifikues të këtij vendimi urdhëri për ngritjen e grupit të punës i drejtuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në përbërje të së cilës ka përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare në mospërputhje me VKM-në nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, neni 2, pika 3.

**7.** Vendimi nr. 84 datë 19.12.2023 “Për miratimin e ndryshimeve të masës së përfitimit të familjeve të miratuara me VKB-në nr. 62 datë 21.07.2021, VKB-së nr.88, datë 11.11.2021, VKB-së nr.4, datë 20.01.2023”.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit,

autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve në disa programe të procesit të rindërtimit” të ndryshuar, Urdhëri nr. 917 datë 12.12.2023, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësimin dhe rivlerësimin e dosjeve të aplikuara nga qytetarët, për mbylljen e procesit të rindërtimit në Bashkinë Kavajë”, si dhe në vijim të raportit të Komisionit të Posaçëm.

**Nga auditimi u konstatua se** për 3 subjekte përfituese përkatësisht F.I.H., masa e përfitimit ishte apartament 2+1 dhe bëhet 2+1 dhe 1+1; H.R.Rr., masa e përfitimit ishte apartament 1+1 dhe bëhet 2+1 dhe Sh.M.L., masa e përfitimit ishte 1+1 dhe bëhet 2+1.

Kërkesat e qytetarëve janë në tejkallim të afateve ligjore të parashikuara për të drejtën e ankimit dhe nuk kanë si dokumentacion shoqërues certifikatat e gjendjes familjare më datë 26.11.2019 në mospërputhje me Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pika 19.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i pashoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

**Nga auditimi u konstatua se** vetëm 1 nga vendimet e kthyera për pabazueshmëri ligjore është rishqyrtuar nga njësia vendore dhe është paraqitur në institucionin e Prefektit, 5 vendime të kthyera nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore, në mospërputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

Referuar kërkesave të mësipërme, institucioni i Prefektit (sektori juridik) ka detyrimin që për rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, **i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ka detyrimin e rishqyrtimit të aktit dhe dërgimin në gjykatën administrative**”, proces i cili nuk është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, por nuk ka argumentim mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pavlefshmëri të vendimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16.

#### **Verifikimi në vend:**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2023,** janë krijuar grupet e punës me urdhërat nr. 161 datë 07.09.2023 “Për verifikimin e periudhës prill-gusht 2023”; urdhëri nr. 17 datë 18.01.2024, “Për verifikimin e periudhës shtator-dhjetor 2023”;

**Nga auditimi u konstatua se** verifikimi në vend për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Në aktin kontrollit e mbajtura nga grupi i punës përkatësisht aktin nr. 1258/1 prot., datë 25.09.2023 dhe aktin nr. 84/1 prot., datë 08.02.2024, grupi i punës nuk ka konstatuar mangësi në drejtim të mos pasqyrimin të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i

këshillit të bashkisë etj. dhe nuk u konstatuan akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (*dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësia vendore*), në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**Konstatohet se:** Grupi i punës nuk ka monitoruar procedurën e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore mbi aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore;

Me shkresat nr. 1258/2 prot., datë 25.09.2023, nr. 84/2 prot., datë 08.02.2024, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve.

**Konstatohet se:** Pas verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Kamzë (viti 2022):**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga Bashkia Kamzë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **174** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **165** vendime të këshillave bashkiakë, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **9** vendime.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej për verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të depozituara në Prefektin e Qarkut Tiranë nga Bashkia Kavajë, për vitin 2022 përzgjedhi për auditim **35** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **9** vendime (të pakonfirmuara).

Nga Këshilli i Bashkisë Kamzë, gjatë viteve 2022-2023 janë miratuar 37 Vendime të cilat përbëjnë “Akte administrative individuale” për “dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”. Këto vendime janë dhënë për arsye shëndetësore, për familje të cilat kanë dalë nga sistemi i pikëzimit dhe nuk kanë të ardhura ose për familje të cilat janë kushtet e varfërisë ekstreme.

Të gjitha këto vendime, nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishin pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi janë vendime individuale, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

Si bazë ligjore për këto raste, nga njësia vendore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB-të përkatëse për buxhetet vjetore, etj.

Në rastet e VKB nr. 143, datë 25.11.2022 dhe nr. 165 datë 21.12.2022, me objekt “...pajisjen me certifikatë pronësie të objekteve të rindërtuara...”, si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM nr. 748, datë 09.12.2021 “Për kalimin te Bashkitë Durrës, Shijak dhe Kamzë të njësive individuale të banimit” dhe VKM nr. 319, datë 18.05.2022 “Për kalimin te Bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë të njësive individuale të banimit”.

Nga auditimi, u konstatua se asnjë nga rastet e trajtuara nuk përmbush kriteret e përcaktuara në bazën ligjore të sipërcituar për dhënie/përfitim të ndihmës ekonomike.

Në rastin e ndihmave të dhëna për arsye shëndetësore, u konstatua se VKB-të përkatëse janë dhënë në kundërshtim me ligjin nr. 10383, datë 24.02.20211, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11, “Pagesat e drejtpërdrejta”, pika 1, ku përcaktohet:

*“Personat e siguruar marrin pjesë në pagesën e një pjese të çmimit të shërbimit shëndetësor që u jepet. Masa, shërbimet dhe mënyra e pagesës së drejtpërdrejtë vendoset në çdo rast nga Këshilli i Ministrave.”*

Për VKB-të nr. 14, datë 15.02.2023, 26, datë 17.03.2023, 28, datë 17.03.2023, 53, datë 18.04.2023 dhe nr. 55, datë 18.04.2023, u konstatua se janë miratuar në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”, pika 4, ku përcaktohet:

*“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”*

Për vendimet nëpërmjet të cilave është miratuar ndihmë ekonomike për familje të cilat janë në kushte të vështira ekonomike, sipas listave bashkëlidhur, nuk janë zbatuar dhe nuk argumentohet përmbushja e kriterëve të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kapitulli 4, pikat 5, 7 dhe 13, etj., ku përcaktohet:

*“5. Familjet në nevojë, në momentin që do të përzgjidhen nga lista e familjeve, duhet të kenë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistratit Elektronik Kombëtar për ndihmë ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit. 7. Për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duhet të jetë kryer paraprakisht verësimi social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. 13. Nuk mund të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike: a) familjet të cilat nuk kanë aplikuar për ndihmë ekonomike nëpërmjet Regjistratit Elektronik Kombëtar; b) familjet të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike sipas kriterëve I, II dhe III, të këtij vendimi.”*

Si bazë ligjore për këto raste, nga njësia vendore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB-të përkatëse për buxhetet vjetore, etj.

VKB-të për këto raste janë paraqitur në në Aneksin 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela L15.

VKB nr. 5, datë 23.01.2023, “Për miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i Bashkisë”, nuk duhet të kishte marrë konfirmimin e ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit, pasi kriteret e përcaktuara në të, nuk mbështeten në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Pavarësisht se në ligjin nr. 57, datë 18.07.2019, neni 21 “Roli i këshillit bashkiak”, përcaktohet se “Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit...”, si dhe në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019, Kreu IV, pika 1 përcaktohet se “Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk

janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, këto kritere nuk duhet të dalin jashtë përcaktimeve në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019, Kreu I.

**15** Vendime të Këshillit Bashkiak ( të konfirmuara) janë konfirmuar në mungesë verifikimi të përputhshmërisë me dispozitat rregullatore në fuqi, si më poshtë:

1. Vendimi nr. 48 datë 19.04.2022, “Mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Bashkisë Kamzë dhe UNDP për zbatimin e projektit ReLoaD2” ka miratuar buxhetin në vlerën prej **597,493 lekë** për zbatimin e projektit ReLoaD2 në strukturën buxhetore Gr.0. Prog. 6140 Art 602.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 8788/2001, “Për organizatat jo fitimprurëse”, i ndryshuar.

Ky vendim **nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se me shkresën nr. 2547 prot., datë 29.03.2022, Bashkia Kamzë ka njoftuar UNDP-në se ka vendosur të japë kontributin prej **597,493 lekë** për zbatimin e projektit ReLoaD2. Ky njoftim është bërë më datë 29.03.2022, para se Këshilli Bashkiak të miratonte buxhetin në vlerën prej **597,493 lekë** për zbatimin e projektit ReLoaD2.

**Si konkluzion**, akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

2. Vendimi nr. 49 datë 19.04.2022, “Mbi miratimin e një shtese në listën e vendimit nr. 97 datë 10.11.2021 së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të institutit të ndërtimit “Për shembje””

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa procese të rindërtimit dhe projektet model”, VKM nr. 8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim nr. 22, datë 13.02.2020 të Këshillit Bashkiak Kamzë “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, Urdhërit nr. 479, datë 22.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit për aplikuesit në njësinë Administrative Paskuqan për dosjet e administruara sipas urdhërit nr. 456 datë 10.09.2021”.

**Nga auditimi u konstatua se** për familjet e shtuara në listën e subjekteve përfitues, përkatësisht J.M.N. dhe A.M.N., nuk është paraqitur dokumentacion justifikues që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, në mospërputhje me VKM-në nr. 5, datë 06.01.2020

*“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pikat 13 dhe 14, ku përcaktohet:*

**“13. Njësitë e vetëqeverisjes vendore regjistrojnë aplikimet në një sistem elektronik, i cili jep mundësinë e përpunimit të të dhënave, si më poshtë vijon:**

a) emrin, atësinë, mbiemrin;

b) numrin e aplikimit;

c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;

ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit dhe tipi i projektit model të zgjedhur ose projektin e kryer vetë nga kërkuesi/aplikanti;

d) adresën e kërkuetit;

dh) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;

e) akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme;

ë) çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar;

f) të dhënat e llogarisë bankare të kërkuetit pranë një banke të nivelit të dytë.

**14. Në qoftë se aplikimi paraqet mangësi të të dhënave, sipas parashikimeve të këtij vendimi, struktura/t përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e regjistrimit të aplikimit, i kërkon/jnë me shkrim aplikantit të korrigjojë pasaktësitë, duke përcaktuar edhe afatin e nevojshëm për plotësimin e tyre. Struktura/t përgjegjëse ofron/jnë ndihmë aktive për plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit për cilindo aplikues, duke u kujdesur që çdo individ/familje të marrë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.”**

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 *“Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”*, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**3.** Vendimi nr. 95 datë 19.07.2022, *“Mbi miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve të vendimit nr. 67 datë 17.06.2022 të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për banesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të institutit të ndërtimit me nivel dëmtimi “Për shembje”*” ka miratuar ndryshimin në listën e subjekteve përfitues të Vendimit nr. 67 datë 17.06.2022, bazuar në akt ekspertizën e thelluar nr. 850/3 prot., datë 09.05.2022 nga Instituti i Ndërtimit për objektin e z. E.B. dhe A.B.. Dy subjektet kanë jetuar në një objekt të përbashkët por në hyrje të ndryshme, së bashku me z. P.B. i cili është kualifikuar me Vendimin nr. 67, datë 17.06.2022.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, *“Për përbashkimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 *“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”* VKM nr. 750, datë 27.11.2019 *“Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”* të ndryshuar, VKM nr. 904, datë 24.12.2019 *“Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa procese të rindërtimit dhe projektet model”*, VKM nr. 8, datë 06.01.2020 *“Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”*, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”*, Vendim nr. 22, datë 13.02.2020 të Këshillit Bashkiak Kamzë *“Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga*

programet e rindërtimit”, Urdhërit nr. 479, datë 22.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit për aplikuesit në njësinë Administrative Paskuqan për dosjet e administruara sipas urdhërit nr. 456 datë 10.09.2021”.

Ky vendim **nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**Nga auditimi u konstatua se** për familjet e shtuara në listën e subjekteve përfitues, përkatësisht E.B. dhe A.B., nuk është paraqitur dokumentacion justifikues që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar, në mospërputhje me VKM-në nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pikat 13 dhe 14.

**4.** Vendimi nr. 93 datë 19.07.2022 “Mbi miratimin e shembjes së shkollës 9-vjecare “Lidhja e Prizrenit”, në rrugën “Demokracia”, Paskuqan 1, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019”, ka miratuar shembjen e shkollës 9-vjecare “Lidhja e Prizrenit”, sipas aktektimizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit.

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me projekt vendimin dhe relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore,** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**5.** Vendimi nr. 100 datë 27.07.2022 “Mbi shfuqizimin e VKB-së nr. 14 datë 03.02.2022 për subjektin në listën aplikuese i cili ka përfituar nga programi i rindërtimit për objektet kolektive (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”

**Nga auditimi u konstatua se** subjekti aplikues, **A.Z.Z.** shfuqizohet nga lista e subjekteve përfitues pasi nuk ka patur banesë në objektet kolektive (Pallatet Valias), bazuar në vërtetimin e UKK-së ku rezulton se banesa është në rrugën “Shpresa”. Në pikën 3 të vendimit parashikohet se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Kamzë.

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore dhe pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**6.** Vendimi nr. 107 datë 17.08.2022 “Për miratimin e listës së subjekteve, posedues të ndërtimeve pa leje që preken nga realizimi i projektit unaza e madhe e Tiranës, sheshi shqiptonja, bulevardi i ri, Shkozë për njësinë administrative Paskuqan, të cilët përfitojnë subvencionim të qirasë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, ka miratuar listën e 76 subjekteve përfitues për bonus qiraje që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiptonja, bulevardi i ri, Shkozë për njësinë administrative Paskuqan”.

**Nga auditimi u konstatua se ky vendim nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**7.** Vendimi nr. 109 datë 07.09.2022 “Mbi miratimin e shembjes së “Qendrës Shëndetësore”, ndodhur në adresën: Rruga “Besnik Hidri”, Zall Mner, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019” ka miratuar shembjen e “Qendrës Shëndetësore”, Zall Mner, sipas aktektimizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit.



**Nga auditimi u konstatua se ky vendim nuk është i shoqëruar relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore,** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertiza e thelluar është hartuar në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34 dhe Vendimin nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, pika 5.

**8. Vendimi nr. 112 datë 07.09.2022 “Mbi miratimin e listës shtesë të subjekteve posedues të ndërtimeve pa leje nga realizimi i projektit unaza e madhe e Tiranës, sheshi shqiptonja, bulevardi i ri, Shkozë për njësinë administrative Paskuqan, të cilët përfitojnë subvencionim të qirasë sipas parashikimeve të vkm-së nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”.**

**Nga auditimi u konstatua se ky vendim nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**9. Vendimi nr. 117 datë 29.09.2022, “Mbi miratimin e një ndryshimi në listat e vendimeve nr. 54 datë 02.06.2020 dhe nr. 88, datë 17.07.2020, të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për banesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të institutit të ndërtimit me nivel dëmtimi “Për shembje””** ka miratuar një ndryshim në listat e vendimeve nr. 54 datë 02.06.2020 dhe nr. 88, datë 17.07.2020, ku objektet e z. B.Ç. dhe z. F.S. janë klasifikuar me dëmtime të kategorisë DS-5.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa procese të rindërtimit dhe projektet model”, VKM nr. 8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim nr. 22, datë 13.02.2020 të Këshillit Bashkiak Kamzë “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, Urdhërit nr. 479, datë 22.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit për aplikuesit në njësinë Administrative Paskuqan për dosjet e administruara sipas urdhërit nr. 456 datë 10.09.2021”.

**Nga auditimi u konstatua se ky vendim nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertiza e thelluar është hartuar në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34 dhe Vendimin nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, pika 5.

**10.** Vendimi nr. 120 datë 29.09.2022 “Mbi një shtesë në vendimin nr. 137 datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kamzë” ka miratuar një tarifë shfrytëzimi të hapësirës në Tregun Publik Kamzë, në vlerën 400 lekë/m<sup>2</sup> në muaj.

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, VKB nr. 137 datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kamzë”, ligji nr. 115/2014, “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 5 datë 17.01.2022 “Mbi krijimin, organizimin dhe funksionimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike”, VKB nr. 160 datë 22.12.2021 “Mbi ndryshimin e VKB nr. 5 datë 17.01.2022 “Mbi krijimin, organizimin dhe funksionimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike””.

**Nga auditimi u konstatua se** propozimi i ardhur nga “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” mbi tarifën e shfrytëzimit të hapësirës në Tregun Publik Kamzë, është **në vlerën 200 lekë/m<sup>2</sup> në muaj.**

VKB nr. 120 datë 29.09.2022 “Mbi një shtesë në vendimin nr. 137 datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kamzë” ka miratuar një tarifë shfrytëzimi të hapësirës në Tregun Publik Kamzë, në vlerën 400 lekë/m<sup>2</sup> në muaj.

**Në vendimin nr. 137 datë 22.12.2021,** “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kamzë”, në pikën C.4. janë vendosur tarifat do të aplikohen mbi të gjitha subjektet, të cilët shfrytëzojnë hapësirat publike për të kryer aktivitete të ndryshme. Baza e tarifës për zënien e hapësirës publike për qëllime veprimtarie ekonomike fitimprurëse është sipërfaqja në m/katror, që vihet në shfrytëzim nga subjekti për ushtrim aktiviteti dhe llogaritjet me bazë mujore. Zënien e hapësirës publike, bashkia e ka ndarë në tre zona, si më poshtë:

- Zona A: 200 lekë/muaj për m<sup>2</sup>;
- Zona B: 70 lekë/muaj për m<sup>2</sup>;
- Zona C: Qendër Babrru, 40 lekë/muaj për m<sup>2</sup>;
- Zona C: I gjithë territori i bashkisë Kamzë, 10 lekë/muaj për m<sup>2</sup>.

Miratimi i tarifës së shfrytëzimit të hapësirës në Tregun Publik Kamzë, në vlerën 400 lekë/m<sup>2</sup> në muaj është i pa argumentuar dhe në mospërputhje me tarifat e tjera të miratuara në vendimin nr. 137 datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kamzë”

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**11.** Vendimi nr. 128 datë 14.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të çerdheve të Bashkisë Kamzë për vitin 2022”, ka miratuar nivelin e pagave për punonjëset e çerdheve në Bashkinë Kamzë.

Ky vendim **nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**12.** Vendimi nr. 109 datë 07.09.2022 “Mbi miratimin e shembjes së shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, me adresë në rrugën: “Zhvillimi”, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019” ka miratuar shembjen e shkollës 9-vjeçare “Demokracia”, sipas aktepertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit.

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore,** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**13.** Vendimi nr. 139 datë 19.02.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime të VKB-së nr. 137 datë 22.12.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Kamzë””, ka miratuar në pikën Lehtësira dhe Përjashtime, shtesën si më poshtë:

Për familjet që rrjedhin nga i njëjti trung familjar dhe jetojnë në të njëjtën banesë (nëse nuk kanë banesë) nga 6000 lekë për familje – në 0 lekë për familje.

**Ky vendim nuk është i shoqëruar me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore,** në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.

**14.** Vendimi nr. 14 datë 03.02.2022, “Mbi miratimin e listës të subjekteve të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për objektet kolektive (Pallatet e Valiasit), të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”, ka miratuar listën e subjekteve të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për objektet kolektive (Pallatet e Valiasit).

Si bazë ligjore është referuar ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të KM, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” VKM nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, VKM nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa procese të rindërtimit dhe projektet model”, VKM nr. 8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim nr. 22, datë 13.02.2020 të Këshillit Bashkiak Kamzë “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”.

- 10 Familje janë kualifikuar për të përfituar apartamente 1+1;

- 17 Familje janë kualifikuar për të përfituar apartamente 2+1;

- 13 Familje janë kualifikuar për të përfituar apartamente 3+1;

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim **nuk është i shoqëruar me Akt ekspertizën e thelluar,** në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34.

**Si konkluzion:** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**15.** Vendimi nr. 31 datë 11.03.2022 “Mbi shfuqizimin e listës së subjekteve aplikues të cilët kanë përfituar nga programi i rindërtimit për objektet kolektive, (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”

**Nga auditimi u konstatua se** komisioni i posaçëm ka konstatuar se, 6 Subjekte aplikuese duhen shfuqizuar pasi nga verifikimet e bëra ka rezultuar se këta aplikues nuk kanë dokumentacion provues ligjor, ose duhen bashkuar në bazë të numrit të frymëve ose kanë rezultuar se nuk kanë disponuar njësi banimi por njësi biznesi në zonën e zhvillimit për rindërtim në Pallatet e Valiasit.

Në pikën 3 të vendimit parashikohet se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Kamzë.

***Ky vendim nuk është i shoqëruar me pasqyrat përkatëse mbi efektet që rrjedhin si zbatim i tij në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma b.***

**9 Vendime të Këshillit Bashkiak, nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut**

**Nga auditimi u konstatua se** vendimet e të kthyera për pabazueshmëri ligjore nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit në mospërputhje me ligjin nr. “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

Referuar kërkesave të mësipërme, institucioni i Prefektit (sektori juridik) ka detyrimin që për rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, ***i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ka detyrimin e rishqyrtimit të aktit..***”, proces i cili nuk është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, por nuk ka argumentim mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pavlefshmëri të vendimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16.

**Verifikimi në vend:**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2022**, janë krijuar grupet e punës me urdhërat nr. 121 datë 16.05.2022 “Për verifikimin e periudhës janar-mars 2022”; urdhëri nr. 196 datë 17.08.2022 “Për verifikimin e periudhës prill-qershor 2022”; urdhëri nr. 258 datë 02.11.2022 “Për verifikimin e periudhës korrik-shtator 2022” dhe urdhëri nr. 18 datë 23.01.2023 “Për verifikimin e periudhës tetor-dhjetor 2022.

**Nga auditimi u konstatua se** verifikimi në vend për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Në akt kontrollet e mbajtura nga grupi i punës, përkatësisht aktin nr. 918/1 prot., datë 30.05.2022; aktin nr. 1575/1 prot., datë 26.08.2022; aktin nr. 2021/1 prot., datë 30.11.2022 dhe aktin nr. 119/1 prot., datë 10.02.2023, grupi i punës nuk ka konstatuar mangësi në drejtim të mos pasqyrit të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk u konstatuan akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësia vendore), në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**Konstatohet se** grupi i punës nuk ka monitoruar procedurën e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore mbi aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore;

Me shkresat nr. 918/2 prot., datë 30.05.2022, nr. 1575/2 prot., datë 26.08.2022 dhe nr. 2121/3 prot., datë 30.11.2022, nr. 119/2 prot., datë 10.02.2023, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve.

**Konstatohet se** pas verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Kamzë (viti 2023):**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nga Bashkia Kamzë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **118** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **117** vendime të këshillit bashkiak dhe është kthyer për pabazueshmëri ligjore **1** vendim.

Grupi i auditimit të KLSH-së, për vitin 2022 përzgjodhi për auditim **11** Vendime të Këshillit Bashkiak (të konfirmuara) dhe **1** vendim (të pakonfirmuar).

**1.** Vendimi nr. 10 datë 23.01.2023 *“Për miratimin e subjekteve, të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit për shembje”*. Referuar relacionit shpjegues, aplikuesit L.P. dhe N.M. kanë qenë të skualifikuar me VKB nr. 50, datë 19.05.2021 dhe VKB nr. 146 datë 07.12.2020. Komisioni i Posaçëm i Apelit i ka kualifikuar pasi subjektet kanë provuar me dokumentacion shtesë se kanë jetuar në banesën e dëmtuar para datës 26.11.2019.

**Nga auditimi u konstatua se** dokumentacioni justifikues mbi rivlerësimin e tyre nuk rezulton në dosje, në mospërputhje me Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”*, pika 19.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 *“Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”*, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**2.** Vendimi nr. 25 datë 17.03.2023 *“Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato familje në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2023”*, ka miratuar subvencionimin e qirasë për 18 familjeve në nevojë, në vlerën totale prej 2,961,450 lekë.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim përbën *“Akt administrativ individual”* dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 *“Për Prefektin e Qarkut”*, i ndryshuar, neni 16, *“Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”*, pika 2.

**3.** Vendimi nr. 39 datë 11.04.2023 *“Për Shpërblimin e sportistëve dhe trajnerëve të ekipeve të shkollave të Bashkisë Kamzë, fituese në nivel qarku në disiplinat volejboll dhe basketboll ( meshkuj dhe femra), në kuadër të projektit “Ekipet sportive në shkolla”*”, ka miratuar shpenzimet për shpërblimin e sportistëve dhe trajnerëve të ekipeve të shkollave në vlerën totale prej 450,000 lekë.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim përbën *“Akt administrativ individual”* dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 *“Për Prefektin e Qarkut”*, i ndryshuar, neni 16, *“Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”*, pika 2.

Për VKB-në nr. 39 datë 11.04.2023, u konstatua se është miratuar në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 *“Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, neni 91, *“Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”*, pika 4.

**4.** Vendimi nr. 51 datë 18.04.2023 *“Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato familje në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2023”*, ka miratuar subvencionimin e qirasë për 3 muaj të 12 familjeve në nevojë, në vlerën totale prej 609,450 lekë.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim përbën *“Akt administrativ individual”* dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi

është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

5. Vendimi nr. 63 datë 23.06.2023, “Mbi miratimin e listës së familjeve që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë për trajtim me fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike”, ka miratuar listën e muajit maj 2023, prej 74 familjeve që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë për fondin 6%.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim, nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

6. Vendimi nr. 98 datë 20.11.2023, “Për miratimin e listës së dokumenteve për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”” për vitin 2024, miratuar listën e dokumenteve për programin e Strehimit Social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara” për vitin 2024.

**Nga auditimi u konstatua se** lista e dokumenteve për programin e strehimit social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara” nuk përmban gjithë dokumentacionin e parashikuar në të Vendimin nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfiturat strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pikat 5 dhe 16, gërmat a, b, c, e dhe d, ku përcaktohet:

“5. Individidi/familja paraqet kërkesën për të përfiturat nga programet e strehimit social në çdo kohë, sipas formatit të miratuar nga këshilli bashkiak, bazuar në modelin që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca “A” dhe sipas deklaratimit tip për vërtetësinë e të dhënave që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca “B”.

16. Në fazën e dytë, dosja e çdo aplikanti duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton deklaratimet e bëra në fazën e parë.

Dokumentacioni që kërkohet në këtë fazë përcaktohet në pikat (a), (b), (c), (ç), (d) të saj.”

7. Vendimi nr. 97 datë 20.11.2023 “Për dhënie ndihme financiare për djegie banese” ka miratuar kërkesën e Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe financiare në vlerën prej 445,886 Lekë të familjeve: R.H.H., për banesën e dëmtuar nga zjarri i datës 24.10.2023 dhe A.H.N., për banesën e dëmtuar nga zjarri i datës 23.10.2023;

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim përbën “Akt administrativ individual” dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

8. Vendimi nr. 52 datë 18.04.2023 “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim”, për vitin 2023 me fonde nga buxheti i shtetit”, ka miratuar listën e familjeve për të përfiturat nga programi Strehimi Social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim, për vitin 2023”. Janë përfituese 18 familje.

**Nga auditimi u konstatua se** ky vendim përbën “Akt administrativ individual” dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishte pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

Për VKB-në nr. 52 datë 18.04.2023, u konstatua se është miratuar edhe në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”, pika 4.

9. Vendimi nr. 56 datë 18.04.2023 “Për miratimin e kërkesës për shpronësim në interes publik. Të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit të rrogës “Jusuf Gërvalla”, Zall-Mner”.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk rezulton e përllogaritur vlera e shpronësimit në bazë të Vendimit nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.

**10.** Vendimi nr. 82 datë 22.08.2023 “Për miratimin e listës shtesë të subjekteve, posedues të ndërtimeve pa leje që preken nga realizimi i projektit unaza e madhe e Tiranës, sheshi shqiptonja, bulevardi i ri, Shkozë për njësinë administrative Paskuqan, të cilët përfitojnë subvencionim të qirasë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 409 datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen”, ka miratuar listën e subjekteve përfitues për bonus qiraje që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e madhe e Tiranës, sheshi shqiptonja, bulevardi i ri, Shkozë për njësinë administrative Paskuqan”.

**Nga auditimi u konstatua se** në relacionin shpjegues nuk ka asnjë të dhënë identifikuese mbi dy subjektet përfitues (shtesë), dhe dokumentacionin justifikues të paraqitur nga ana e tyre pranë grupit të punës.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**11.** Vendimi nr. 83 datë 22.08.2023 “Për miratimin e listës së familjeve shtesë që përfitojnë bonus qiraje, banesat e të cilëve preken nga rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit dhe ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit”, ka miratuar listën e familjeve shtesë që do të trajtohen me bonus qiraje, për shkak se banesat e tyre preken nga projekti “Ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit dhe Rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit”.

**Nga auditimi u konstatua se** në relacionin shpjegues nuk sqarohet dhe as rezulton e dokumentuar procedura e ndjekur për 3 familjet që preken nga projekti në zbatim të Vendimit nr. 409, datë 15.6.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen” i cili në kreun II të tij, përcakton mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen.

**Si konkluzion,** akti i paraqitur në Prefektin e Qarkut Tiranë, nuk ka qenë i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërma c.

**1** Vendim i Këshillit Bashkiak, **nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.**

**Nga auditimi u konstatua se** vendimi i kthyer për pabazueshmëri ligjore nuk është rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk është paraqitur në institucionin e Prefektit, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

Referuar kërkesave të mësipërme, institucioni i Prefektit (sektori juridik) ka detyrimin që për rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, **i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila ka detyrimin e rishqyrtimit të aktit..**”, proces i cili nuk është realizuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Vlerësimi ligjor i përputhshmërisë ose jo të aktit sa i përket moskonfirmimit është i rregullt, por nuk ka argumentim mbi shkeljet e vërejtura.

Nga ana e institucionit nuk ka vendime të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pavlefshmëri të vendimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, neni 16.

### **Verifikimi në vend:**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 procedura e kontrollit në vend të akteve pranë njësive vendore është si më poshtë:

**Për vitin 2023**, janë krijuar grupet e punës me urdhërat; nr. 93 datë 18.04.2023 “Për verifikimin e periudhës janar-mars 2023”; urdhëri nr. 159 datë 7.09.2023 “Për verifikimin e periudhës prill-gusht 2023” dhe urdhëri nr. 14 datë 18.01.2024 “Për verifikimin e periudhës shtator-dhjetor 2023”.

**Nga auditimi u konstatua se** verifikimi në vend për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nuk është bërë në përputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pikat 1 dhe 2.

Në aktin kontrollit e mbajtura nga grupi i punës, përkatësisht aktin nr. 615/1 prot., datë 04.05.2023; aktin nr. 1256/1 prot., datë 25.09.2023 dhe aktin nr. 81/1 prot., datë 08.02.2024, grupi i punës nuk ka konstatuar mangësi në drejtim të mos pasqyrit të saktë të të gjithë procedurës së mbledhjes së këshillit të bashkisë në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim në rrjedhim të së cilës zbardhet edhe vendimi i këshillit të bashkisë etj. dhe nuk u konstatuan akte të pa depozituara pranë institucionit të Prefektit.

**Nga auditimi u konstatua se** nuk është kryer kontrolli nga ana e grupit të punës, sa i përket procedurës së ndjekur me këto akte (dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsytet e mos rishqyrtimit të akteve nga njësia vendore), në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**Konstatohet se** grupi i punës nuk ka monitoruar procedurën e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore mbi aktet normative të kthyera për pabazueshmëri ligjore;

Me shkresat nr. 615/2 prot., datë 04.05.2023, nr. 1256/2 prot., datë 25.09.2023 dhe nr. 81/2 prot., datë 08.02.2024, Prefekti i Qarkut ka përcjellë akt-kontrollet mbi verifikimet në vend të vendimeve.

**Konstatohet se** pas verifikimit në vend të akteve, prefekti i qarkut nuk ka dërguar konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse pranë NJVV-së objekt verifikimi, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, gërma g.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Vorë (viti 2022):**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, nga Bashkia Vorë, rezulton se në protokollin e institucionit janë depozituar (të hyra) gjithsej **154** akte administrative, nga të cilat janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore **70** vendime të këshillave bashkiakë, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore **8** vendime.

**8** Vendime të Këshillit Bashkiak, **nuk janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut.**

**Nga auditimi u konstatua se** vetëm vendimet e kthyera për pabazueshmëri ligjore nuk janë rishqyrtuar nga njësia vendore dhe nuk janë paraqitur në institucionin e Prefektit, në mospërputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b.

**53** Vendime janë akte me karakter individual, kryesisht **akte të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie pranë prefektit pasi marrin fuqi ditën e njoftimit të subjektit/subjekteve që i drejtohet.**

**1.** Me vendimin nr. 18 datë 31.03.2022 “Për miratimin e listës së familjeve përfituese të bonusit të qirasë të cilat janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe familjeve të cilat janë shpronësuar në kuadër të procesit të rindërtimit në zbatim të planit të detyruar vendor për muajin mars 2022”, ka miratuar listën e 908 familjeve përfituese të bonusit të qirasë të cilat janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.



2. Me vendimin nr. 35 datë 29.06.2022 “Për miratimin e listës së familjeve përfituese të bonusit të qirasë të cilat janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe familjeve të cilat janë shpronësuar në kuadër të procesit të rindërtimit në zbatim të planit të detyruar vendor për muajin qershor 2022”, është miratuar lista e 881 familjeve përfituese të bonusit të qirasë të cilat janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

3. Me vendimin nr. 48 datë 02.09.2022 “Për miratimin e listës së familjeve përfituese të bonusit të qirasë të cilat janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe familjeve të cilat janë shpronësuar në kuadër të procesit të rindërtimit në zbatim të planit të detyruar vendor për muajin gusht 2022” është miratuar lista e 854 familjeve përfituese të bonusit të qirasë të cilat janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.

**Nga auditimi u konstatua se** këto vendime përbëjnë “Akte administrative individuale” dhe nga Prefektura Tiranë nuk duhet të ishin pranuar dhe nuk duhet të ishte shprehur ligjshmëria, pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

4. Me vendimin nr. 37 datë 29.06.2022 “Për miratimin në parim të Ujësjellës Kanalizime Vora Sha në subjekte me kompetenca të përbashkëta dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për të lidhur marrëveshjet përkatëse”, është miratuar në parim riorganizimin e shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Vora ShA” në subjekte me kompetenca të përbashkëta dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për të lidhur marrëveshjet përkatëse.

Nga auditimi u konstatua se vendimi nuk gjen përputhshmëri me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, gërma gj. Sa më sipër, **është kompetencë e kryetarit të Bashkisë si person juridik dhe përfaqësues i saj, marrëdhënia me të tretët**, për rrjedhojë nuk nevojitet autorizim nga Këshilli Bashkiak.

5. Me vendimin nr. 39 datë 29.06.2022 “Për miratimin e procedurës për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale që kalojnë në pronësi të bashkisë Vorë nga ndërtimet e reja”, në pikën 3 dhe 6 është miratuar:

**“3. Subjekti privat mund të propozoj që sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi ta ofroj në një objekt tjetër në pronësi. Në këtë rast sipërfaqja që i dorëzohet bashkisë konvertohet në diferencën e vlerave të tregut.**

**6. Në rast se sipërfaqja takuese në favor të Bashkisë Vorë sipas parashikimeve të këtij vendimi ofrohet nga zhvilluesi privat që të paguhet në vlerë leku, konvertimi i sipërfaqes përlllogarit duke shumëzuar sipërfaqen takuese me vlerën e referencës së banesave në zonën në të cilën ka aplikuar për leje ndërtimi, sipas përcaktimit të bërë me udhëzim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Vlera e përfituar shkon në buxhetin e bashkisë Vorë në programin e strehimit social.”**

Nga auditimi i bazës ligjore e cila është cituar si mbështetje për këtë vendim, u konstatua se nuk parashikohet që zhvilluesi privat mund ta konvertojë sipërfaqen ndërtimore në vlerë leku dhe sa më sipër rezulton në mospërputhje me ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 19, “Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik”, ku përcaktohet:

**“1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t’i akordohet shtesa në intensitetet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.”**

**Si konkluzion,** vendimi nr. 39 datë 29.06.2022 është konfirmuar në mospërputhshmëri me dispozitat rregullatore në fuqi.

**6.** Me vendimin nr. 59 datë 03.10.2022 “Për prishjen e detyruar të objekteve (pallate 2 katëshe) dhe të objekteve të tjera private në territorin e Bashkisë Vorë për efekt të shpronësimit në kuadër të rindërtimit sipas VKM nr. 598 datë 14.09.2022 dhe përfshirjen e familjeve që mbeten të pastreha në bonusin e qirasë sipas kritereve ligjore”, është miratuar prishja e detyruar e objekteve (pallate 2 katëshe) dhe të objekteve të tjera private në territorin e Bashkisë Vorë për efekt të shpronësimit në kuadër të rindërtimit sipas VKM nr. 598 datë 14.09.2022 dhe përfshirjen e familjeve që mbeten të pastreha në bonusin e qirasë sipas kritereve ligjore.

Vendimi është miratuar në përputhshmëri me dispozitat rregullatore në fuqi.

**7.** Vendimi nr. 4, datë 19.01.2022 “Mbi miratimin e listës së përfituesve të granteve të rikonstruksionit ose riparimit, të shtëpive individuale dhe banesave, për individët dhe familjet e dëmtuara sipas nivelit të dëmit DS4”, është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit të vërtetimit të ekzistencës së banesës së dëmtuar gjithashtu mungon deklarata noteriale për vërtetimin se aplikuesit ka pasur aty vendbanimet e tyre në momentin e rënies së tërmetit të datës 26.11.2019.

**8.** Vendimi nr. 5, datë 19.01.2022 “Mbi miratimin e listës së përfituesve të granteve të rikonstruksionit ose riparimit, të shtëpive individuale dhe banesave, për individët dhe familjet e dëmtuara sipas nivelit të dëmit DS5”, është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit të vërtetimit të ekzistencës së banesës së dëmtuar dhe mungon deklarata noteriale për vërtetimin se aplikuesit kanë pasur aty vendbanimet e tyre në momentin e rënies së tërmetit të datës 26.11.2019.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se vendimet nr. 4 dhe 5, datë 19.01.2022 nuk janë të shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

Ky vendim është konfirmuar në mungesë dokumentacioni, në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34, si dhe Vendimin nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, pika 5.

**9.** Me vendimin nr. 77, datë 05.01.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Vorë për vitin 2023”, është konfirmuar ligjshmëria për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, u konstatua se në pikën II.2., “Tarifa për shërbime administrative”, me numër rendor 3 është specifikuar “Aplikim për leje ndërtimi, leje zhvillimi, leje infrastrukturore, leje përdorim”, në vlerën 10,000 lekë. Në pikën II.9., “Tarifa vendore për kërkesa për leje punimesh”, është specifikuar 1% e vlerës së punimeve/preventivit.

Sa më sipër, rezulton se është vendosur dy herë detyrim, për të njëjtin shërbim të ofruar. Një herë në vlerën 10,000 lekë, e cila rezulton e argumentuar dhe e mbështetur në legjislacionin tatimor dhe një herë e shprehur në përqindje. Mënyra e llogaritjes së këtij detyrimi, e shprehur në përqindje mbi vlerën e investimit, del jashtë kuptimit të tarifës së aplikimit dhe realisht është rritje në mënyrë të tërthortë e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke rënduar detyrimet e qytetarëve.

Në parim, natyra e tarifës ka lidhje me objektin për të cilin paguhet dhe jo me madhësinë e objektit, pasi në thelb, procedura dhe puna e kryer nga administrata është e njëjtë, pavarësisht madhësisë së objektit. Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, neni 2 “Përkufizime”, pika 3, përcaktohet:

““Tarifë” është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejt apo nëpërmjet një agjenti tek administrata tatimore qendrore. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mire publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë.”

Pra, vlera e tarifës nuk mund dhe nuk duhet të ndikohet nga vlera e shërbimit të ofruar, pasi edhe në këtë rast, pavarësisht nëse objekti është një banesë e vogël familjare, apo një ndërtesë shumëkatëshe komplekse.

Shprehja e tarifës për aplikim për kërkesa për leje ndërtimi me 1% mbi vlerën e preventivit, nuk është e argumentuar dhe nuk mbështetet në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, kreun VII, neni 35, pika 2, ku përcaktohet:

“Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to...”

Në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, pika 5, gërma c), përcaktohet:

“...dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;”

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 35 “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 1, gërma b), përcaktohet:

“1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë ose të qarkut, klasifikohet si tarifë kur: ...b) nuk është taksë bashkiake, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligj.”

Pavarësisht se koncepti fillestar i kësaj “takse” të trajtuar si tarifë dhe të aplikuar dy herë ka filluar vite më parë, nga prefekti i qarkut nuk duhet të ishte miratuar dhe duhet të ishte ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë si i pambështetur në legjislacionin tatimor në fuqi.

### **Vendime të Këshillit të Bashkisë Vorë (viti 2023):**

1. Vendimi nr. 6, datë 23.01.2023 “Për shpalljen përfitues nga procesi i rindërtimit në kuadër të tërmetit të datës 26.11.2019 të familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga plani i detyruar vendor dhe janë me kategori DS5”, është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit të vërtetimit të ekzistencës së banesës së dëmtuar gjithashtu mungon deklarata noteriale për vërtetimin se aplikuesit ka pasur aty vendbanimet e tyre në momentin e rënies së tërmetit të datës 26.11.2019.

2. Vendimi nr. 15, datë 23.02.2023 “Miratimi i listës së përfituesve nga Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit për kategorinë DS5”, është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit të vërtetimit të ekzistencës së banesës së dëmtuar gjithashtu mungon deklarata noteriale për vërtetimin se aplikuesit ka pasur aty vendbanimet e tyre në momentin e rënies së tërmetit të datës 26.11.2019.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se vendimet nr. 6, datë 23.01.2023 dhe 15, datë 23.02.2023 nuk janë të shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, gërmat b dhe c.

Ky vendim është konfirmuar në mungesë dokumentacioni, në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34, si dhe Vendimin nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, pika 5.

### **Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **Z. A.Q.**, në cilësinë e Prefektit të Qarkut Tiranë.
2. **Znj. P.Q.**, në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit Juridik në Prefekturën e Qarkut Tiranë.
3. **Z. H.LI.**, në cilësinë e Specialistit të Sektorit Juridik në Prefekturën e Qarkut Tiranë.
4. **Z. S.B.**, në cilësinë e Specialistit të Sektorit Juridik në Prefekturën e Qarkut Tiranë.
5. **Znj. E.Sh.**, në cilësinë e Specialistit të Sektorit Juridik në Prefekturën e Qarkut Tiranë.

Për sa më lart, nga nëpunësit: A.Q., P.Q., S.B., E.Sh. dhe H.Ll. janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 466/17 prot., datë 26.09.2024, administruar nga KLSH, me nr. 561/6 prot., datë 27.09.2024.

**Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me gjetjen nr. 4, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se në total për periudhën objekt auditimi 227 vendime të këshillave bashkiake nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, mospërputhje me rregulloren e brendshme nr.175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizmin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi 1, neni 4, gërma b dhe manuali për hartimin e legjislacionit, shtojca relacioni për projekt aktin, faqe 303-306. Ju parashtrojmë dhe argumentojmë se: Ligji Nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 citon se “Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre...”***

Referuar ligjit organik të institucionit të Prefektit përveç nenit të larte përmendur që përcakton detyrimin ligjor të prefektit për verifikim ligjshmërie, nuk parashkohet asnjë kriter në pranimin e dokumentacionit shoqërues të praktikës së dorëzuar për verifikim ligjshmërie.

Sa më sipër, edhe ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në Kreun IV “**Marrëdhëniet midis qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore**” nuk përcakton në asnjë rast detyrimin e Këshillit Bashkiak të depozitohet te Institucioni i Prefektit dokumentacion shoqërues së bashku me vendimin e marr prej tij. Në nenin 12 të Kreut IV “**Konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore**”, në pikën 1 theksohet që “**qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësisive**”. Gjithashtu në pikën 3 të po këtij neni shprehet qartë se “**Struktura, procedura, forma, mënyra e organizimit dhe funksionimit dhe natyra e çështjeve për konsultim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave**”.

Në kushtet e një barazie juridike, ku çdo institucion funksionon me ligjin e vetë organik, si pushteti vendor ashtu dhe Institucioni i Prefektit dhe në mungesë të akteve nënligjore që rregullojnë funksionalitetin midis tyre, nuk mund të imponohet përcaktimi i njëanshëm i marrëdhënieve midis tyre. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve referuar legjislacionit në fuqi nga institucioni ka konsistuar në disa drejtime:

- Kompetenca e Këshillit Bashkiak referuar objektit të aktit;
- Përputhshmëria e vendimmarrjes me bazën ligjore specifike;
- Elementët e nevojshëm të aktit referuar Kodit të Procedurave Administrative.

***Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumente plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar këtij dokumentacioni bashkëlidhur, në koherencë me kompetencat dhe instrumentet që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në cenim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njeh organeve të vetëqeverisjes vendore.***

Fakti që është kryer këshillimi me bashkësinë shprehet në mënyrë eksplicite në bazën ligjore të aktit, si një ndër elementët kryesor që duhet të ketë akti referuar KPA. Theksojmë që e gjithë procedura deri në dërgimin e projektvendimit në këshill përgatitet nga administrata dhe më tej kalon në komisionet e Këshillit Bashkiak, procedurë që ndiqet nga KB, ndërkohë kompetenca ligjore e Prefektit është verifikimi i ligjshmërisë së aktit të miratuar në këshill, dhe fakti që gjithë procedura e ndjekur është e pasqyruar në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer, si dhe Ligji shprehet se Prefekti miraton vendimet pa penguar zbatimin e tyre. Fakti që gjithë procedura e ndjekur pasqyrohet në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer dhe pjesëmarrja e tre të pestave të anëtarëve të këshillit, si dhe në relacionin bashkëlidhur vendimit pasqyrohet dhe shpjegohet detajimi i përdorimit të fondit për vitet buxhetore sipas rastit.

Nëse i referohemi ligjit “Për vetëqeverisjen vendore” nr.139/2015 në nenin 13 “**Mbikëqyrja dhe kontrolli**”, në asnjë rast nuk përcakton kriteret e pranimit të dokumentacionit si proces i verifikimit të ligjshmërisë. Gjithashtu edhe në Kodin e Procedurave Administrative, neni 99 përcakton qartë

elementët që duhet te ketë një akt administrativ që te jetë i vlefshëm, por jo dokumentacionin që e shoqëron praktikën deri në zbardhjen e një akti.

Në vitin 2020 Ministria e Brendshme ka miratuar një rregullore të brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të Prefektit të Qarkut”, ku bashkëlidhur ka një aneks për rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, e cila përcakton sjelljen e punonjësve në funksionimin e brendshëm, por në asnjë moment nuk mund të shërbeje si bazë ligjore në raport me të tretët në kuadër.

Rregullorja e brendshme përcakton rregullat dhe parimet bazë në funksionimin e brendshëm ku miratohen dhe Procedurat Standarde të Veprimt, (PSV është një procedurë specifike ose një grup udhëzuesish e procedurash që dokumentojnë një aktivitet a proces rutinë ose përsëritës pune që kryhet brenda një ose në një situatë të caktuar për të rritur cilësinë duke ndjekur një procedurë të standardizuar të punës. PSV-të janë pjesë e një strategjie përmirësimi të vazhdueshëm që duhet të rishikohet vazhdimisht në mënyrë që shërbimet të bëhen sa më efikase).

Kjo bazuar në nenin 119 të Kushtetutës ku thuhet se:

1. “Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre”.

2. “Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera”.

Përsa u tha më sipër, përcaktimet e PSV –ve të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e një institucioni, miratohen në një rregullore dhe janë të detyruara të zbatohen nga institucioni miratues apo i vartësisë por nuk janë detyruese për palët e treta. Në këto kushte janë kriteret ato të cilat përcaktojnë pranimin e dokumentacionit për fillimin e një shqyrtimi administrativ, verifikimin e ligjshmërisë për rastin në fjalë. Pra kriteret janë ato që vendosin normat e një marrëdhënie ligjore ndërmjet dy institucioneve në një procedim administrativ.

Në përfundim, mungesa e kriterëve të përcaktuar me një akt nënligjor (VKM) nuk të jep mundësinë e pengimit ose të interpretimit të një procesi shqyrtimi administrativ (verifikimi i ligjshmërisë) për aktet e nxjerra nga Këshillat Bashkiak. Pra trajtimi i bërë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut në verifikimin e ligjshmërisë së akteve të pushtetit vendorë është konform akteve ligjore në fuqi.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. Pretendimi juaj se në Kodin e Procedurave Administrative, neni 99 përcakton qartë elementët që duhet te ketë një akt administrativ që te jetë i vlefshëm, por jo dokumentacionin që e shoqëron praktikën deri në zbardhjen e një akti nuk qëndron pasi “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjshmërinë e akteve administrative e ka parashikuar në “Seksionin III”, dhe lidhur me paligjshmërinë e akteve administrative, në nenin 109 parashikon:

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

**a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;**

**b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;**

c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;

ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;

d) është në kundërshtim me ligjin material;

**dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme;** apo

**e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.**

Përsa i përket pretendimit tuaj se rregullorja e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” në asnjë moment nuk mund të shërbeje si bazë ligjore në raport me të tretët, ri sqarojmë se kjo rregullore është mbështetur në Nenin 102(4) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjin Nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 50 datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut” dhe si e tillë shërben për të rritur cilësinë duke ndjekur një procedurë të standardizuar të punës.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me gjetjen nr. 8, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se për vitet 2022-2023 janë kthyer për pabazueshmëri ligjore, 50 vendime. Në të gjitha rastet kur është vërejtur papajtueshmëri ligjore të akteve, prefekti i qarkut ia ka kthyer ato organeve përkatëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore, por në asnjë rast nuk ka argumentuar shkeljet apo parregullsitë e vërejtura. Në asnjë rast Institucioni i Prefektit të Qarkut nuk i është drejtuar gjykatës kompetente për çështje administrative për të kërkuar drejtpërdrejt pavlefshmërinë e akteve, mospërputhje me ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pika i.***

***Ju parashtrijmë dhe argumentojmë se :*** Në shkresën verifikim ligjshmërie të institucionit të Prefektit në të gjitha rastet e mos konfirmimit është cituar baza ligjore specifike e cila ka dhe argumentimin ligjor për moskonfirmimin, përsa i përket mos dërgimit në gjykata në periudhën e audituar nuk ka pasur raste të tilla të evidentuara që institucioni të zbatojë nenin 16 pika 1.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. Ritheksojmë se në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pika i citon: “Në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t’ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, **duke argumentuar shkeljet e vërejtura**”.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me gjetjen nr. 10, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se nëpërmjet VKB-së nr. 8, dt. 25.01.2022 ‘Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit privat A.A. shpk&E.A. dhe Bashkia Kavajë’, është miratuar aktmarrëveshja nr. 227 Prot. dt. 18.01.2022, ku dakortësohet që detyrimi i subjektit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 11,842,828 leke, të këmbëhet me 3 apartamente banimi të cilat do të kalojnë në pronësi të Bashkisë Kavajë. Marrëveshja e miratuar nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të referuar në vendim, pasi nuk është e parashikuar të realizohet këmbimi me apartamente i vlerës së taksës së detyrueshme për tu paguar në vlerë monetare. **Ju parashtrijmë dhe argumentojmë se:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë është shprehur se është e drejtë e kryetarit lidhja e marrëveshjeve referuar nenit 9 të Ligjit nr. 139/2015, theksojmë se objekti i kësaj natyre (marrëveshja) nuk është objekt shqyrtimi nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë. Pra institucioni i Prefektit nuk është shprehur mbi konfirmimin e ligjshmërisë së marrëveshjes pasi nuk është kompetencë e Këshillit miratimi i kësaj marrëveshje dhe aq më tepër Prefekti të verifikoj ligjshmërinë. Marrëveshja është një marrëdhënie dypalëshe e cila përcakton të drejta dhe detyrime ndaj palëve nënshkruese dhe as një palë e tretë nuk mund të vlerësojë apo të shprehet mbi këtë marrëdhënie. Vendimi i këshillit nuk ka për objekt këto të drejta dhe detyrime objekt marrëveshje të cilën ju citoni që janë në mospërputhje ligjore, për të cilat mbajnë përgjegjësi palët nënshkruese dhe struktura që ka hartuar atë marrëveshje, administrata e bashkisë. Institucioni i Prefektit dhe një herë në shkresën e tij ka cituar bazën ligjore që konfirmon përsa u tha me sipër dhe në asnjë moment nuk shprehet mbi objektin e marrëveshjes që është objekt shqyrtimi.***

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore. VKB-së nr. 8, dt. 25.01.2022 ‘Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit privat A.A. shpk&E.A. dhe Bashkia Kavajë’, është konfirmuar në mospërputhje me bazën ligjore të referuar në vendim, pasi nuk është e parashikuar të realizohet këmbimi me apartamente i vlerës së taksës së detyrueshme për tu paguar në vlerë monetare.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen nr. 11, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në 2 raste, VKB-të nuk kanë qenë të shoqëruara nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175, datë 09.07.2020, aneksi nr. 1, neni 4/c. Në dokumentacionin shoqëruar të VKB nr. 67, dt. 23.11.2022, mungon preventivi i vlerësimit të dëmeve për dëmshpërblimin e miratuar në shumën 692,700 lekë, në mospërputhje me vendimin nr. 329, dt 16.05.2012, kreu III, pika 1/b/c/d/e. Në dokumentacionin shoqëruar të VKB nr35, dt 26.04.2022, mungon procesverbali i konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara në mospërputhje me vendimin nr. 329, dt 16.05.2012, kreu III, pika 1/b. **Ju parashtrojmë dhe argumentojmë se:** VKM-ja 329/2012, në kreun III, pika 1, germa ë) citon: "Këshilli i komunës ose i bashkisë, pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes dhe të dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ" dhe germa f) Institucioni i prefektit të qarkut konfirmon bazueshmërinë ligjore të vendimit të lëshuar nga këshilli i komunës ose i bashkisë.*

*Përsa më sipër VKM-ja ngarkon një komision që ngrihet me urdhër kryetari për përgatitjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit referuar kërkesës së qytetarëve, i cili më pas përgatit relacionin përkatës (i cili gjendet bashkëlidhur vendimit që përcillet për verifikim së bashku me dokumente të tjera shoqëruese dhe fondi është nga fondet e Bashkisë), ndërkohë Institucioni i prefektit të qarkut konfirmon bazueshmërinë ligjore të vendimit të lëshuar nga këshilli i komunës ose i bashkisë referuar pikës f të sipërpërmendur duke parë nëse është zbatuar procedura e përcaktuar ligjore dhe jo përmbajtja e dokumentacioneve pjesë e saj që është detyrë e komisioneve të ngritura në zbatim të legjitimitetit që VKM-ja ju jep.*

*Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumente plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentet që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në cenim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njuh organeve të vetëqeverisjes vendore.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Referuar kuadrit rregullator në fuqi, Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, duke kontrolluar nëse vendimi është marrë sipas ligjit dhe në përputhje me procedurat. Procedura administrative e ndjekur gjatë marrjes së vendimit është thelbësore për ligjshmërinë e tij. Në këtë fazë verifikohet nëse janë respektuar të gjitha hapat proceduralë të kërkuar nga ligji dhe rregulloret e brendshme. Pretendimi juaj se Institucioni i prefektit të qarkut konfirmon bazueshmërinë ligjore të vendimit të lëshuar nga këshilli i komunës ose i bashkisë referuar pikës f të sipërpërmendur duke parë nëse është zbatuar procedura e përcaktuar ligjore dhe jo përmbajtja e dokumentacioneve pjesë që është detyrë e komisioneve të ngritura në zbatim të legjitimitetit që VKM-ja ju jep, nuk qëndron pasi

*në rregulloren e brendshme nr. 175, datë 09.07.2020, aneksi nr. 1, neni 4/b(vii) parashikohet se akti i depozituar duhet detyrimisht të shoqërohet nga dokumentacioni përkatës sipas standardit të kërkuar (për emergjencat civile).*

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen nr. 12, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në vendimin*

nr. 72, dt. 20.11.2023, me të cilin është miratuar fondi 3,349 leke, ndërhyrje të menjëhershme në objektin industrial ish Fabrika e Letrës, është në mospërputhje me aktin nr. 9, dt. 16.12.2019, për arsye se prishja e detyruar e ndërtesave private apo publike, kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njeriut. U konstatua se për nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesës nuk rezultojnë të dokumentuara kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011. **Ju parashirojmë dhe argumentojmë se:** Ky vendim është konfirmuar në parim, referuar kompetencës ligjore të pikës 2/b vkm nr. 414/2021, e ndryshuar me vkm nr. 290 dt. 17.05.2023, që i jep Këshillit Bashkiak kompetencat për përdorimin e fondit për emergjencat civile. Për sa i përket procedurave për blerjen e automjetit dhe dokumentet shoqërues për këtë procedurë sqarojmë se janë detyrë të ndiqen nga administrata pas miratimit të fondit. Ndërsa për pikën tjetër vendimi është i shoqëruar me preventivin përkatës, relacionin, akt preventiv dhe akt konstatimi nga grupi përgjegjës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Kavajë. Gjithsesi sqarojmë se objekti është përdorimi i fondit të kushtëzuar sipas pikës 2/b vkm nr. 414/2021, e ndryshuar me vkm nr. 290 dt. 17.05.2023, që i jep Këshillit Bashkiak kompetencat për përdorimin e fondit për emergjencat civile edhe për blerje automjetesh.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Ritheksojmë se në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni (35/1), parashikon se: “Prishja e detyruar e një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, **sipas përfundimeve në akt konstatimet apo akt vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit ose në akt ekspertizën e thelluar, si dhe nëse riparimi kushton më shumë se ndërtimi nga e para, sipas rekomandimeve në aktin e ekspertizës së thelluar, të hartuar sipas parashikimeve në këtë ligj**”

VKB-ja është konfirmuar në mungesë të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurës ligjore mbi vlerësimet e kryera nga IN.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### **Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 13, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në 7 rast VKB-të janë konfirmuar në mungesë të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurës ligjore mbi të gjitha rivlerësimet e kryera, në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175, dt. 09.07.2020 dhe vendimin nr. 5, dt. 06.01.2020. **Ju parashirojmë dhe argumentojmë se:** a) VKM-ja nr. 904/ 2019 pika 16, citon se “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit”, ndërsa pika 17 citon se: “Komisioni informon kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në lidhje me listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, i cili lidh kontratën për kalimin e pronësisë së banesave të përfituesit, pas marrjes së miratimit të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”,**

Pra, VKM -ja përcakton dy faza , 1. Përzgjedhjen dhe hartimin e listës nga komisioni i posaçëm, çka nënkupton që në këtë fazë ky komision ezauron të gjithë procedurën e verifikimit të dokumentacionit të aplikuesve dhe nxjerrje e përfituesve si përgjegjësi e komisionit përkatës ngritur me urdhër Kryetari. Ndërkohë që këshilli miraton listën e hartuar nga komisioni, si pasojë vendimmarrjet e këshillit për miratim listash kanë qenë të shoqëruara me relacion dhe lista të firmosura nga anëtarët e komisioneve përkatëse. Ndaj në referencë të kësaj baze dhe arsyetimi ligjor Institucioni i Prefektit në verifikimin e ligjshmërisë është shprehur specifikisht” **sipas listave të komisioneve të rindërtimit**”.



b) Një moment tjetër në këto vendime janë vendimmarrjet e akteve të rindërtimit që kanë objekt prishje ndërtesash sipas akteve nënligjore në fuqi për rindërtimin, të cilat duhet të jenë të shoqëruara detyrimisht me Akt-Ekspertizën e thelluar e Institutit të Ndërtimit.

Theksojmë se këto akte të konfirmuara nga Institucioni i Prefektit kanë pasur detyrimisht bashkëlidhur akt ekspertizat, në të cilat referohet objekti i vendimit si dhe konfirmimi ligjor.

Në lidhje me konstatimin se akt ekspertiza e thelluar nuk përmban elementet që parashikon akti normativ nr. 9 dhe VKM nr. 26 e vitit 2020 theksojmë që ky dokument lëshohet nga një organ kompetent përcaktuar nga akte ligjore për përpilimin e akt-ekspertizës së thelluar, çka ngarkon me përgjegjësi direkt atë organ. Institucioni i Prefektit nuk ka kompetencë verifikimi për dokumentin që lëshon Instituti i Ndërtimit, pasi ky është një dokument shoqërues i vendimit që verifikohet.

c) Në lidhje me konstatimin se në disa akte me “objekt miratim lista përfituesish të granteve” nuk janë të shoqëruar me akt ekspertizën e thelluar,

Sqarojmë se këto akte kanë pasur akt ekspertiza të thelluara në vendimmarrjen e miratimit të prishjes së objekteve, në të cilët kanë qenë pjesë personat që kanë dalë përfitues. Këto akte kanë qenë pjesë e praktikës së vendimmarrjeve për miratimi prishje/rikonstruksioni.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.LI. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore.

VKB-të janë konfirmuar në mungesë të relacionit apo të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurës ligjore.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### **Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 14**, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se, me vendimin nr. 98, dt 20.11.2023, për vitin 2024, është miratuar lista e dokumenteve për programin e Strehimit Social për vitin 2024, e cila nuk është hartuar në përputhje me vendimin nr. 384, dt 12.06.2019, pasi nuk përmban dokumentacionin e plotë të cituar në këtë vendim. **Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:** Në relacionin e bashkisë të hartuar nga drejtoria përkatëse sqarohet se duke analizuar rast pas rasti kërkesat e qytetarëve të ardhura në ambientin e institucionit Bashkisë Kamëz pranë sportelit One Stop Shop, për programin e përmirësimit të kushteve të banimit në zbatim të VKM-së nr.384 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar nga programet e strehimit social”, sektori strehimit ka hartuar listën e dokumenteve duke u bazuar në Termat e Referencës 2023 lidhur me projektet e investimit që do të financohen nga buxheti shtetit për vitet 2023-2024 nga MFE që publikohen në faqen e web të Ministrisë.

Nisur sa më sipër një ndër dokumentet që kërkohej të jete pjese e dosjes se aplikantit janë fotografite që vërtetojnë kushtet sociale të aplikanteve, si dhe deklarata që vërteton se familja që ndodhet në kushtet të vështira ekonomike nuk ka banesë (objekt) tjetër për të banuar.

Referuar VKM-së së sipërcituar pranë sektorit tonë ka pasur aplikime gjatë gjithë vitit për programin e strehimit social dhe në momentin e hapjes së fazës së parë janë njoftuar për të dorëzuar dokumentacionet ligjore që përcakton VKM-ja. Referuar listës së dokumenteve në dosjet e aplikantëve kanë dhe dokumentacione ligjore sipas përcaktimit të VKM-së nëse kanë kategori të tjera shtesë.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.LI. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Observacioni nuk merret në konsideratë, pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore.

**Nga auditimi i VKB-së u konstatua se**, lista e dokumenteve për programin e strehimit social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara” nuk ishte hartuar në përputhje të pikave, 5 dhe 16 (a), (b), (c), (ç), (d) të Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pasi nuk përmbante dokumentacionin e plotë të cituar në këtë vendim.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 15**, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se, me vendimin nr. 29.09.2023, u konstatua se urdhri nr. 102, dt 24.04.2023, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i dt. 26.11.2019, është në tejkalim të afateve dhe konstatimi është kryer në mospërputhje të ligjit nr. 45/2019. Gjithashtu u konstatua se akt-ekspertiza e thelluar është në mospërputhje me Aktin Normativ nr. 9, dt 16.12.2019, pasi nuk përmban përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe shëndetit të njerëzve si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje. **Ju parashtrojmë dhe argumentojmë se:** Theksojmë se në zbatim të VKM-së nr. 904/ 2019 këto akte të konfirmuara nga Institucioni i Prefektit kanë pasur detyrimisht bashkëlidhur akt ekspertizat, në të cilat referohet objekti i vendimit si dhe konfirmimi ligjor. Në lidhje me konstatimin se akt ekspertiza e thelluar nuk përmban elementet që parashikon akti normativ nr. 9 dhe VKM nr. 26 e vitit 2020 theksojmë që ky dokumentet lëshohet nga një organ kompetent përcaktuar nga akte ligjore për përpilimin e akt-ekspertizës së thelluar, çka ngarkon me përgjegjësi direkt atë organ. Institucioni i Prefektit nuk ka kompetencë verifikimi për dokumentin që lëshon Instituti i Ndërtimit, pasi ky është një dokument shoqëruar i vendimit që verifikohet. Kopshti nuk ka qenë funksional, pasi në momentin që është konstatuar rrezikshmëri është zhvendosur i gjithë stafi dhe fëmijët në ambient tjetër, prandaj vonesa në kohë e ardhur si pasojë e prioritizimit të procedurave të shumta të asaj kohe nuk ka qenë rrezikshmëri, por duke pasuar parasysh interesi publik për të parandaluar shembjen e tij të pakontrolluar u bë në një moment të dytë. Theksojmë që e gjithë kjo është procedurë që ndiqet nga administrata dhe objekt vendimi i këshillit është thjesht prishja e cila bazohet në akt ekspertizë siç e kërkon akti normativ.

**Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumente plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentet që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në cenim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njeh organeve të vetëqeverisjes vendore.**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 6**, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se 17 vendime të këshillit bashkiak Kamëz me objekt dhënie ndihme ekonomike me një vlerë prej 13.342, 00 lekë janë konfirmuar në mospërputhje me kriteret e përcaktuara në vkm nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfutimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, kapitulli 4, pika 5 dhe 7 dhe 13. Në 5 raste u konstatua se Vkb me objekt dhënie ndihme ekonomike për arsye shëndetësorë, janë konfirmuar në kundërshtim me ligjin nr.10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Rep. e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 11 pika 1.

**Ju parashtrojmë dhe argumentojmë se:** Ndihma financiare që Bashkia jep është zë buxhetor i veçantë i përcaktuar në buxhetin e bashkisë nga fondi përkatës për ndihmën ekonomike (zëri 606), si program social në ndihmë të komunitetit nga fondet e veta dhe jo nga fondi për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në referencë të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, ligji nr.57 dt.18/07/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV, të Vendimit nr. 597 datë. 04/09/2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKB nr.103 dt. 18.12.2023 " Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2024, 2025, 2026; VKB nr. 6 datë 22.01.2024 mbi Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin, 2024, Këshilli Bashkiak Kamëz".

Bashkia Kamëz i ka kushtuar vëmendje të shtuar dhe i ka dhënë prioritet familjeve në nevojë, çdo vit planifikon një buxhet nga të ardhurat e bashkisë për familjet në nevojë që kanë problematika të mëdha ekonomike, sociale, shëndetësore etj.. Për çdo familje që trajtohet nga ky fond është e krijuar një dosje individuale ku janë të paraqitura të gjithë dokumentet si vlerësim social-ekonomik gjendja e banesës dhe çdo dokument tjetër që vërteton problematikën shëndetësore dhe sociale. Bashkia Kamëz nuk ka akoma qendra rezidenciale, strehëza, banesa sociale, qendra ditore për të ofruar shërbime kësaj kategorie dhe ndodhur në këto kushte këtyre problematikave ju vijmë në ndihmë nga fondi i bashkisë.

Objekt i këtyre vendimeve janë ndihma ekonomike për qytetarët në pamundësi financiare për të siguruar kushtet minimale të jetesës, i përcaktuar dhe si objektiv social në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; jepen në bazë të kriterëve të përcaktuar më VKM nr. 597/2019 dhe specifikuar në VKB në fillim vitit vkm e cila ngarkon administratorin social për ndjekjen e procedurave referuar vkm-së 597/2019. Referuar ligjit të Prefektit nenit 16, ku shprehet detyrimi ligjor i verifikimit ligjor të akteve si dhe Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, ku përcaktohen kompetencat e Këshillit Bashkiak nuk është kompetencë e tyre hartimi dhe përzgjedhja e përfituesve në bazë të kriterëve të përcaktuara në VKM, e cila përcakton në pikën 9 "Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki harton projekt vendimin për familjet në nevojë nën juridiksionin e bashkisë në bazë të propozimeve dhe vlerësimeve social-ekonomike të ardhura nga administratori shoqëror për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" dhe pika 10 " Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përllogarit fondin për mbulimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe dërgon për miratim në këshillin bashkiak".

**Ligjshmëria e aktit nuk përfshin as kontrollin e kriterëve përzgjedhëse fituese dhe as llogaritjen e fondit por zbatimin e procedurës ligjore referuar kuadrit rregullator në fuqi.**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### **Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 7, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhëresave me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se VKB Nr.4, dt.15.02.202, nr.26, dt.17.03.2023; nr.28, dt.17.03.2023; nr.39. dt.11.04.2023; nr.52, dt.18.04.2023 janë konfirmuar në kundërshtim me ligjin nr.10019, dt.29.12.2008 "Për kodin zgjedhor", i ndryshuar, neni 91, pika 4.**

**Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:** Objekt i këtyre vendimeve janë ndihma ekonomike për qytetarët në pamundësi financiare për të siguruar kushtet minimale të jetesës, i përcaktuar dhe si objektiv social në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; jepen në bazë të kriterëve të përcaktuar më VKM nr. 597/2019 dhe specifikuar në VKB në fillim vitit; janë ndihma të vazhdueshme mujore të pandryshueshme me një fond të përcaktuar në buxhetin e vitit aktual të miratuar në vitin paraardhës; klasifikimi i përfituesve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara shteruese nga struktura përkatëse e përcaktuar me VKM, si detyrë funksionale ngarkuar me përgjegjësi për zbatimin e kriterëve Ligjore, e cila harton dhe nënshkruan listën bashkëlidhur vendimit. Për arsyet e sipërcituara nuk jemi përpara faktit të vendimarrjeve të ndaluara nga neni 91 i Kodit zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore, aq më tepër para vendimarrjes që mund të lënë shkas favorizimi të këtyre subjekteve për procesin zgjedhor.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me gjetjen 16***, ku nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se në 5 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht vendimet nr 32,dt 06.04.2022, nr 50,dt 14.06.2022,nr 6 dt 25.01.2023, nr 52,dt 03.05.2023 dhe nr 118,dt 15.11.2023, për dhënie prone për zhvillim janë konfirmuar pa u shoqëruar me dokumentacionin që vërteton këshillimin me bashkësinë,dokumentacionin ligjor në regjistrimin e pronës, relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore si dhe pa procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

***Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:*** Këto vendime janë konfirmuar nga institucioni i Prefektit si e drejtë e Këshillit Bashkiak për t'u shprehur për pronën, referuar nenit 54 të ligjit, ndërkohë që është cilësuar që është kompetencë e kryetarit të bashkisë dhe administratës ndjekja e procedurave ligjore përkatëse në vazhdimësi. ***Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumenta plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentat që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në çënim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njeh organeve të vetqeverisjes vendore.***

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi miratimet nga Prefekti me nr.694/2 prot, datë 29.04.2022 si dhe me nr.1171/2 prot, datë 22.06.2022 janë kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues konkretisht:

- Dokumentacion që vërteton Këshillimin me bashkësinë, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ku përcaktohet:
- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ku përcaktohet
- Dokumentacioni ligjor mbi regjistrimin e pronës (certifikatë pronësie)
- Relacion përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore. Në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksin nr.1, neni (4) pika b, c.

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me gjetjen nr.17***, ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhërave dhe urdhërësive me karakter normative të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se VKB Tiranë, nr 56, dt 06.07.2022 nuk ka respektuar procedurën e përcaktuar në aktet ligjore të procesit rindërtimit.

***Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:*** a) VKM-ja nr. 904/ 2019 pika 16, citon se “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit”, ndërsa pika 17 citon se: “Komisioni informon kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore në lidhje me listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, i cili lidh kontratën për kalimin e pronësisë së banesave të përfituesit, pas marrjes së miratimit të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”,

Pra, VKM -ja përcakton dy faza , 1. Përzgjedhjen dhe hartimin e listës nga komisioni i posaçëm, cka nënkupton që në këtë fazë ky komision ezauron të gjithë procedurën e verifikimit të dokumentacionit të aplikuesve dhe nxjerrje e përfituesve si përgjegjësi e komisionit përkatës ngritur me urdhër Kryetari. Ndërkohë që këshilli miraton listën e hartuar nga komisioni, si pasojë vendimarrjet e këshillit për miratim listash kanë qenë të shoqëruara me relacion dhe lista të firmosura nga anëtarët e komisioneve përkatëse. Ndaj në referencë të kësaj baze dhe arsytimi ligjor Institucioni i Prefektit në verifikimin e ligjshmërisë është shprehur specifikisht ” **sipas listave të komisioneve të rindërtimit**”.

b) Një moment tjetër në këto vendime janë vendimarrjet e akteve të rindërtimit që kanë objekt prishje ndërtesash sipas akteve nënligjore në fuqi për rindërtimin, të cilat duhet të jenë të shoqëruara detyrimisht me Akt-Ekspertizën e thelluar e Institutit të Ndërtimit.

Theksojmë se këto akte të konfirmuara nga Institucioni i Prefektit kanë pasur detyrimisht bashkëlidhur akt ekspertizat, në të cilat referohet objekti i vendimit si dhe konfirmimi ligjor.

Në lidhje me konstatimin se akte ekspertiza e thelluar nuk përmban elementet që parashikon akti normativ nr. 9 dhe VKM nr. 26 e vitit 2020 theksojmë që ky dokument lëshohet nga një organ kompetent përcaktuar nga akte ligjore për përpilimin e akt-ekspertizës së thelluar, çka ngarkon me përgjegjësi direkte atë organ. Institucioni i Prefektit nuk ka kompetencë verifikimi për dokumentin që lëshon Instituti i Ndërtimit, pasi ky është një dokument shoqërues i vendimit që verifikohet.

c) Në lidhje me konstatimin se në disa akte me “objekt miratim lista përfituesish të granteve” nuk janë të shoqëruar me akt ekspertizën e thelluar,

Sqarojmë se këto akte kanë pasur akt ekspertiza të thelluara në vendimarrjen e miratimit të prishjes së objekteve, në të cilët kanë qënë pjesë personat që kanë dalë përfitues. Këto akte kanë qënë pjesë e praktikës së vendimarrjeve për miratimi prishje/rikonstruksioni.

**Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumenta plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentat që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në çënim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njeh organeve të vetqeverisjes vendore.**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi Miratimi i listave sipas VKB nr. 56, datë 06.07.2022 nuk është shoqëruar me dokumentacionin si: Procesverbali i mbledhjes së këshillit bashkiak; Arsyet e rivlerësimit të 2 banesave, të shpjeguara në raportet me nr. 18270, datë 20.05.2022 dhe nr. 23628, datë 24.06.2022 nga komisioni i posaçëm i ngritur janë në mospërputhje me pikën 19 si dhe me Kreun IV “Grantet për rikonstruksion” pika 2/a të Vendimit nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”.

Për sa më sipër, **Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### **Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 18,** ku nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve me karakter normativ të organeve të vetqeverisjes vendore u konstatua se VKB nr.,71 dt. 12.07.2022 “Për kalim në administrim të Agjencisë Industriale të Kreative të obketit “Kinema Agimi” me nr. Pas. 2/106-n 20, ZK 8270, në pronësi të Bashkisë Tiranë , nuk është e shoqëruar me dok. shoqërues. Ne vendim nuk është relatuar parashikimi në lidhje me administrimin e debitorit, mungon procesverbali i mbledhjes së këshillit Bashkiak për të vertetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anetareve të këshillit Bashkiak përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar, nëni 54 dhe nëni 55, si dhe në mospërputhje me rregulloren e brendshme të Institucionit

**Ju parashikojmë dhe argumentojmë se:** Objekti i vendimit është kalim administrim asetit pronësie brenda strukturave të bashkisë dhe në këtë rast këshilli shprehet në tagrat e ushtrimit të administratorit të pronave, dhe jep pëlqimin për një kalim të tillë në parim, ndërkohë që të gjitha detyrimet kontabël edhe pasqyrat financiare janë të janë të parashikuara në pikën 3 të këtij Akti, dhe i ngarkohen një strukturë përkatëse që nuk është objekt kontrolli nga ana institucionit tonë.

*Theksojmë që e gjithë procedura deri në dërgimin e projektvendimit në këshill përgatitet nga administrata dhe më tej kalon në komisionet e Këshillit Bashkiak, procedurë që ndiqet nga KB, ndërkohë kompetenca ligjore e Prefektit është verifikimi i ligjshmërisë së aktit të miratuar në këshill, dhe fakti që gjithë procedura e ndjekur është e pasqyruar në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer, si dhe Ligji shprehet se Prefekti miraton vendimet pa penguar zbatimin e tyre.*

***Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumenta plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentat që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në çënim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njeh organeve të vetqeverisjes vendore.***

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi miratimi nga Prefekti me nr.1399/1 prot, datë 22.07.2022 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 71 datë 12.07.2022 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar:

- Pasqyrat përkatëse ( në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në lidhje me administrimin e debitorit). Qendra Kulturore Tirana me shkresën nr. 297, datë 16.06.2022 “Informacion mbi objektin Kinema “Agimi“ drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit thekson -“Vlen për tu theksuar për Kinema Agimi është krijuar debitori shoqëria “E.“ deri në 31.12.2021 në vlerën 20,215,543 lekë të pasqyruar në bilancin e vitit ushtrimor 2021 në llogarinë 468 “debitorë të ndryshëm“, vlerë e cila në përfundim të kontratës në datë 09.02.2022 arrin vlerë 22,219,621 lekë dhe për çdo ditë vonesë një kamatë ditore prej 1 % të vlerës së qirasë.....”. Veprim në mospërputhje me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” aneksin nr.1, neni (4) pika b, c

- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,

Për sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### **Pretendimi i subjektit:**

***Në lidhje me gjetjen nr. 19, ku nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se në dy raste për dhenie me qera VKB nr. 158 dt. 23.12.2022 “Per disa ndryshime ne VKB nr. 158 dt. 26.12.2019 te Keshillit Bashkiak dhe vkb nr. 144, dt 23.12.2022 ne kuader te projektit “Shkolla Qender Komunitare” për periudhë të përkohëshme përcakton një afat 3 vjeçar por nuk jane te shoqeruara me procesverbalin e mbledhjes dhe relacionin shpjegues, në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 si dhe rregullores se brendeshme te Institucionit.***

***Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se: Vendimmarrja ka si objekt të drejtën e Këshillit për t’u shprehur mbi pronat dhe asetet në tagrin e pronarit, ndërkohë të gjitha procedurat tjera ndiqen nga administrata e bashkisë. Theksojmë që e gjithë procedura deri në dërgimin e projektvendimit në këshill përgatitet nga administrata dhe më tej kalon në komisionet e Këshillit Bashkiak, procedurë që ndiqet nga KB, ndërkohë kompetenca ligjore e Prefektit është verifikimi i ligjshmërisë së aktit të miratuar në këshill, dhe fakti që gjithë procedura e ndjekur është e pasqyruar në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer, si dhe Ligji shprehet se Prefekti miraton vendimet pa penguar zbatimin e tyre.***

***Fakti që është kryer këshillimi me bashkësinë shprehet në mënyrë eksplicite në bazën ligjore të aktit, si një ndër elementët kryesor që duhet të ketë akti referuar KPA. Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumenta plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentat që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke***

**kaluar dhe në cënim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njeh organeve të vetqeverisjes vendore.**

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga punonjësit e atakuar në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 20**, ku nga Auditimi u konstatua se ne 3 raste VKB nr. Transferim prone me vkb nr. 109 dt. 15.11.2022, VKB nr. 19 dt. 06.04.2022 dhe VKB nr. 24 dt. 17.03.2023 janë konfirmuar pa marrë me parë miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe pa u shoqeruar me procesverbalin e mbledhjes së keshillit bashkiak referuar ligjit nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 8744, dt. 22.02.2001 “Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e veteqeverisjes vendore”.

**Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:** Këto vendime janë miratim në formën e kërkesës të cilat do të përcillen në organet përkatëse për veprime të mëtejshme e **cilësuar kjo edhe në konfirmimin ligjor të Institucionit të Prefektit**, referuar nenit 17 të Ligjit 8744/2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore. Vendimi i Keshillit Ministrave del pas kërkeses se Organit të njesive te veteqeverisjes vendore. Vendimarrja ka si objekt të drejtën e Këshillit për t’u shprehur mbi pronat dhe asetet në tagrin e pronarit, ndërkohë të gjitha procedurat tjera ndiqen nga administrata e bashkisë.

Theksojmë që e gjithë procedura deri në dërgimin e projektvendimit në këshill përgatitet nga administrata dhe më tej kalon në komisionet e Këshillit Bashkiak, procedurë që ndiqet nga KB, ndërkohë kompetenca ligjore e Prefektit është verifikimi i ligjshmërisë së aktit të miratuar në këshill, dhe fakti që gjithë procedura e ndjekur është e pasqyruar në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer, si dhe Ligji shprehet se Prefekti miraton vendimet pa penguar zbatimin e tyre.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi miratimi nga Prefekti me nr.prot. 2178/2 datë 25.11.2022 i Vendimet e Këshillit Bashkiak nr. 19 datë 06.04.2022 si dhe nr. 109 datë 15.11.2022, është kryer

- pa marrë më parë miratimin nga Këshilli i Ministrave për kalimin të pronës nr. 1/71 në ZK 8150 nga pronësia shtet në pronësi të Bashkisë Tiranë është veprim në kundërshtim me nenet 17 dhe 19 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

- pa procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 21**, ku nga Auditimi u konstatua se ne 3 raste vkb per dhenie ndihme emergjente, perkatesisht vkb nr. 128 dt. M23.12.2022vkb nr.51 dt. 03.05.2023 dhe dhe vkb nr. 86 dt. 20.07.2023 janë konfirmuar në mospërputhje me VKM nr. 329 dt. 16.05.2012 “ Per kriteret dhe procedurat ....”

**Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:** VKM-ja 329 /2012, në kreun III, pika 1, gërma ë) citon: “Këshilli i komunës ose i bashkisë, pas shqyrtimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes dhe të dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ” dhe gërma f) Institucioni i prefektit të qarkut konfirmon bazueshmërinë ligjore të vendimit të lëshuar nga këshilli i komunës ose i bashkisë.

Përsa më sipër VKM-ja ngarkon një komision që ngrihet me urdher kryetari për përgatitjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit referuar kërkesës së qytetarëve, i cili më pas përgatit relacionin përkatës (i cili gjendet bashkelidhur vendimit që përcillet për verifikim së bashku me dokumenta tjera shoqëruese

dhe fondi është nga fondet e Bashkisë), ndërkohë Institucioni i prefektit të qarkut konfirmon bazueshmërinë ligjore të vendimit të lëshuar nga këshilli i komunës ose i bashkisë referuar pikës f të sipërpërmendur duke parë nëse është zbatuar procedura e përcaktuar ligjore dhe jo përmbajtja e dokumentacioneve pjesë osje që është detyrë e komisioneve të ngritura në zbatim të lgjitimitetit që VKM-ja ju jep.

**Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumenta plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentat që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në cënim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njej organeve të vetqeverisjes vendore.**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga punonjësit e atakuar në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### **Pretendimi i subjektit:**

**Në lidhje me gjetjen nr. 22**, ku nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se ne dy raste vkb nr. 40, dt. 19.04.2023 dhe 100, dt. 15.09.2023 janë konfirmuar në mospërputhje me ligjin nr. 139/2015, VKM nr. 469/2015 dhe rregulloren e brendeshme.

**Ju pararashtrajmë dhe argumentojmë se:** Gjithë procedura deri në dërgimin e projektvendimit në këshill përgatitet nga administrata dhe më tej kalon në komisionet e Këshillit Bashkiak, procedurë që ndiqet nga KB, ndërkohë kompetenca ligjore e Prefektit është verifikimi i ligjshmërisë së aktit të miratuar në këshill, dhe fakti që gjithë procedura e ndjekur është e pasqyruar në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer, si dhe Ligji shprehet se Prefekti miraton vendimet pa penguar zbatimin e tyre. Fakti që gjithë procedura e ndjekur pasqyrohet në bazën ligjore të aktit konsiderohet e kryer dhe pjesëmarrja shumicës së kërkuar të anëtarëve të këshillit, si në relacionin bashkelidhur vendimit.

**Në momentin që akti është përcjellë për verifikim i shoqëruar me relacione shpjeguese dhe rast pas rasti me dokumenta plotësuese ka bërë që procesi i verifikimit të bëhet referuar tyre në koherencë me kompetencat dhe instrumentat që ligji na jep për të ushtruar këtë detyrë funksionale, dhe jo në rolin e audituesit ligjor apo financiar të procedurave të ndjekura nga Administrata e Bashkisë, e cila do të kapërcente kompetencat tona duke kaluar dhe në cënim të autonomisë vendore që Karta për Autonominë Vendore i njej organeve të vetqeverisjes vendore.**

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. P.Q., z. S.B., zj. E.Sh., z. H.Ll. në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

Observacioni nuk merret në konsideratë pasi miratimi nga Prefekti me nr. 649/1, datë 25.04.2023 i Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 40 datë 19.04.2023 është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- relacion mbi dobishmërinë e dhënies me qira;

- në shkresën e Qendrës Sportive Tirana nr. 47, datë 16.02.2023 “Propozim për dhënien me qira afatgjatë të një sipërfaqe në administrim të Qendrës Sportive “Tirana” për këshillin drejtues i Qendrës Sportive “Tirana” si dhe në Vendimin nr. 1, datë 17.02.2023 të Këshillit Drejtues “Për dhënien me qira pasuri të paluajtshme”. Llogaritja e nivelit minimal të qirasë është për objekte banimi dhe jo tregtare ç’ka bie në kundërshtim me VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore” në pikën 3.

- procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkia për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak përcaktuar në neni 54 dhe pikat 3 dhe 4 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17. 12. 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Lidhur me VKB-në nr. 100, datë. 15.09.2023 Observacioni nuk merret në konsideratë pasi Miratimi nga Prefekti i Vendimit të Këshillit Bashkiak është kryer pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqërues:

- Pasqyrat përkatëse ( në rastin e vendimarrjes me karakter financiar);

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në buxhet dhe në çfarë zëri preket te buxheti i bashkisë;



- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit Bashkiak për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak

Veprime në mos përputhje me nenin 54 dhe pikat 2 dhe 6 të nenin 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut” e cila në aneksin nr.1, neni (4) pika b, c

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

**Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen nr. 23, ku konstatohet se: me vendimin nr. 77, dt. 05.01.2022 është miratuar ligjshmeria e paketës fiskale të Bashkisë Vore sa me sipër u konstatua se është vendosur dy here detyrim menyra e llogaritjes së këtij detyrimi e shprehur në përqindje mbi vlerën e investimit del jashtë kuptimit të tarifës së aplikimit dhe është rritje në menyra të terthorte e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Ju parashatrojmë dhe argumentojmë se:** Referuar Ligjit 9632, dt. 30.10.2006, neni 35 citon se “...këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifatat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent”

*Përsa më sipër, është kompetencë e Këshilli Bashkiak vendosja e tarifave si dhe përcaktimi i vlerës së tyre brenda kuadrit ligjor fuqi. Referuar këtij parshikimi si dhe argumentimit se taksa e ndikimit në infrastrukturë është një taksë që përcaktohet në ligj për ndikimin në infrastrukturë, ndërkohë tarifa për leje punimesh është e vendosur nga KB si kompetencë e tij për dhënien e shërbimit në bazë të aplikimit të subjektit për leje punimesh, pra nuk jemi para faktit të mbivendosjes së detyrimit. Në referencë sa u tha më sipër është bërë dhe konfirmimi ligjor i këtij vendimi.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga punonjësit e atakuar në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

**Observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

## 2.4. Të ndryshme, të dala gjatë auditimit

**Auditimi i Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara:** ligji nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, gërma g përcakton: “...kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë...”.

Institucioni i Prefektit, në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” ka marrëdhënie bashkëpunimi/koordinimi/informimi dhe ndërveprimi me Ministrinë, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Rajonale, Task Forcat në nivel qarku dhe bën bashkërendimin e veprimtarive të degëve territoriale në nivel qarku por dhe me organet e vetëqeverisjes vendore, mbi bazën e kërkesave që mund të kenë degët territoriale gjatë veprimtarisë së tyre.

Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, ka si mision monitorimin e kompetencave vendore të autoriteteve shtetërore në nivel qarku dhe kontrollin e zbatimit të funksioneve të deleguara nga qeveria. Fushat e zbatimit të tij janë: Arsimi, Sporti dhe Rinia, Bujqësia dhe çështjet e pronësisë, Kultura dhe Turizmi, Mbrojtja e Konsumatorit, Shëndetësia, Puna dhe Çështjet Sociale, Siguria publike dhe Shërbimi Zjarrfikës.

**Degët Territoriale:** Në zbatim të neneve 2, 3, 8 pika c; neni 10 pika ç të ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, si dhe urdhërit të Ministrisë të Brendshme, nr. 667, datë

18.12.2018 “Për raportimin dhe informimin mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut”, Institucioni i Prefektit u kërkon raportime dhe bazë të dhënash në formë elektronike dhe shkresore degëve territoriale sipas formatit tip dhe përgatit informacion për ZOS, MB dhe ministritë e linjës në bazë javore, mujore dhe rast pas rasti kur kërkohe në forma të tjera. Gjithashtu ky sektor ka një databazë të konsoliduar të degëve territoriale me 40 kontakte, me të dhënat për bazën ligjore, organigramën, organizimin territorial, buxhetin vjetor dhe infrastrukturën logjistike së bashku me përfaqësuesit e tyre e numrat e kontaktit. Degët territoriale që përfshihen në Prefekturën e Qarkut Tiranë për vitin 2022 dhe 2023, janë paraqitur në Aneksin 4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Tabela T1.

Nga auditimi i veprimtarisë së këtij sektori, rezultoi se nuk janë zbatuar detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, Kreu III, neni 6, pika b, përcakton:

*“Për kryerjen e funksioneve në marrëdhënie me institucionet qendrore në qark, prefekti i qarkut ushtron përgjegjësitë e monitorimit dhe kontrollit me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, si më poshtë:*

*Kryen kontroll sipas planit vjetor të miratuar nga prefekti i qarkut duke ndjekur procedurën e mëposhtme:*

*Prefekti i qarkut me urdhër të veçantë cakton grupin e punës, i cili do të kryejë procedurën e kontrollit duke përcaktuar dhe objektin e kontrollit;*

*Grupi i punës fillon procesin e kontrollit me dërgimin e njoftimit, institucioneve me formë shkresore, i cili do të përmbajë: Institucionin/subjektin e kontrollit; Bazën ligjore; Llojin e kontrollit; Arsyet e inicimit të kontrollit; Periudha që do të kontrollohet; Afatet e kryerjes së kontrollit; Përbërjen e grupit të punës.*

*Grupi i punës është përgjegjës për ndjekjen e procesit të administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit gjatë kryerjes së kontrollit;*

*Gjatë procesit të verifikimit në vend në institucionin, objekt kontrolli, grupi i punës mban akt-konstatimi, i cili nënshkruhet dhe nga përfaqësuesit e institucionit;*

*Në përfundim të kontrollit, harton raportin përfundimtar me konkluzionet përkatëse lidhur me plotësimin e detyrave të ngarkuara me akte ligjore e nën ligjore këtyre institucioneve, si dhe duke propozuar në çdo rast masat që duhen marrë për përmirësimin e punës dhe përgjegjësinë individuale të drejtuesve apo punonjësve të veçantë të këtyre institucioneve;*

*Raportin përfundimtar së bashku me rekomandimet përkatëse ja dërgon: a. Institucionit objekt kontrolli; b. Ministrit përgjegjës për institucionin; c. Ministrit përgjegjës për prefektin e qarkut; d. Kryeministrit.”*

### **Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:**

**1. Z. A.Q.**, në cilësinë e Prefektit të Qarkut Tiranë.

**2. Znj. E.K.**, në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara të Qarkut Tiranë.

Për sa më lart, nga znj. E.K. janë paraqitur observacione në rrugë elektronike dhe me shkresën nr. 466/17 prot., datë 26.09.2024, administruar nga KLSH, me nr. 561/6 prot., datë 27.09.2024.

#### **Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me gjetjen nr. 5 parashitrojmë dhe argumentojmë se: Referuar nenit 8 të ligjit 107/16 “Për prefektin e qarkut” ku citohet përkatësisht se: Prefekti i Qarkut ka përgjegjësi kryesore bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës; dhe shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;*

Prefekti i Qarkut ka një rol të rëndësishëm në bashkërendimin dhe monitorimin e veprimtarive të agjencive dhe inspektorateve që veprojnë brenda qarkut. Ky funksion ndihmon në sigurimin e një administrimi efikas të politikave qeveritare dhe respektimin e ligjit në nivel lokal. Prefekti vepron si përfaqësues i qeverisë qendrore në qark dhe siguron që veprimtaritë e këtyre agjencive dhe inspektorateve të jenë në përputhje me planet dhe politikat e përgjithshme shtetërore. Prefekti koordinon punën e këtyre organeve për të garantuar një menaxhim të unifikuar të çështjeve të qarkut dhe një zbatim të duhur të rregullave dhe ligjeve. Gjithashtu ai ndjek nga afër veprimtarinë e institucioneve rajonale, agjencive dhe inspektorateve për të siguruar që ato të respektojnë ligjet dhe rregulloret në fuqi. Prefekti, sipas ligjit, **mund të shqyrtojë raportet dhe dokumentacionin për të vlerësuar performancën dhe përputhshmërinë me standardet e kërkuara.**

Monitorimi i veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve është një proces që ka funksionuar në vijimësi pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë dhe jo vetëm për qëllim të punës së Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara por dhe për sektorët e tjerë. Kjo përfshin verifikimin e efikasitetit të politikave dhe procedurave, analizimin e performancës së tyre dhe identifikimin e ndonjë problemi që mund të ndikojë në përmbushjen e detyrave të caktuara.

Përgjatë ushtrimit të detyrave sektori është udhëhequr nga detyrat ligjore të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut". Kjo vërtetohet edhe me kërkesat periodike që ka kryer Prefekti i Qarkut, i cili në zbatim të nenit 8/ç të Ligjit Nr. 107/2016 ku sanksionohet se "Në përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut është informim çdo gjashtë muaj i institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku", **ka kërkuar dërgimin e analizës 6 mujore (ose vjetore) të veprimtarisë së degëve territoriale**, ku specifikohen objektivat e përcaktuara për vitin përkatës, zbatimin e detyrave funksionale, të dhëna statistikore si dhe problematikat e hasura gjatë punës.

Për sa i takon vërejtjeve dhe sugjerimeve tuaja në lidhje me detyrat që dalin nga Aneksi numër I, Kreu III, neni 6, pika b, ju shpjegojmë se ky Aneksi, si logjikë juridike, ka dalë në funksion dhe për zbatim të rregullores së brendshme nr. 175 datë 09.07.2020, me të cilën është bashkëngjitur. Aneksi detajon dhe zbërthen mënyrën e procedimit për kryerjen e funksioneve e marrëdhënieve me Institucionet qendrore në Qark.

Për sa më sipër, detyrat e përcaktuara nga rregullorja janë zbatuar nga sektori monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, pavarësisht boshllëqeve juridike dhe procedurale që dalin gjatë veprimtarisë së monitorimit, pasi institucionet qendrore në qark, shpesh kanë ligjet e tyre organike, ligje të cilat përjashtojnë varësinë dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut.

Nisur nga teknika dhe hierarkia legjislativë në një sistem juridik, ligjet organike kanë një nivel më të lartë sesa rregulloret ose aktet nënligjore. Kjo do të thotë se një rregullore ose aneksi i saj nuk mund të ketë fuqi më të madhe ose të përmbajë dispozita që janë në kundërshtim me një ligj organik. Si rezultat përballimi me një kufizim ligjor për kryerjen e kontrolleve të caktuara (sipas aneksit nr. 1, neni 6, germa b) nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga zj. E.K., në lidhje me situatën, qëndrimi i grupit të auditimit nuk ndryshon. Pretendimi se detyrat e përcaktuara nga rregullorja janë zbatuar nga sektori monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, pavarësisht boshllëqeve juridike dhe procedurale që dalin gjatë veprimtarisë së monitorimit, nuk qëndron pasi në asnjë prej praktikave të vëna në dispozicion grupit të auditimit nuk rezultoi të ishin zbatuar detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut", Aneksi nr.1, Kreu III, neni (6) pika b.

Përsa i përket pretendimit tuaj se nisur nga teknika dhe hierarkia legjislativë në një sistem juridik, ligjet organike kanë një nivel më të lartë sesa rregulloret ose aktet nënligjore, që do të thotë se një rregullore ose aneksi i saj nuk mund të ketë fuqi më të madhe ose të përmbajë dispozita që janë në kundërshtim me një ligj organik, ri sqarojmë se kjo rregullore është mbështetur në Nenin 102(4) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Ligjin Nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe Urdhrin e Kryeministrit nr. 50 datë

12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut” dhe si e tillë shërben për të rritur cilësinë duke ndjekur një procedurë të standardizuar të punës.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, monitorimi i veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve që veprojnë në nivel qarku përcaktohet edhe në Ligjin nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 8, pika (gj).

Për sa më sipër, **observacioni nuk merret në konsideratë** pasi pretendimet tuaja referuar rasteve konkrete nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

###### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla në Prefekturën Tiranë, për blerjet me vlerë të vogël, në dy raste nuk ka një strukturë të përcaktuar për hartimin e fondit limit por kjo detyrë i është ngarkuar sektorit të financës, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 56, pika 4 dhe neni 76 pika 3.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 28-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël, të marrë masa që në çdo procedurë prokurimi të plotësojë dokumentet e tenderit në përputhje me rregullat e prokurimit publik për të mundësuar pasqyrim të saktë të procedurës.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se nga njësitë e qeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut, Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë), për periudhën objekt auditimi në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë janë depozituar **381 Akte Individuale** (195 gjatë vitit 2022 dhe 186 gjatë vitit 2023), të cilat nuk duhet të përcillen për konfirmim ligjshmërie, pasi iu drejtohen subjekteve të përcaktuar individualisht, duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete dhe janë të shteruar në zbatimin e tyre.

Konfirmimi i ligjshmërisë së tyre nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Tiranë, është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve”, pika 2.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa që në vazhdim të pranojë dhe të konfirmojë ligjshmërinë vetëm për aktet me karakter normativ, të depozituara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, u konstatua se:

- Verifikimi në vend në njësitë e qeverisjes vendore (Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë dhe Rrogozhinë), nuk është kryer në muajt mars, qershor, shtator dhe dhjetor, në kundërshtim me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së

*brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut*”, aneksi nr.1, neni 5, pika 1 dhe 2;

- Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, gjatë viteve 2022 dhe 2023 nuk ka kryer asnjë kontroll në Këshillin e Qarkut Tiranë, në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016 “*Për prefektin e Qarkut*”, neni 17.

- Sa i përket procedurës së ndjekur me aktet normative të kthyer për pabazueshmëri ligjore (*dërgimit në afat të aktit në njësitë vendore, regjistrimit ose jo të tyre si dhe arsyen e mos rishqyrtimit të akteve nga njësitë vendore*), grupet e punës nuk kanë kryer kontrollet sipas kërkesave të Ligjit nr. 107/2016 “*Për prefektin e Qarkut*”, neni 16, pika 2, germa b.

- Pas verifikimit në vend të akteve, Institucioni i Prefektit të Qarkut (sektori juridik) nuk ka dërguar pranë NJVV-së objektin e verifikimit, konkluzionet së bashku me rekomandimet përkatëse në kundërshtim me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut*”, aneksi nr. 1, neni 5, pika 2, germa g.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik, të marrë masa për:

- Verifikimin sistematik të ligjshmërisë së akteve normative në njësitë e vetëqeverisjes vendore çdo 3 muaj.

- Kontrollin periodik mbi procedurat e ndjekura për aktet normative të kthyer për pabazueshmëri ligjore.

- Hartimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve pas verifikimeve në terren, për të përcjellë rezultatet dhe problematikën e konstatuara.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

- **75** Vendime të Këshillave Bashkiakë (Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë) dhe **25** Vendime të Këshillit të Qarkut Tiranë, nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes.

- **68** Vendime të Këshillave Bashkiakë (Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë) dhe **11** Vendime të Këshillit të Qarkut Tiranë, nuk janë të shoqëruara me relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore.

- **22** Vendime të Këshillit të Qarkut Tiranë, nuk janë të shoqëruara me projekt vendimin;

- **10** Vendime të Këshillave Bashkiakë (Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë), me karakter financiar, nuk janë të shoqëruara me pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar).

- **16** Vendime të Këshillave Bashkiakë (Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë dhe Këshilli i Qarkut Tiranë), nuk janë të shoqëruar me procesverbalet e dëgjësive publike.

Në total, për periudhën objekt auditimi, **227** Vendime të Këshillave Bashkiakë (Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë dhe Këshillit të Qarkut Tiranë, **nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë**, në kundërshtim me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “*Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut*”, aneksi nr. 1, neni 4, germa b dhe “*Manualin për hartimin e legjislacionit*”, Shtojca E, “*Relacioni për projekt aktin*”, faqe 303-306.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa që në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e

nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara u konstatua se për vitet 2022-2023, gjatë kryerjes së funksioneve në marrëdhëniet me institucionet qendrore në qark, Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk ka ushtruar përgjegjësitë e monitorimit dhe kontrollit, në kundërshtim me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 6, germa b.

Gjithashtu, nga ana e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, nuk është kryer monitorimi i veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve që veprojnë në nivel qarku, në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut”, neni 8, germa gj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 97-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, të marrë masa për:

-Zbatimin e përgjegjësisë të monitorimit dhe kontrollit sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme.

-Monitorimin e veprimtarisë së agjencive dhe inspektorateve që operojnë në nivel qarku.

*Deri në 31.07.2025*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

- 17 Vendime të Këshillit Bashkiak Kamëz, me objekt “Dhënie ndihme ekonomike”, me një vlerë totale prej **13,342,000 Lekë**, janë konfirmuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kapitulli 4, pikat 5, 7 dhe 13.

- Në 5 raste, u konstatua se VKB-të me objekt “Dhënie ndihme ekonomike për arsye shëndetësore”, janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 11, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë të marrë masa për:

-Krijimin e një grupi pune për analizimin dhe përcaktimin e përgjegjësisë në rastet kur është dhënë konfirmim në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi.

-Forcimin e mekanizmave të parandalimit për të shmangur shkeljet përmes monitorimit të hershëm dhe vlerësimit të akteve para miratimit të tyre.

-Në rastet kur vërehen shkelje ligjore dhe kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore konsiderohet i pafrytshëm, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se

VKB-të nr. 14, datë 15.02.2023, “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”, nr. 26, datë 17.03.2023, “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”, nr. 28, datë 17.03.2023, “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë”, nr. 39 datë 11.04.2023, “Për Shpërblimin e sportistëve dhe trajnerëve të ekipeve të shkollave të Bashkisë Kamëz, fituese në nivel qarku në disiplinat volejboll dhe basketboll (meshkuj dhe femra), në kuadër të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, shpërblyer në vlerën totale prej 450,000 lekë, Vkb nr. 52 datë 18.04.2023, “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë nga programi i strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim”, për vitin 2023 me fonde nga buxheti i shtetit” të marra gjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, pika 4 dhe Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, neni 1, neni 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik, të marrë masa që në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura katër muaj para datës së zgjedhjeve parashikojnë dhënien e përfitimeve të ndryshme për kategori të caktuara të popullsisë, t’ia kthejë ato organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se për vitet 2022-2023, janë kthyer për pabazueshmëri ligjore, **50** Vendime të Këshillave Bashkiakë (Bashkia Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë). Në të gjitha rastet kur është vërejtur papajtueshmëri ligjore e akteve, prefekti i qarkut ia ka kthyer ato organeve përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, por në asnjë rast nuk ka argumentuar shkeljet apo parregullsitë e vërejtura. Në asnjë rast, Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë nuk i është drejtuar gjykatës kompetente për çështje administrative, për të kërkuar drejtpërdrejt pavlefshmërinë e akteve, në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, neni 16, pika i.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa që:  
- Në të gjitha rastet, kur vëren papajtueshmëri ligjore të akteve, t’ia kthejë ato organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, **duke argumentuar shkeljet e vërejtura.**

- Në të gjitha rastet, kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se:

VKB-të nr. 20, datë 19.09.2023, “Për dhënie autorizimi kryetarit të bashkisë Rrogozhinë me objekt: Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe avokaturës së shtetit për të autorizuar e legjitimuar avokaturën e shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar Bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të RSh”, nr. 11, datë 23.02.2022, “Për dhënie autorizimi kryetarit të bashkisë Rrogozhinë me objekt: Lidhjen e marrëveshjes në emër të SH.A, UK Rrogozhinë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe

*Energjisë për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura në territorin e Bashkisë Rrogozhinë”, nr. 119 datë 14.12.2022, “Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit “Mbështetje për Zhvillim 2022-2024” ndërmjet projektit Bashki të Forta dhe Bashkisë Kavajë”, janë konfirmuar në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 54 dhe 64, germa gj.*

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa që në të gjitha rastet kur, Këshillat Bashkiakë kanë vepruar në mungesë të kompetencës, t’ia kthejë ato duke argumentuar shkeljet e vërejtura.

**Deri në 31.07.2025**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në 2 raste, VKB-të nuk kanë qenë të shoqëruara nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë. Institucioni ka konfirmuar ligjshmërinë e aktit në kundërshtim me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, germa c.

- Në dokumentacionin shoqëruar të VKB-së nr. 67 datë 23.11.2022, “Për miratimin e fondit nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Rrogozhinë për objektin mbrojtje me gabione, përroi Sinaballaj, për mbrojtjen e banesave nga gërryerjet e këtij përroi”, mungon preventivi i vlerësimit të dëmeve për dëmshpërblimin e miratuar në shumën prej 692,700 lekë, në kundërshtim me Vendimin nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, germa b, ç, d dhe e.

- Në dokumentacionin shoqëruar të VKB-së nr. 35 datë 26.04.2022, “Për dhënien e ndihmës financiare z. S.H. për dëmet e shkaktuara në banesën e tij”, mungon procesverbali i konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara, në kundërshtim me Vendimin nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, germa b.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa që në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’u kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe urdhrave me karakter normativ të njësive të vetëqeverisjes vendore u konstatua se Vendimi nr. 72, datë 20.11.2023, për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar nga AKMC për përballimin e situatave emergjente, me vlerë **3,349,000 lekë**, është konfirmuar në kundërshtim me Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, neni 35. Ky akt kërkon që prishja e detyruar të justifikohet nga një akt konstatimi, akt vlerësimi paraprak ose akt ekspertizë e thelluar nga Instituti i Ndërtimit, gjë që mungon në këtë rast. Ky konstatim evidenton mungesën e dokumentacionit të nevojshëm për justifikimin ligjor të vendimit dhe përdorimit të fondeve



publike.

Gjithashtu, u konstatua se për nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesës, nuk rezultojnë të dokumentuara kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**11.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë të marrë masa për:

-Sigurimi i pajtueshmërisë ligjore në përdorimin e fondeve publike, duke kërkuar dokumentacion të plotë justifikues sipas dispozitave në fuqi.

-Forcimin i mekanizmave të kontrollit dhe verifikimit për të parandaluar miratimin e akteve në kundërshtim me kuadrin ligjor.

*Menjëherë*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se:

**1.** Me vendimin nr. 4, datë 20.01.2023, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”, është miratuar shuma **234,499,204 lekë**, në zbatim të programeve të rindërtimit.

**2.** Me vendimin nr. 84, datë 19.12.2023, “Për miratimin e ndryshimeve të masës së përfitimit të familjeve të miratuara me VKB-në nr. 62 datë 21.07.2021, VKB-së nr.88, datë 11.11.2021, VKB-së nr.4, datë 20.01.2023”, është miratuar ndryshimi i masës së përfitimit për: F.I.H., e cila kishte përfituar një apartament 2+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartamente 2+1 dhe 1+1; H.R.Rr., i cili kishte përfituar një apartament 1+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartament 2+1; Sh.M.L., i cili kishte përfituar apartament 1+1 dhe nga rivlerësimi përfiton apartament 2+1.

**3.** Me vendimin nr. 95, datë 19.07.2022, “Mbi miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve të vendimit nr. 67 datë 17.06.2022 të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për banesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të institutit të ndërtimit me nivel dëmtimi “Për shembje” është miratuar kualifikim shtesë për 2 përfitues.

**4.** Me vendimin nr. 28 datë 23.03.2022, “Për disa ndryshime në VKB-në nr. 64, datë 11.06.2020 dhe VKB-në nr. 54 datë 30.06.2021, për miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit si rezultat i fatkeqësisë natyrore të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019” është miratuar masa e ndryshimit për përfituesit: F.H.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS1 dhe bëhet DS3); R.Sh.; (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3); D.T. (shkalla e dëmit në banesë ishte DS2 dhe bëhet DS3).

**5.** Me vendimin nr. 30 datë 23.03.2023, “Për një ndryshim/shtesë të VKB-së nr. 4 datë 20.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programet e rindërtimit të vlerësuara nga komisioni dhe të miratuara nga kryetari i bashkisë, banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti i datës 26.11.2019”” është miratuar masa e ndryshimit për përfituesit: E.Sh. (Sh.), vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 2,241,707 Lekë dhe pas rivlerësimit është në vlerën prej 3,412,137 Lekë; D.D., vlerësimi i dëmit ishte në vlerën prej 12,094,026 Lekë për tre familjet D., për ndërtimin e një ndërtese në bashkëpronësi dhe pas rivlerësimit u shtua vlera prej 2,241,707 Lekë; L.B. shtohet si përfitues i një apartamenti 2+1.

**6.** Me vendimin nr. 10 datë 23.01.2023, “Për miratimin e subjekteve, të cilët përfitojnë nga grantet për rindërtimin e shtëpive individuale, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, vlerësuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit për shembje”, janë miratuar si përfitues aplikuesit L.P. dhe N.M., të cilët rezultojnë të skualifikuar në VKB-në nr. 50, datë 19.05.2021 dhe VKB nr. 146 datë 07.12.2020.

**7.** Me vendimin nr. 83 datë 22.08.2023, “Për miratimin e listës së familjeve shtesë që përfitojnë bonus qiraje, banesat e të cilëve preken nga rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit dhe

ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit”, është miratuar lista e familjeve shtesë që do të trajtohen me bonus qiraje, për shkak se banesat e tyre preken nga projekti “Ndërtimi i pedonales dhe zonave rekreative të liqenit të Paskuqanit dhe Rehabilitimi i digës së liqenit të Paskuqanit”.

**Në 7 rastet e sipërcituara, VKB-të janë konfirmuar në mungesë të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurës ligjore** mbi të gjitha rivlerësimet e kryera (depozitimi i ankesave të subjekteve jo përfitues, procedura e ndjekur nga njësia e vetëqeverisjes vendore, akt ekspertizat e thëlluara të Institutit të Ndërtimit etj.), në kundërshtim me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, germa b dhe Vendimin nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, pika 19.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë të marrë masa që:

- Të ngrejë grupe pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për konfirmimin e dhënë në mungesë të dokumentacionit justifikues që shpjegon respektimin e procedurave ligjore.

- Në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

*Menjëherë*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se me vendimin nr. 98 datë 20.11.2023, “Për miratimin e listës së dokumenteve për programin “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara” për vitin 2024, është miratuar lista e dokumenteve për programin e Strehimit Social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara” për vitin 2024, e cila nuk është hartuar në përputhje me Vendimin nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pikat 5 dhe 16 germat a, b, c, ç dhe d, të pasi nuk përmban dokumentacionin e plotë të cituar në këtë vendim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa për të ngritur një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi.

*Menjëherë*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, Vendimit nr. 62 datë 29.09.2023 “Për shembjen e detyruar të ndërtesës së Kopshtit “Fiqiri Kurti” si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i 26.11.2019”, u konstatua se Urdhri nr. 102, datë 24.04.2023, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26.11.2019, është në tejkalim të afateve (rreth 4 vite pas fatkeqësisë natyrore) dhe konstatimi është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 3.

Gjithashtu, u konstatua se akt-ekspertiza e thëlluar është hartuar në kundërshtim me Aktin Normativ nr. 9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 34 dhe VKM-në nr. 26, datë 15.1.2020 “Për kryerjen e akt ekspertizës së thëlluar në ndërtesat e

dëmtuara”, pika 5, pasi përveç të tjerave, nuk përmban përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa për të ngritur një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi.

### *Menjëherë*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se **në 5 raste**, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht: Vendimet nr. 32, datë 06.04.2022; nr. 50, datë 14.06.2022; nr. 6, datë 25.01.2023; nr. 52, datë 03.05.2023 dhe nr. 118, datë 15.11.2023 (të konfirmuara), **për dhënie prone për zhvillim** janë konfirmuar pa u shoqëruar me dokumentacionin që vërteton këshillimin me bashkësinë, dokumentacionin ligjor mbi regjistrimin e pronës (certifikatë pronësie), relacionin përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore si dhe pa procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 18, neni 54 dhe neni 55, pikat 3 dhe 4, si dhe me Rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksin nr. 1, neni 4, pikat b dhe c.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik të marrë masa për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për këto vendime dhe në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

### *Menjëherë*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, u konstatua se Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë me nr. 56 datë 06.07.2022 “Për miratimin e listave të përfituesve të nën programit të grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi **DS4**” është miratuar megjithëse kërkesat e qytetarëve janë në tejkallim të afateve ligjore të parashikuara për të drejtën e ankimit dhe nuk kanë si dokumentacion shoqërues certifikatat e gjendjes familjare në datën 26.11.2019. Miratimi i listave nuk është shoqëruar me Procesverbalin e mbledhjes së këshillit bashkiak. Arsyet e rivlerësimit të 2 banesave, të shpjeguara në raportet nr. 18270, datë 20.05.2022 dhe nr. 23628, datë 24.06.2022 nga komisioni i posaçëm i ngritur, janë në kundërshtim me VKM-në nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Kreu IV “Grantet për rikonstruksion”, pika 19, pika 2, germa a.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 56, datë 06.07.2022 dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së

dokumentacionit.

*Deri në 31.07.2025*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se me shkresën nr. 1399/1 prot., datë 22.07.2022, nga Prefekti është miratuar Vendimi KB Tiranë nr. 71 datë 12.07.2022 “Për kalimin në administrim të Agjencisë së Industrisë Kreative, të objektit “Kinema Agimi”, me nr. pasurie 2/106-n 20, zona kadastrale 8270, në pronësi të Bashkisë Tiranë”, pa u shoqëruar me dokumentacionin shoqëruar.

- Në vendim nuk është relatuar parashikimi në lidhje me administrimin e debitorit; (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar). Qendra Kulturore Tirana në shkresën nr. 297, datë 16.06.2022 “Informacion mbi objektin Kinema “Agimi””, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, thekson se për Kinemanë “Agimi” është krijuar debitori shoqëria “E.” deri në 31.12.2021, në vlerën 20,215,543 lekë të pasqyruar në bilancin e vitit ushtrimor 2021 në llogarinë 468 “debitorë të ndryshëm”, vlerë e cila në përfundim të kontratës në datë 09.02.2022 arrin në 22,219,621 lekë dhe për çdo ditë vonesë një kamatë ditore prej 1% të vlerës së qirasë.....”).

- Mungon procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak, për të vërtetuar zbatimin e kushtit ligjor të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 dhe neni 55.

Në kundërshtim edhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, germa b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 71, datë 12.07.2022 dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

*Deri në 31.07.2025*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, në 2 raste për dhënie me qira, Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, konkretisht Vendimi nr. 139 datë 23.12.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar” dhe Vendimi nr. 144 datë 23.12.2022 “Për miratimin e formës dhe procedurave për shfrytëzimin e ambienteve sportive të institucioneve arsimore publike para universitare, Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit “Shkolla Qendër Komunitare”, (të konfirmuara), për periudhë të përkohshme përcakton një afat 3 vjeçar, por nuk janë të shoqëruara me procesverbalin e mbledhjes, projektvendimin dhe relacionin shpjegues, në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 18 si dhe rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksin nr. 1, neni 4, germat b dhe c.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 139 datë 23.12.2022 dhe nr. 144 datë 23.12.2022, si dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të

bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

**Menjëherë**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, **për transferim prone** konkretisht Vendimi nr. 109, datë 15.11.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të një pjese të pasurisë me nr. 7/662, zona kadastrale 8170, me sipërfaqe prej 529 m<sup>2</sup>, që do të përdoret për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën e zhvillimit ekonomik, si dhe shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”; Vendimi nr. 19 datë 06.04.2022 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme shtetërore me nr. pasurie 150, zona kadastrale 3517, me emërtimin “grup depo rep. usht. 8837, me vendndodhje në Stërmas”, me qëllim ngritjen e një qendre grumbullimi (strehëz) për kafshët endacake” dhe Vendimi nr. 24 datë 17.03.2023 “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pronës së paluajtshme me numër pasurie 1/71, ZK 8150, tiranë, që do të përdoret në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, si dhe realizimin e funksioneve apo shërbimeve të tjera në funksion të bashkësisë”, janë konfirmuar pa marrë më parë miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe pa u shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, nenet 17 dhe 19, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 dhe nenin 55, pikat 3 dhe 4, si dhe Rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune për të konfirmuar dokumentacionin ligjor për VKB Tiranë nr. 109, datë 15.11.2022 dhe nr. 19 datë 06.04.2022, si dhe në të gjitha rastet kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t’i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

**Deri në 31.07.2025**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 3 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, **dhënie ndihmë emergjencë** konkretisht Vendimi nr. 128, datë 23.12.2022 “Për dhënien e ndihmës financiare për 16 (gjashtëmbëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit dhe përmbytjeve dhe dëmet ndërtimore në ambientet e përbashkëta të pallatit “Mesaplik 05”, ndërtesa Nr.4, në rrugën “Migjeni”, Lagjja Nr. 14.”. i cili ka miratuar fondin **3,245,423 lekë**; Vendimi nr. 51 datë 03.05.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 7 (shtatë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 2 raste, zjarre 4 raste dhe përmbytje 1 raste në vlerë totale 5,397,301 lekë); Vendimi nr. 86 datë 20.07.2023 “Për dhënien e ndihmës financiare për 29 (njëzet e nëntë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit, tërmetit dhe përmbytjeve”. (Tërmet 11 raste, zjarre 13 raste dhe përmbytje 5 raste në vlerë totale 11,757,572 lekë), janë konfirmuar në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe VKM-në nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III, pika 1, gerrat b, ç, d dhe e.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**20.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimet e dhëna në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi dhe në të gjitha rastet, kur aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

*Deri në 31.07.2025*

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, **në 2 raste** Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë **për sipërmarrje dhe dhënie me qira**, konkretisht Vendimi nr. 40 datë 19.04.2023 “Për miratimin në parim të dhënies me qira, me konkurrim, të një sipërfaqeje prej 1284 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë me nr. 8/72, zona kadastrale 8270, me emërtim “Akuadromi i Tiranës” dhe Vendimi nr. 100 datë 15.09.2023 “Për miratimin e projektit “Sipërmarrja ime për shkollën” hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”, janë konfirmuar në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54 dhe neni 55, pikat 3 dhe 4; VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, pika 3; si dhe me rregulloren e brendshme nr. 175 datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucionit të prefektit të qarkut”, aneksi nr. 1, neni 4, pikat b dhe c.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa të ngrejë grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimet e dhënë në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi. dhe në të gjitha rastet kur, aktet e paraqitura nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë, t'i kthejë menjëherë aktet NJVV-ve, duke i informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

*Menjëherë*

**22. Gjetje nga auditimi:** Me vendimin nr. 77, datë 05.01.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Vorë për vitin 2023”, është konfirmuar ligjshmëria për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, u konstatua se në pikën II.2., “Tarifa për shërbime administrative”, me numër rendor 3 është specifikuar “Aplikim për leje ndërtimi, leje zhvillimi, leje infrastrukturore, leje përdorimi”, me detyrim në vlerën 10,000 lekë. Në pikën II.9., “Tarifa vendore për kërkesa për leje punimesh”, është specifikuar detyrim në vlerën 1% e punimeve/preventivit.

Sa më sipër, rezulton se është vendosur dy herë detyrim, për të njëjtin shërbim të ofruar. Një herë në vlerën 10,000 lekë, e cila rezulton e argumentuar dhe e mbështetur në legjislacionin tatimor dhe një herë e shprehur në përqindje. Mënyra e llogaritjes së këtij detyrimi, e shprehur në përqindje mbi vlerën e investimit, del jashtë kuptimit të tarifës së aplikimit dhe realisht është rritje në mënyrë të tërthortë e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke rënduar detyrimet e qytetarëve.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, neni 2 “Përkufizime”, pika 3, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, kreun VII, neni 35, pika 2, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, pika 5, germa c), dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 35 “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 1, germa b).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, Sektori Juridik, të marrë masa

për të kërkuar pavlefshmërinë e aktit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ELEMNIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se nëpërmjet VKB-së nr. 8 datë 25.01.2022, “Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet zhvilluesit privat A.A. ShPK & E.A. dhe Bashkisë Kavajë”, është miratuar aktmarrëveshja nr. 227 prot., datë 18.01.2022, ku dakortësohet që detyrimi i subjektit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej **11,842 828 lekë**, të këmbëhet me 3 apartamente banimi të cilat do të kalojnë në pronësi të Bashkisë Kavajë. Marrëveshja e miratuar nuk gjen mbështetje në bazën ligjore të referuar në vendim, pasi nuk është e parashikuar të realizohet këmbimi me apartamente i vlerës së taksës të detyrueshme për t’u paguar në vlerë monetare. Miratimi i këtij vendimi të pa bazuar në ligj ka shkaktuar për Bashkinë Kavajë, mungesë të ardhurash në vlerën prej **11,842 828 lekë**.

Konfirmimi i ligjshmërisë është në mospërputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 27, pika 4 dhe Vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 22, pika 2.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 35-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë, të marrë masa për të ngritur një grup pune me qëllim analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive mbi konfirmimin e dhënë në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neneve 57, 58 dhe 59 të Ligjit nr. 152/2013 datë 17.10.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut II, pika 2 të VKM-së nr. 115 datë 05.03.2015 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i ndryshuar, **i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Tiranë**, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për **5 (pesë)** punonjësit, si më poshtë:

**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, germa (c) neni 58.**

1. **Znj. P.Q.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik;
2. **Z. H.Ll.**, me detyrë Specialist në Sektorin Juridik;
3. **Z. S.B.**, me detyrë Specialist në Sektorin Juridik;
4. **Znj. E.Sh.**, me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik;
5. **Znj. E.K.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve te Deleguara.

Për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me germën a, neni 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”.

**C.1.** Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin

Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, dhe **lihet në kompetencë të Prefektit të Qarkut Tiranë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

**C.2.** Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 5 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin” dhe Urdhrit nr.175 datë 09.07.2020 të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Prefektit të Qarkut si dhe aneksin i të rregullave për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, **i rekomandojmë Ministrit të Brendshëm**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për Prefektin e Qarkut Tiranë, **z. A.Q.**, për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjorë për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të germa (a) nenit 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”.

#### **D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Prefekti i Qarkut Tiranë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndër marrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**